RAPORT AUDITIMI

"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE"

NË

DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS TIRANË

Tiranë, mars 2022

Nr. Përmbatja FAQE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të auditimit..... 3

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....3

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit. 3

II. HYRJA

1.Objekti i auditimit.....

2.Qëllimi i auditimit.....

3.Identifikimi i çështjes.....3

4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 4

5.Përgjegjësitë e audituesve.....

6.Kriteret e vlerësimit.....

7.Standardet e auditimit.....4

8.Metodat e auditimit.....5

9.Dokumentimi i auditimit.....5

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

2.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....6

2.2 .Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:.....6

2.2.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën nën auditim, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, sipas komponentëve të të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.....6-10

- Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe respektimi i afateve.....10

-Mbajtja dhe plotësimi i dokumentacionit financiar kontabël.Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhje e detyrimeve fiskale etj. ndaj buxhetit të shtetit.....

2.2.2.Auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë dhe arkë, inventarizimi i pronës.

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera përmes bankës, arkës në lekë dhe valutë.....10-38

-Prokurimi i fondeve publike.....38-66

-Inventarizimi i pronës, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sitemimi i diferencave.

2.2.3. Mbi përputhshmërinë ligjore të veprimeve të kryera në lidhje me strukturën organizative, marrëdhëniet e punës, paga e shpërblime bazuar në aktet ligjore në fuqi.....72-85

2.2.4. Auditimi i përputhshmërisë me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së Shërbimit të Provës/drejtorive përbërëse dhe drejtorive rajonale në varësi të tij, për arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë.....85-117

2.2.5 Çështje të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET.....120-133

V.ANEKSE 134-135

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Raporti i auditimit ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Tiranë (*këtu e më poshtë DPSHP*) prezanton çështjet kryesore të rezultuara në përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor dhe rregullator si: vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe respektimi i afateve, mbi përputhshmërinë ligjore të veprimeve të kryera në lidhje me strukturën organizative, marrëdhëniet e punës, paga e shpërblime bazuar në aktet ligjore, përputhshmëria me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së Shërbimit të Provës/drejtorive përbërëse dhe drejtorive rajonale në varësi të tij. Disa nga gjetjet kryesore të evidentuara, si dhe rekomandimet përkatëse në mënyrë të përmbledhur jepen më poshtë.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbikqyrjes Elektronike u konstatua se për periudhën 2018-2019, kjo drejtori nuk ka qënë në eficencë të plotë për të përmbushur shërbimin e ME, pasi funksionimi i ñpajisjes së gjurmimitò ka paraqitur një sërë problematikash të cilat nuk kanë mundësuar teknikisht funksionimin e saj. Për pasojë, nga gushti i vitit 2017 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP) nuk ka zbatuar asnjë urdhër ekzekutimi për mbikqyrje elektronike si dhe pas dy vitesh testim dhe monitorim të sistemit të mbikqyrjes elektronike ministria e Drejtësisë ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën nr.8383/10 prot., datë 21.02.2017, për shkak se ka dështuar funksionimi efektiv i pajisjes së gjurmimit. Për pasojë, nga data 20.09.2019, datë në të cilën është zgjidhur zyrtarisht kontrata e sipërcituar e në vijim (*deri 30.06.2021 periudhë nën auditim*), DME, nuk ka qënë eficente dhe nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për të cilat është krijuar, pasi nuk ka realizuar procesin e mbikqyrjes elektronike, duke sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në lidhje me shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve të drejtorisë së ME në vlerën 14,291,182 lekë llogaritur për periudhën tetor 2019 deri në Qershor 2021 lekë.	fq	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, të marrë masa të menjëhershme duke kërkuar nga organi qëndror/ministria e Drejtësisë vënien në eficencë të DME dhe stafit të saj, me qëllim funksionimin e kësaj drejtorie.
2	Nga auditimi mbi veprimtarinë e Shërbimit të Provës në lidhje me krijimin e regjistrit elektronik dhe dixhitalizimin e Shërbimit të Provës konstatohet se: DPSHP ka ngritur një sistem elektronik për dixhitalizimin e sistemit të Shërbimit të Provës i cili është implementuar që nga viti 2015 me lidhjen e kontratës me objekt ñDixhitalizimin e sistemit të Shërbimit të Provësò nr.1853, datë 28.09.201 mes AKSHI-t dhe BOE ñF.ò(*ku përfitues është SHP*) e cila ka përfunduar me akt marrëveshjen e palëve kontraktuese nr.7552/6 prot., datë 06.12.2019. Për periudhën 2018-2019 nuk rezulton të jenë hedhur të dhënat e regjistruara nga ZVSHP-të dhe administruar nga DPSHP, jo në përputhje me termat e referencës, Aneksi 1, versioni 1.1., pika 2.1 pjesë përbërëse e kontratës nr.1853, datë 28.09.2015, ku objekti i	Fq.	E lartë	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi në lidhje me dixhitalizimin e Shërbimit të Provës me qëllim që në të ardhmen të vihet në eficencë ky sistem konform kontratës nr. 1201 prot., datë 25.02.2021 me vlerë 2,292,000 lekë pa TVSH.

	kontratës është krijimi i sistemit të menaxhimit të dosjeve të SHP.Mos hedhja e të dhënave/dixhitalizimi i dosjeve në kohë reale, jo në përputhje me VKM nr.302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3 ka sjellë si pasojë përdorimin pa eficencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 7,899,680 lekë pa TVSH, vlerë e cila është shpenzuar për ngritjen e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij.			
3	Nga auditimi mbi vendimet gjyqësore u konstatua se janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 7 ish-punonjës në vlerën totale 5,938,934 lekë, nga ku për vitin 2019 në vlerën 2,784,670 lekë, për vitin 2020 në vlerën 2,547,072 lekë dhe për vitin 2021 ne vlerën 607,192 lekë. Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës menjëherë me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë ekzekutur në mënyrë të detyrueshme me urdhër ekzekutime të lëshuara nga përmbaruesit privat, kundrejt tarifës përmbarimore, në vlerë totale prej 661,644 lekë nga ku për vitin 2019 në vlerën 265,248 lekë, për vitin 2020 në vlerën 354,676 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 41,720 lekë. Vendimit gjyqësore janë shpenzim jo i drejtë dhe jo në përputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e DPSHP-së, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej 5,938,934 lekë.	Fq.		Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës të marrë masa për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë menjëherë pas publikimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, me qëllim uljen e shpenzimeve të DPSHP-së.
4	Për periudhën 01.01.2018 deri në 30.06.2021, në lidhje me realizimin e procedurave me blerje të vogël me objekt ñBlerje karburant për nevojat e DPSHPò, u konstatua se: Me USH nr.373 date 24.05.2019, është paguar 350 litra gazoil me tollonë, bazuar në Urdhërin nr.3812 prot datë 22.11.2018 ñPër shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, për specialisten e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kukës, znj J.E.ò, për lëvizjet në ZVSHP-Tropojë në përmbushje të detyrave administrative dhe funksionimit të zyrës. Në Urdhër-shpenzimin nr.373 datë 24.05.2019, nuk u konstatuan, dokumentacion justifikues si dhe faturat e blerjes së karburantit nga znj.J.E. në koherencë me lëvizjet e saj sipas datave të raportuara në autorizimet e lëshuara nga ish-titullari i DPSHP, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.36. Dhënia e 350 litra karburant me tollonë është në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qëndrës së punës, brenda venditò, për pasojë vlera prej 47,970 lekë pa TVSH, është menaxhuar jo në përputhje me aktet e mësipërme ligjore/nënligjore, duke shkaktuar efekt negativ në buxhetin e institucionit, siguruar nga Buxheti i shtetit. -Për periudhën 01.01.2020 deri në 31.08.2020, në bazë të Fletë daljeve të magazinës së DPSHP, sasia për përdorim brenda Tiranës prej 150 litra në muaj, është konsumuar duke mos paraqitur dokumentacionin argumentues dhe justifikues Fletë-udhëtime mujore, për rrjedhojë sasia prej 950 litra gazoil në vlerën prej 130,055	Fq.		DPSHP në bashkëpunim me ministrinë e Drejtësisë në cilësinë e organit qendror, të marrë masa për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për konsumin e karburantit në vlerën prej 144,926 lekë, përdorim pa efektivitet ifondeve publike, në përmbushje të misionit dhe objektivave të njësisë publike.

	lekë me TVSH, është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 & 36 dhe Urdhër nr.2477 prot datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë TR xxxT, brenda Tiranësò pika 3. -Nga institucioni i DPSHP, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.06.2021,në bazë të fletë-udhëtimit mjeti ka lëvizur brenda Tiranës duke përfshirë edhe lëvizjet në drejtim të IEVP-Vaqarr të cilat janë 1090 km ose 100 litra gazoil, ndonëse ky institucion është i mbyllur për shkak të amortizimit të godinës, kjo në bazë Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019, duke u zhvendosur në ambjentet e IEVP ñJordan Misjaò. -Gjithashtu për këtë periudhë, u konstatua se, në hartimin dhe miratimin e fletë-udhëtimeve, kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit,i cili rezultoi që në të njëjtën datë ñ*është ndodhur në dy vendndodhje të ndryshme*ô e për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit për 320 km ose 32 litra gazoil, duke lenë ñhije dyshimiò mbi mënyrën e hartimit dhe miratimit të konsumit të gazoilit për DPSHP. Sasia prej 132 litra gazoil me vlerë prej 14,871 lekë me TVSH**,** është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i shtetit. Në total, për vitet 2019, 2020 deri në 30.06.2021, vlera prej 144,926 lekë me TVSH është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i shtetit, për shkak të konsumit të karburantit, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar UMF nr.30 datë 27.12.2011ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36.			

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Bazuar në auditimin e kryer kemi konstatuar se Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit të Provës (DPSHP)Tiranë për periudhën nga 01.01.2018 deri më 30.06.2021, nuk ka vepruar në përputhshmëri në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, përmendur më poshtë tek ñBaza për opinion të kualifikuarò. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e DPSHP, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale por jo të përhapura** që justifikojnë dhënien e një opinioni **të modifikuar (kualifikuar) /cilësuar**[1].

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese. Besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

[1]Opinion i kualifikuar/i cilësuar jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mos përputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga DPSHP, e cila konsiderohet nga ana e jonë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe kemi ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit, niveli 3 (ISSAI 100-999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, të detajuara më pas në ISSAI-t e nivelit 4. Procedura e auditimit është bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 ñParimet themelore të auditimit të Përputhshmërisëò, ISSAI 4000 ñStandardet e Auditimit të Përputhshmërisëò; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; praktikat e mira që lidhen me pavarësinë dhe ISSAI 130 Kodin e Etikës së INTOSAI dhe Kodin e Etikës së KLSH-së, si dhe dokumentimi i auditimit ka shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinioni në këtë auditim përputhshmërie.

Baza për opinion të modifikuar (kualifikuar)/cilësuar.

Nga rezultatet e këtij auditimi, të cilat kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë problematikat si më poshtë:

-Mos funksionimi i Drejtorisë së Mbikqyrjes Elektronike (DME)si pasojë e problematikave të konstatuara në funksionimin e ñpajisjes së gjurmimitò deri në datën 20.09.2019, kur është zgjidhur zyrtarisht kontrata e lidhur për këtë qëllim, ka sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në lidhje me shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve të drejtorisë së ME në vlerën 14,291,182 lekë, llogaritur për periudhën tetor 2019 deri në Qershor 2021 lekë,

-Në procedurat e prokurimit publik rezultuan parregullësi dhe mangësi në drejtim të zbatimit të kontratave dhe konkretisht:

-në tenderin me objektñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò, ka vonesa në zbatimin e kontratës për të cilën penaliteti për OE ñC.ò, llogaritet në vlerën prej 9,434,247.96 lekë, etj.

-për vitet 2019, 2020 deri në 30.06.2021, rezultoi përdorimi pa efektivitet i fondeve buxhetore në vlerën prej 144,926 lekë me TVSH për konsumin e karburantit,

-Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Inspektimit & Shërbimeve Komunitare për kontrollet e ushtruara në degët rajonale rezultuan se praktikat e inspektimit/raportet e kontrollit audituara me zgjedhje, nuk janë në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 pasi:

-mungon dokumentacioni bashkëngjitur praktikës, në shumicën e rasteve paraqitja e raportit është në tejkalim të afatit të vendosur në urdhrin e inspektimit,

-konkluzionet e dala nga grupi i inspektimit, nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, pasi nuk propozohen masa disiplinore konkrete etj.

-të dhënat e dosjeve active fizike për personat në mbikqyerje, nuk janë në përputhje me dosjet aktive në formatin elektronik,

-dixhitalizimi i Shërbimit të Provës në aspektin e hedhjes në sistem të të dhënave të dosjeve fizike për personat nën mbikëqyrje është jo eficent që nga viti 2018-2020, për shkak se nuk është përdorur dhe nuk ka gjurmë dokumentare të qarta për të vërtetuar cilat kanë qenë shkaqet, nga mos përdorimi i sistemit si pasojë e mos kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes apo mos hedhja në kohë e të dhënave si pasojë e mos përdorimit të sistemit nga vetë Shërbimi i Provës.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si: Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provesò, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar bazuar në në ISSAI 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme për çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu kemi aplikuar gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.
Ne kemi identifikuar dhe përpunuar riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, kemi planifikuar dhe kemi kryer procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, kemi grumbulluar evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit.
Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.
Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të auditimit Nr.935/1, datë 14.09.2021 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.09.2021 deri në datë 17.12.2021, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (*këtu e më poshtë DPSHP*) u krye auditimi ñMbi auditimin e përputhshmërisë mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provësò për periudhën nga 01.01.2018 deri në 30.06.2021 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1.M.H. (Përgjegjës Grupi)
2.V.G. Auditues
3. A.GJ. Auditues
4. A.Z. Auditues
5. F.XH. Auditues

të cilët përgatitën këtë Raport auditimi.
Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e DPSHP.
Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt konstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren (DPSHP) me datë 14.12.2021 (*pas përfundimit të auditimit*) mes përfaqësuesve të strukturave përbërëse të DPSHP-së dhe grupit të auditimit, për të cilin u mbajt dokumenti 13 ñProtokolli i takimit përmbyllësò.Mbi bazën e

akteve të mbajtura nga KLSH është hartuar Projektraporti i cili i është dërguar subjektit. Subjekti ka bërë observacionet ndaj Projektraportit, të cilat pasi u shqyrtuan u reflektuan në këtë Raport Përfundimtar auditimi.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objekti i auditimit

Në objektivat e auditimit, përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator duke përfshirë këtu, dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DPSHP dhe drejtorive përbërese të saj dhe degëve në varësi nëse në të gjithë aspektet materiale, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi synon në vlerësimin nëse procedurat dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me legjislacionin për shërbimin e provës dhe aktet ligjore në zbatim të tij. Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të legjislacionit për shërbimin e provës dhe aktet ligjore në zbatim të tij në procesin e inspektimit dhe monitorimit dhe të mbikëqyrjes elektronike për personat nën mbikqyrje,

-dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së DPSHP Tiranë.

3.Identifikimi i çështjes.

Projektraporti mbi auditimin e përputhshmërisë në veprimtarinë e DPSHP Tiranë për periudhën 01.01.2018 deri më 30.06.2021, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

-Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e DPSHP-së Tiranë.

4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5.Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i DPSHP Tiranë dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e

KLSH-^{së}) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të legjislacionit për shërbimin e provës dhe aktet ligjore në zbatim të tij në procesin e inspektimit dhe monitorimit dhe të mbikëqyrjes elektronike për personat nën mbikqyrje,
-nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;
-nëse janë zbatuar dispozitat e akteve ligjore e nënligjore në planifikimin, zhvillimin e procedurave tenderuese dhe zbatimi i kontratave që rrjedhin nga ligji për procedurat e prokurimit publik në RSH;
-nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

6.Kriteret e vlerësimit.
Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:
-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Ligji nr.78/2020òPër organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provësò
-VKM nr.302, datë 25.3.2009 ñPër miratimin e rregullores ñPër organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e e standardeve e të procedurave për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò; Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provësò, Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 ñKodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisëò etj.
-Akte të tjera ligjore/nënligjore.

7.Standardet e auditimit.
Standardet e zbatuara nga grupi gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:
-ISSAI 100 (*Parime parimet themelore të auditimit të sektorit publik*), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
-ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë),* që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me konteksin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
-ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";*
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;
-Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñ*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";* etj.;
-Praktikat më të mira të fushës.

8.**Metodat e auditimit.**
Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, DPSHP, funksionon në zbatim të Ligjit nr.78/2020òPër organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provësò i cili promovon përfshirjen shoqërore të personave nën mbikëqyrje, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së 4 përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të posaçme.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:
a. Intervistimi-duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:
b. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9.Dokumentimi i auditimit.
Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e DPSHP-së, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projektraporti.

III.PËSHKRIMI AUDITIMIT.

1.INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.

Shërbimi i Provës është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe është organ i centralizuar, i organizuar në nivel qëndror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës (*këtu e më poshtë DPSHP*) dhe në nivel vendor nëpërmjet degëve territoriale të Shërbimit të Provës, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Misioni i Shërbimit të Provës është promovimi i përfshirjes shoqërore të personave nën mbikëqyrje,me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së 4 përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të posaçme. DPSHP përbëhet nga 3 drejtori: Drejtoria e Inspektimit&Shërbimeve Komunitare, Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike dhe Drejtoria e Financës&Shërbimeve Mbështetëse.

2.Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 .1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën nën auditim, në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, sipas komponentëve të të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Drejtuesit e njësive publike sipas legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kanë detyrimin të zbatojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe legjitimitetin në administrimin e fondeve publike dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me to.

Në zbatim të nenit 19 dhe 20 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

Nga auditimi u konstatua:
1. **"Mjedisi i kontrollit"** i cili është baza për menaxhimin e fondeve buxhetore përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.
a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.
DSHP funksionon bazuar në Ligjin nr. 78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, Vendimin nr. 302, datë 25.03.2009 ñPër miratimin e rregullores ñPër organizimin dhe fuksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò, Rregulloren e Brendshme ñMbi procedurat për dhënien e masave disiplinore për punjësit e SHPò si dhe Kodi Etik, miratuar me Urdhërin 1673, datë 01.12.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHP.
Subjekti në auditim ka të rregulluar me akt ligjor mënyrën e organizimit dhe fuksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, i cili rregullon procedurën, por nuk ka një akt/rregullore që përcakton përshkrimin e detyrave për secilin pozicion pune brenda strukturës organizative institucionale,
b) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.
Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin rregullohen në bazë të ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; i ndryshuar, Kodin e Punës në RSH, si dhe dispozitat e tjera ligjore parashikuar nga Ligji nr. 78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò.
c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka bërë planifikimin e rekrutimit për vitin 2019, ku me shkresën datë 14.12.2018 ka dërguar në Departamentin e Administratës Publike ñPlanin e nevojave për rekrutim **për vitin 2019**ò.
Ndërkohë me shkresë nr.1650 prot datë 22.11.2019 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ñ*Planifikimin e nevojave per rekrutim per vitin 2020*ò, për Drejtorinë e Përgjithshme të Sherbimit te Provesò, DPSHP ka dërguar në Departamentin e Administratës Publike ñPlanifikimin e nevojave për rekrutim **për vitin 2020**ò
Gjithashtu DPSHP i ka derguar DAP kërkesat për plotesimin e vendeve vakante në çdo rast kur ka pasur vënde të lira me anë të shkresave nr.986 prot datë 07.10.2020, nr.1010 prot 13.10.2020, nr.152 datë 08.02.2021, nr 190 prot datë 16.02.2021, nr.264 prot datë 05.03.2021, nr 265 prot datë 05.03.2021, nr.280/1 datë 12.03.2021, nr.284/1 prot datë 16.03.2021, nr.377 dhe 378 prot datë 08.04.2021, nr.513 prot datë 18.05.2021, nr.540 prot datë 25.05.2021.DAP-i ka publikuar vendet vakante dhe janë ndërmarrë procedura për plotësimin, por vakancat e krijuara vijnë pasi ka pasur dhe largime dhe dorëheqje të punonjësve.
Në DPSHP ka ushtuar inspektim edhe Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, duke u konkluduar me ñ*Raporti Përfundimtarë të mbikqyrjes së administratës të shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe paralajmerin e institucionit për të*

rregulluar gjendjen e ligjshmerisë" përcjellë pranë DPSHP me shkresë Nr411/10, datë 25.09.2018.
Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Komisioneri për mbikqyrjen e Shërbimit civil, gjatë vitit 2018 janë liruar nga detyra 66 punonjës.
DPSHP pasi ka konstatuar pavlefshmërinë absolute sipas nenit 108 te Kodit të Procedurave Administative, të akteve të emerimit/komandimit të punonjesve të emeruar në pozicione të shërbimit civil ne kundeshtim me Ligjin 152/2013 *"Për nenpunesin civil"* i ndryshuar, ka nxjerrë 55 urdhra lirimi.
Gjithashtu janë ndërprerë marrëdhëniet e punës si pasoje e mosplotësimit të kritereve për të qenë nëpunës civil për 11 punonjës.
Në zbatim të legjislacionit për MFK neni 9, pika 4/ç si dhe Manualit, Kapitulli II, pika 2.2.7 ñ*NA të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e MFK-së kanë përgjegjësi …: caktimin dhe shkarkimin e Nëpunësit Zbatues*ò.
Për vitin buxhetor 2018-2020, nga NA i njësisë DSHP, me shkresën nr. 156, datë 24.01.2018, ka nxjerrë aktin për emërimin e Znj. A.N., në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar, neni 9, pika 4/ç. Me shkresën nr. 1102, datë 04.11.2020, NA i njësisë DSHP, ka nxjerr aktin për emërimin e e Znj. H. M., në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar, neni 9, pika 4/ç.
ç) <u>Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.</u>
Në zbatim të strukturës dhe organikës së Sherbimit të Provës të miratuara nga Kryeministri me Urdhër nr.55, datë 20.04.2017, nr.149, datë 01.10.2018 dhe nr.63, datë 07.05.2020, nuk ka një rregullore që të përcaktojë detyrat funksionale që ka cdo Drejtori, sektor dhe punonjës i DPSHP.
Nga auditimi rezultoi:
Pavarësisht se DPSHP ka hartuar nje draft rregullore që përcakton detyrat funksionale që ka cdo Drejtori, sektor dhe punonjës, Ministria e Drejtesise nuk e ka miratuar ketë rregullore në kundershtim me ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò Neni 20 pika ñcò citon: strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
d) <u>Aftësitë profesionale të punonjësve.</u>
Trajnimet për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.
Nga auditimi rezultoi:
Trajnimet për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, njësia në bashkëpunim dhe nën drejtimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), për periudhën Qershor 20210-Qershor 2021, ka bërë trajnimin e personelit të DSHP. Për shkak se trajnimet janë kryer online nuk ka infomacion të saktë në lidhje me numrin e trajnimeve dhe numrin e pjesëmarrësve.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila përcakton programet e trajnimin siç kërkohet edhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm, në paragrafet ñPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreò dhe ñProfesionalizmi i stafitò, nuk ka ndjekur procesin e kryerjes së trajnimeve në kuadër të mbajtjes së evidencave.

2. ñ**Menaxhimi i Riskut**ò përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.
Nga DSHP është krijuar Regjistri i Risqeve, monitorimi i kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive.

Nga auditimi rezultoi:
Nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 të Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar, ku përcaktohet:
"Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike *përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:..identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë…"*
3. "Veprimtaritë e kontrollit".
Struktura përcakton përgjegjësitë dhe kalimin e informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Drejtori Njësisë deri te specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. Drejtori i DPSHP është njëkohësisht dhe Nëpunësi Autorizues, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 3 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar, cakton si dhe Manualit ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.7 sipas të cilit ñ*NA i njësisë shpenzuese është titullari i kësaj njësie*ò.
Delegimet e detyrave në DPSHP, bëhen me urdhër të Titullarit të Institucionit. Lidhur me delegimin e kompetencave, NA dhe NZ, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, siç parashikohet nga Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 15, si dhe Kapitulli III ñDelegimi i detyraveò, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
Nga auditimi rezultoi:
Në drejtim të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar konstatohet se nuk janë hartuar pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar, neni 18, pika 1 si dhe Manualit kap.III, pika 3.5, ku citohet:
"Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual…".
4. ñInformacioni dhe komunikimiò. Në DPSHP ka sisteme raportimi të ndryshme duke filluar nga eprori direkt deri tek titullari i institucionit në lidhje me realizimet parregullësitë apo dhe problematikat e hasura përmes komunikimit me shkrim apo në mënyrë verbale, mbledhjeve brenda institucionit etj. Shërbimi i Provës përmes dixhitalizimit të sistemit që ka bërë ka detyrimin ligjor për hedhjen e të dhënave të dosjes së personave në mbikëqyrje si dhe të dhënat statistikore që sjellin zyrat vendore.
Nga auditimi u konstatua:
Në lidhje me krijimin e regjistrit elektronik si detyrim ligjor, parashikuar nga neni 26, pika 3 e Vendimit nr. 302, datë 25.03.2009 ñPër miratimin e rregullores ñPër organizimin dhe fuksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò, për vitin 2018-2019 dhe Ligjit 78/2020 për vitin 2020 e në vijim, evidentohet që është ngritur dixhitalizimi i sistemit të shërbimit të provës, i cili është implementuar që në vitin 2015, por në periudhën 2018-2020 nuk ka funksionuar. Për 6-mujorin e parë 2021 evidentohet moshedhja në sistemin elektronik të elementëve të plotë të dosjeve aktive për personat në mbikqyrje, përgjegjësi e zyrave vendore të Shërbimit tëProvës.
Konkluzion:

Për periudhën objekt auditimi (2018-2020) në lidhje me funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm u konstatua:

***1**. Në zbatim të strukturës dhe organikës së Sherbimit të Provës të miratuar nga Kryeministri me Urdhër nr.55, datë 20.04.2017, nr.149, datë 01.10.2018 dhe nr.63, datë 07.05.2020, nuk ka rregullore që të përcaktojë detyrat funksionale të cdo drejtorie, sektori dhe punonjësve të DPSHP. DPSHP ka hartuar nje draft rregullore që përcakton detyrat funksionale që ka cdo Drejtori, sektor dhe punonjës por Ministria e Drejtësisë nuk e ka miratuar.*

***2**. Trajnimet për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, për periudhën Qershor 20210-Qershor 2021, për shkak se janë kryer on line nuk ka infomacion të saktë në lidhje me numrin e trajnimeve dhe të pjesëmarrësve.*

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka ndjekur procesin e kryerjes së trajnimeve në kuadër të mbajtjes së evidencave.

***3**. Nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 të Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar.*

***4**. Në drejtim të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar konstatohet se nuk janë hartuar pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm veprime jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" ndryshuar, neni 18, pika 1 si dhe Manualit kap.III, pika 3.5.*

***5**. Regjistri elektronik si detyrim ligjor, parashikuar nga neni 26, pika 3 e Vendimi Nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe fuksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"nuk është në funksion.*

-Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe respektimi i afateve.

-Mbajtja dhe plotësimi i dokumentacionit financiar kontabël. Analizë e debitorëve, kreditorëve, derdhje e detyrimeve fiskale etj. ndaj buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò .

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e

llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.
Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.
Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.
Rezulton se, veprimet kontabël janë përditësuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.
Pasqyrat financiare (PF) janë shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.
Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.
- <u>për vitin 2018</u> janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 527, datë 21.03.2019 ñPër dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimorò
- <u>për vitin 2019</u> janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 398, datë 24.03.2020 ñPër dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimorò
- <u>për vitin 2020</u> janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 220, datë 26.02.2021 ñPër dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimorò duke respektuar afatet ligjore.
Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117 i Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, që përcakton se;
"Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit".
Nga ana tjetër, *situacionet progresive vjetore* janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

<u>Viti 2018</u>

Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.
Totali i *ardhurave të funksionimit* në *Pasqyrën e Performancës, është i barabartë me totalin e shpenzimeve* vjetore *plus rezultatin e ushtrimit* (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2018 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 121,765 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 117,947 mijë lekë
iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)= 3,818 mijë lekë

Totali ii + iii= 121,765 mijë lekë

Llogaria 85 ñ*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*ñ në kolonën nr.100 të Bilancit (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr.132 të Formatit nr.2 ñ*Pasqyra e Performancës*ò.
Llogaria 63 ñNdryshimit të gjendjes së inventaritò në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2017 me 31.12.2018, përkatësisht 5,284,270 ï 1,466,754), rezulton e barabartë sa llogaria 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventaritò në Pasqyrën nr.2 ñ*Performanca financiare e institucionit*ò prej 3,817,516 lekë.
Nga analiza e llogarisë 2 ñ Gjendje Inventari qarkulluesò rezulton të jenë regjistruar llogaria 31 ñMaterialeò dhe 32 ñInventar imëtò.
Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2018, janë plotësuar si më poshtë:

Formati nr. 2: Performanca Financiare/Të ardhurat

Nr.	*Nr. Llogarie*	*Përshkrimi i operacioneve*	*Viti 2018*	*Viti 2017*
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**121,764,541**	**125,856,731**
53	*72*	***V.GRANTE KORENTE***	**121,764,541**	**125,856,731**
54	**720**	**1.Grant korrent i Brendshëm**	**121,764,541**	**125,856,731**
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	108,117,000	114,653,511
61	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	13,647,541	11,203,220

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2018, në vlerën 121,764,541 lekë, analizuar si më poshtë:
-Në llogarinë 72 ñGrante Korrenteò në vlerën 121,764,541 lekë, paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për DPSHP në vlerën 108,117,000 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 13,647,541 lekë.

Formati nr. 2: Performanca Financiare/Shpenzimet

Nr.	*Nr. Llogarie*	*Përshkrimi i operacioneve*	*Viti 2018*	*Viti 2017*
74	**B**	**SHPENZIMET**	**117,947,025**	**125,856,731**
75	**600**	**I. Pagat dhe perfitimet e punonjësve**	**91,744,384**	**93,799,647**
76	6001	Paga, personel i përhershëm	91,009,468	93,799,647
77	6002	Paga personel i Përkohshëm	734,916	
78	6003	Shpërblime		
79	6009	Shpenzime të tjera për personelin		
80	**601**	**II.Kontribute të Sigurimeve**	**15,239,973**	**15,593,729**
81	6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	13,687,558	14,000,913
82	6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	1,552,415	1,592,816
83	**602**	**III.Blerje mallra e shërbime**	**13,745,289**	**16,008,085**
84	602	Mallra dhe shërbime te tjera	5,724,101	4,948,566
87	6022	Shërbime nga të tretë	4,550,347	3,432,724
88	6023	Shpenzime transporti	662,702	770,046
89	6024	Shpenzime udhëtimi	802,764	1,380,735
91	6026	Shpenzime për qiramarrje	1,297,375	1,074,578
92	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		16,971
94	6029	Shpenzime te tjera operative	708,000	4,384,465
101		**V.Transferime korrente**	**1,034,895**	**455,270**
107	**605**	**2.Transferime korrente me jashtë**	**385,275**	**395,270**
108	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare	385,275	395,270

112	**606**	**3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë**	**649,620**	**60,000**
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	649,620	60,000
130	***63***	***VIII.Ndryshimi i gjendjes së inventarit***	**-3,817,516**	
131		***IX.SHPENZIME TE TJERA***	**0**	
132	***85***	**Teprica ose deficiti i periudhës**	**3,817,516**	**0**

Shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2018 janë në vlerën 117,947,025 lekë analizuar si më poshtë:
-Llogaria 600 ñPaga e shpenzime personeliò për 91,744,384 lekë, në këtë zë janë paraqitur pagat e personelit të përhershëm në vlerën 91,009,468 lekë, si dhe pagat e personelit të përkohshëm në vlerën 734,916 lekë, gjatë vitit ushtrimor 2018, gjatë muajve Janar 2018-Dhjetor 2018.
-Llogaria 601 ñKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò për 15,239,973 lekë, paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.
-Llogaria 6020 ñMallra dhe shërbime te tjeraò për 13,745,289 lekë, paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje kancelari, materiale pastrimi, si dhe materiale për funksionin e pajisjeve të zyrës.
-Llogaria 6022 ñShërbime nga të tretëtò për shumën 4,550,347 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni i ka realizuar për shërbime nga të tretët për energji elektrike në vlerën 827,243 lekë, ujë në vlerën 35,300 lekë, komunikim në vlerën 798,756 lekë, shpenzime të postës dhe shërbimit korrier në shumën 1,882,168 lekë, shpenzime për shërbime banke në shumën 6,900 lekë, si dhe shpenzime të tjera në vlerën 999,980 lekë.
-Llogaria 6023 ñShpenzime transportiò për shumën 662,702 lekë përfaqësojnë shpenzime për blerje karburant dhe vaj në vlerën 599,982 lekë, siguracion automjetesh 62,720 lekë.
- Llogaria 6024 ñShpenzime udhëtimiò për shumën 802,764 lekë përfaqësojnë shpenzimet për pagesën e biletave të udhëtimit të punonjësve, shpenzime dieta jashtë vendit në vlerën 257,324 lekë dhe shpenzime dieta brenda vendi në vlerën 545,440 lekë.
-Llogaria 6026 ñShpenzime për qiramarrjeò për shumën prej 1,297,375 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet e qirasë të zyrave vendore.
-Llogaria 6029 ñShpenzime të tjera Operativeò për shumën 708,000 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor, si: shpenzime për sigurimin e ndërtesave në vlerën prej 693,000 lekë, shpenzime për pjesëmarrje në konferenca në shumën prej 15,000 lekë.
-Llogaria 605òTë tjera transferime korrente jashtë shtetitò me vlerën 385,275 lekë.
- Llogaria 606 ñTransferta për buxhetet familjare dhe individëtò për ndihmë ekonomike në shumën prej 649,620 lekë.
-Llogaria 63 ñNdryshim i gjendjes së inventaritò me vlerën 3,817,516 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:
- Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në vlerën 13,745,289 lekë, vlerë kjo e njejtë me Aktrakordimin me Degën e Thesarit.
-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar paraqiten në vlerën 91,744,384 lekë, , vlerë kjo e njëjtë me Aktrakordimin me Degën e Thesarit.
Në thesar në muajin janar të vitit 2019 kanë kaluar pagat e dhjetor 2018, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar - Dhjetor 2018, ku vlera

e pagave Dhjetor 2018 duhet të kalojë në thesar në janar të 2019. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ò*Kontrib.të sig.shoq.e shëndetësore*ò ku nuk ka diferenca. Nga auditimit u konstatua se vlera totale e llogarisë 600 dhe 601 në Pasqyrën e Performancës Financiare, e cila përfshin pagat dhe sigurimet gjatë vitit ushtrimor 2018, nga muaji Janar 2018-Dhjetor 2018 është barabartë me vlerën totale të llogarisë 600 dhe 601 në situacionin e shpenzimeve të dorëzuar pranë Degës së Thesarit, e cila duhet të përfshijë pagat dhe sigurimet përgjatë muajve Dhjetor 2017-Nëntor 2018. Në Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò në pikën 59/a citohet ... ñ*Ky rast përbën një detyrim të shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme. Për këtë arsye, ky detyrim duhet të jetë real dhe të përfaqësojë vetëm atë pjesë të konstatuar si shpenzim në vitin që raportohet, duke qenë gjithmonë brenda fondit (grantit nga buxheti) të parealizuar të vitit ushtrimor raportues.*ò *Veprimi i mësipërm është rregulluar në pasqyrat financiare të vitit 2019.*

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Analiza e posteve kryesore të bilancit:

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2018 në *Aktivin e Bilancit Kontabël* rezulton se:

-Me datë 31.12.2018 ñAktivet afatgjataò zënë 49 % të vlerës totale të aktivit, ndërsa ñAktivet Afatshkurtraò zënë 51% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Formati nr. 1: Pasqyra e Pozicionit Financiar

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2018*	*Viti 2017*
2		**I.Aktivet Afatshkurtra**	**18,931,811**	**12,669,974**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre**	**0**	**0**
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**5,284,270**	**1,466,754**
12	31	Materiale	3,817,516	
13	32	Inventar i imët	1,466,754	1,466,754
21		**3.Llogari te Arkëtueshme**	**13,647,541**	**11,203,220**
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	13,647,541	11,203,220
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Klasa 3 ñGjendja e inventaritò, në fund të vitit 2018, rezulton në vlerën 5,284,270 lekë. Në krahasim me vitin 2017 është rritur në vlerën 3,817,516 lekë, nga rritja e zërit ñMaterialeò.
Në llogarinë 32 ñInventar i Imëtò pasqyrohet në vlerën 1,466,754 lekë.

Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve.

Llogari të arkëtueshme:

-Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetit debitorò paraqitet në vlerën 13,647,541 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka DPSHP ndaj punonjësve për muajin Dhjetor 2018, përkatësisht për pagat në vlerën 6,382,866 lekë, për tatim taksa në vlerën 511,041 lekë , për sigurime shoqërore në vlerën 1,902,035 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 263,956 lekë, si dhe shuma prej 4,111,583 lekë që përfaqëson detyrimet ndaj furnitorëve për blerje pajisjesh kompjuterike në muajin Dhjetor 2018, si dhe detyrime te pa identifikuara te vitit paraardhës në vlerën prej 476,060 lekë.
-Llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò paraqitet në shumën 0 (zero) lekë.
Më 05.04.2017 është lidhur kontratë shërbimi projektimi me objekt ñHartim i projektit për ndërtimin e shtesës anësore dhe shtesë kati për Shërbimin e Provësò ndërmjet DPSHP-së dhe Z.-06 SHPK. Me datë 06.05.2017, operatori ekonomik ka dërguar faturën tatimore të shitjes nr 28, me vlerë 828,000 lekë. Gjatë viteve 2017-2018, fatura e operatorit Z.06 SHPK., ka qenë detyrim i prapambetur, pasi shlyerja e saj është bërë me Urdhër shpenzimin nr. 827 datë 05.11.2019. Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31.12.2017 nuk janë njohur detyrimet e prapambetura. Në momentin e konstatimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të ishte kryer veprimin kontabël duke debituar llogarinë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambeturaò dhe kredituar e llogarisë 467ò Kreditorë të ndryshëmò në vlerën 828,000. Duke qenë se kjo faturë është shlyer në datë 05.11.2019, duhet të ishte njohur dhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2018 si detyrim i prapambetur.

Aktivet afatgjata

Në analizë aktivet:

Në formatin nr.1 ñAktivet e Afatgjataò në vlerën neto prej 18,337 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, ñAktive Afatgjata jo materialeò në vlerën neto 70 mijë dhe ñAktive Afatgjata materialeò në vlerën neto 18,267 mijë lekë.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2018*	*Viti 2017*
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**18,337,349**	**12,510,106**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**70,563**	**70,563**
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme	70,563	70,563
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**18,266,786**	**12,439,543**
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	5,541,718	5,541,718
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	4,192,568	205,165
53	215	Mjete Transporti	1,081,680	1,081,680
56	218	Inventar ekonomik	7,450,820	5,610,980
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 203 ñKoncesione, patenta, licenca e tjera ngjashmeò në shumën prej 70,563 lekë.
Shuma prej 70,563 lekë përfaqëson kthim fondi të pa shpenzuar sipas kontratës nr.2707 datë 13.12.2016 me objekt ñIntegrimi i të miturve në konflikt me ligjin përmes drejtësisë restaurueseò, me palë DPSHP dhe UNICEF. Kthimi i fondeve është bërë me Urdhër Shpenzimin nr.464 datë 06.10.2017. Për këtë duhet të ishte bërë veprimi kontabël duke debituar llogarinë 520 òDisponibilitete në thesarò dhe duke kredituar 203 ñKoncesione, patenta, licenca e te ngjashmeò për shumën 70,563 lekë. *Ky veprim është mbartur nga pasqyrat e vitit 2017.*

- Llogaria 212 ñNdërtime e konstruksioneò, paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën bruto prej 6,585,190 lekë, e cila përfaqëson vlerën e Ndërtesës së DPSHP.
Në ñPasqyrën e pozicionit financiarò paraqitet në vlerën neto prej 5,541,718 lekë.
- Llogaria 214 ñInstalime Teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto prej 4,192,568 lekë, ku është kontabilizuar vlera e pajisjeve elektronike .

- Llogaria 215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto prej 1,081,680 lekë dhe përfaqëson vlerën e një automjeti qe DPSHP ka në dispozicion, vlerë e cila nuk ka pësuar ndryshime nga viti paraardhës në vlerë bruto.
- Llogaria 218 ñInventar ekonomikò, paraqitet në vlerën neto prej 7,450,820 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën 1,839,840 lekë, si rezultat i blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash DPSHP.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 7/a *"Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*,ò (me koston historike) është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2018 me vlerën bruto prej 35,418 mijë leke dhe në formatin 7/b me vlerën e tyre neto prej 18,337 mijë lekë, shumë kjo e njëjtë dhe e rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1, llogaria 20 & 21 të pozicionit financiar në zërin ñAktive afatgjataò (rreshti nr.43 dhe 47 i bilancit).

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2018, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 13,647,541 lekë.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2018*	*Viti 2017*
65	B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**13,647,541**	**11,203,220**
66		I.Pasivet Afatshkurtra	13,647,541	11,203,220
67		**1. Llogari te Pagueshme**	**13,647,541**	**11,203,220**
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	4,587,643	1,580,200
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,382,866	6,728,236
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	511,041	516,580
75	435	Sigurime Shoqërore	1,902,035	1,374,725
76	436	Sigurime Shëndetësore	263,956	921,975
82	467	Kreditore te ndryshëm	0	81,504

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 401-408 ñFurnitorë e llogari te lidhura me toò në vlerën 4,587,643 lekë përfaqëson detyrime ndaj furnitorëve për pajisje kompjuterike në vlerën 4,111,583 lekë dhe detyrime të paidentifikuara nga viti paraardhës në vlerën prej 476,060 lekë.
- Llogaria 42 ñDetyrime ndaj personelitñ në vlerën 6,382,866 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2018, që paguhen në janar të vitit 2019.
-Llogaria 431 ñPersoneli dhe llogari të lidhur me toò në vlerën 511,041 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2018, që paguhen në janar të vitit 2019.
-Llogaria 435 & 436 ñSigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreñ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 1,902,035 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 263,956 lekë të muajit Dhjetor 2018, e cila likuidohet në muajin Janar 2019.

Rakordimi me pasqyrat e tjera financiare:

Për vitin 2018, pasqyra financiare e flukseve monetare si dhe pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar me të gjitha rubrikat dhe zërat përkatës në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme* ñ.

Viti 2019

Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i *ardhurave të funksionimit* në *Pasqyrën e Performancës, është i barabartë me totalin e shpenzimeve* vjetore *plus rezultatin e ushtrimit* (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2019 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 140,175 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 137,532 mijë lekë
iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)= 2,643 mijë lekë

Totali ii + iii= 140,175 mijë lekë

Llogaria 85 ñ*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*ñ në kolonën nr.100 të Bilancit (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 ñ*Pasqyra e Performancës*ò.
Llogaria 63 ñNdryshimit të gjendjes së inventaritò në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2018 me 31.12.2019, përkatësisht 5,284,270 ï 2,641,681), rezulton e barabartë sa llogaria 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventaritò në Pasqyrën nr.2, ñ*Performanca financiare e institucionit*ò prej 2,642,589 lekë.
Nga analiza e llogarisë 2 ñ Gjendje Inventari qarkulluesò rezulton të jenë regjistruar llogaria 31 ñMaterialeò dhe 32 ñInventar i Imëtò.
Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2019, janë plotësuar si më poshtë:

Formati nr. 2: Performanca Financiare/Të ardhurat

Nr.	*Nr. Llogarie*	*Përshkrimi i operacioneve*	*Viti 2019*	*Viti 2018*
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**140,174,590**	**121,764,541**
53	*72*	***V.GRANTE KORENTE***	**140,174,590**	**121,764,541**
54	**720**	**1.Grant korrent i Brendshëm**	**140,174,590**	**121,764,541**
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	121,450,008	108,117,000

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2019, në vlerën 140,174,590 lekë, analizuar si më poshtë:
-Në llogarinë 72 ñGrande Korrenteò në vlerën 140,174,590 lekë, paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për DPSHP në vlerën 121,450,008 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 18,724,582 lekë.

Formati nr. 2: Performanca Financiare/Shpenzimet

Nr.	*Nr. Llogarie*	*Përshkrimi i operacioneve*	*Viti 2019*	*Viti 2018*
75	**600**	**I.Pagat dhe përfitimet e punonjësve**	**99,166,903**	**91,744,384**
76	6001	Paga, personel i përhershëm	97,791,484	91,009,468
77	6002	Paga personel i Përkohshëm	1,375,419	734,916
80	**601**	**II.Kontribute të Sigurimeve**	**16,511,430**	**15,239,973**
81	6010	Kontributi i Sig.Shoqërore	14,875,035	13,687,558
82	6011	Kontributi i Sig.Shëndetësore	1,636,395	1,552,415
83	**602**	**III.Blerje mallra e shërbime**	**18,746,939**	**13,745,289**
84	602	Mallra dhe shërbime të tjera	3,755,088	5,724,101
87	6022	Shërbime nga të trete	4,841,945	4,550,347
88	6023	Shpenzime transporti	600,145	662,702
89	6024	Shpenzime udhëtimi	1,147,866	802,764
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	238,080	
91	6026	Shpenzime për qiramarrje	3,938,685	1,297,375
94	6029	Shpenzime të tjera operative	4,225,130	708,000
101		**V.Transferime korrente**	**464,140**	**1,034,895**
107	**605**	**2.Transferime korrente me jashtë**	**364,140**	**385,275**
108	6051	Transferime për Org.Ndërkombëtare	364,140	385,275
112	**606**	**3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë**	**100,000**	**649,620**
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e	100,000	649,620

		Org.Pusht.Vendor		
132	***85***	***Rezultati i Veprimtarisë së vitit Ushtrimor***	**2,642,589**	**3,817,516**

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2019 janë në vlerën 137,532,001 lekë analizuar si më poshtë:

-Llogaria 600 ñPaga e shpenzime personeliò për 99,166,903 lekë, në këtë zë janë paraqitur pagat e personelit të përhershëm në vlerën 97,791,484 lekë, si dhe pagat e personelit të përkohshëm në vlerën 1,375,419 lekë, gjatë vitit ushtrimor 2019, përgjatë muajve Janar 2019-Dhjetor 2019.

-Llogaria 601 ñKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò për 16,511,430 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

-Llogaria 6020 ñMallra dhe shërbime te tjeraò për 3,755,088 lekë, e cila paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje kancelari, materiale pastrimi, si dhe materiale për funksionin e pajisjeve të zyrës.

-Llogaria 6022 ñShërbime nga të tretëtò për shumën 4,841,945 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni i ka realizuar për shërbime nga të tretët për energji elektrike në vlerën 1,881,507 lekë, ujë në vlerën 44,810 lekë, komunikim në vlerën 844,295 lekë, shpenzime të postës dhe shërbimit korrier në shumën 1,722,440 lekë, shpenzime për shërbime banke në shumën 6,900 lekë, si dhe shpenzime të tjera në vlerën 341,993 lekë.

-Llogaria 6023 ñShpenzime transportiò për shumën 600,145 lekë përfaqësojnë shpenzime për blerje karburant dhe vaj në vlerën 497,697 lekë, shpenzime për pjesë këmbimi, goma dhe bateri në vlerën 58,800 lekë dhe siguracion automjetesh 61,648 lekë.

-Llogaria 6024 ñShpenzime udhëtimiò për shumën 1,147,866 lekë përfaqësojnë shpenzimet për pagesën e biletave të udhëtimit të punonjësve, shpenzime dieta jashtë vendit në vlerën 9,996 lekë dhe shpenzime dieta brenda vendi në vlerën 1,137,870 lekë.

-Llogaria 6026 ñShpenzime për qiramarrjeò për shumën prej 3,938,685 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet e qirasë të zyrave vendore.

-Llogaria 6029 ñShpenzime të tjera Operativeò për shumën 4,225,130 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor, si: shpenzime për vendimet gjyqësore në vlerën 2,784,670 lekë, shpenzime për sigurimin e ndërtesave në vlerën prej 599,500 lekë, shpenzime për pjesëmarrje në konferenca në shumën prej 840,960 lekë.

- Llogaria 605òTransferime korrente me jashtëò paraqitet në vlerën 364,140 lekë.

- Llogaria 606 ñTransferime për buxhetet familjare dhe individëtò për ndihmë ekonomike paraqitet në shumën prej 100,000 lekë.

-Llogaria 63 ñNdryshim i gjendjes së inventaritò me vlerën 2,642,589 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:

-Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Aktrakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në vlerën 18,746,939 lekë, ndërsa Aktrakordimit me Degën e Thesarit vlera është 18,786,681 lekë, ku kemi një diferencë prej 39,742 lekë vjen si rezultat diferencës së blerjeve të mallrave të muajit Dhjetor 2019 me atë të Janar 2020.

-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar paraqiten në vlerën 99,166,903 lekë, ndërsa sipas aktrakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 98,295,919 lekë, ku diferenca prej 870,984 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës Dhjetor 2019 me atë të Janar 2020.

Në thesar në muajin janar të vitit 2019 kanë kaluar pagat e dhjetor 2019, ndërsa në pasqyrën e performancës vlera e llogarisë Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar - Dhjetor 2019, ku vlera e pagave Dhjetor 2019 duhet të kalojë në thesar në Janar të 2020. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ò*Kontrib.të sig.shoq.e shëndetësore*ò ku kemi diferencë prej 129,187 lekë.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Analiza e posteve kryesore të bilancit:

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të bilanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2019 në *Aktivin e Bilancit Kontabël* rezulton se:

- Më datë 31.12.2019 ñAktivet afatgjataò zënë 45% të vlerës totale të aktivit, ndërsa ñAktivet Afatshkurtraò zënë 55% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2019*	*Viti 2018*
2		**I.Aktivet Afatshkurtra**	**21,751,945**	**18,931,811**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre**	**0**	**0**
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**2,641,681**	**5,284,270**
12	31	Materiale	1,174,927	3,817,516
13	32	Inventar i imët	1,466,754	1,466,754
21		**3.Llogari te Arkëtueshme**	**19,110,264**	**13,647,541**
32	468	Debitorë të ndryshëm	385,682	0
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	18,724,582	13,647,541
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Klasa 3 ñGjendja e inventaritò, në fund të vitit 2019, rezulton në vlerën 2,641,681 lekë. Në krahasim me vitin 2018 është ulur në vlerën 2,642,589 lekë, nga ulja e zërit ñMaterialeò në vlerën prej 2,642,589 lekë.

Llogaria 32òInventar i imëtò pasqyrohet në vlerën prej 1,466,754 lekë.

Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve.

Llogari të arkëtueshme:

- Llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò paraqitet në vlerën 385,682 lekë e cila përfaqëson 5% e garancisë së punimeve të ndërtesës.
- Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetit debitorò paraqitet në vlerën 18,724,582 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka DPSHP ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2019, përkatësisht për pagat në vlerën 7,095,235 lekë, për tatim taksa në vlerën 579,717 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 2,091,583 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 290,269 lekë, si dhe shuma prej 8,282,096 lekë e kredituar në llogarinë 401 ñFurnitorë të ndryshëmò që përfaqësojnë detyrimet ndaj furnitorëve gjatë vitit, si dhe është përfshirë vlera e garancisë së punimeve të ndërtesës në shumën 385,682 lekë.

Në llogarinë 4342 ñTë tjera operacione me shtetit debitorò është kredituar llogaria 401 ñFurnitorë të ndryshëmò në shumën totale të detyrimeve ndaj furnitorëve gjatë vitit 2019. Në

këtë llogari, duhet të përfshiheshin vetëm detyrimet për blerje pajisjesh kompjuterike në muajin Dhjetor 2019 në vlerën 2,156,286 lekë. Gjithashtu, pjesa e 5% garancisë së punimeve të ndërtesës është keqklasifikuar në këtë llogari, duke dublikuar shumën prej 385,682 lekë, njëherë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, dhe njëherë në llogarinë 4342 ñTë tjera operacione me shtetit debitorò.

<u>Aktivet afatgjata</u>

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 ñAktivet e Afatgjataò në vlerën neto prej 26,564 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, ñAktive Afatgjata jo materialeò në vlerën neto 898 mijë lekë, ñAktive Afatgjata materialeò në vlerën neto 18,337 mijë lekë, dhe ñInvestimetò në vlerën neto 7,328 mijë lekë.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2019*	*Viti 2018*
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**26,563,842**	**18,337,349**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**898,563**	**70,563**
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme	898,563	70,563
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**18,337,329**	**18,266,786**
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	5,580,577	5,541,718
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	6,939,109	4,192,568
53	215	Mjete Transporti	440,651	1,081,680
56	218	Inventar ekonomik	5,376,992	7,450,820
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
62		**4.Investime**	**7,327,950**	**0**
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale	7,327,950	

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

-Llogaria 203 ñKoncesione, patenta, licenca e tjera ngjashmeò në shumën prej 898,563 lekë, përfaqëson hartimin e projektit për ndërtimin e shtesës anësore në vlerën prej 828,000 lekë dhe 70,563 lekë. Shuma prej 70,563 lekë përfaqëson kthim fondi të pa shpenzuar sipas kontratës nr.2707 datë 13.12.2016 me objekt ñIntegrimi i të miturve në konflikt me Ligjin përmes drejtësisë restaurueseò, me palë DPSHP dhe UNICEF, veprim i cili është mbartur nga pasqyrat financiare të vitit 2017. Për këtë duhet të ishte bërë veprimi kontabël duke debituar llogarinë 520 òDisponibilitete në thesarò dhe duke kredituar 203 ò Koncesione, patenta, licenca e te ngjashmeò për shumën 70,563 lekë.

Veprimi i mësipërm është rregulluar në pasqyrat financiare të vitit 2020. Hartimi i projektit të shtesës për ndërtimin e shtesës anësore, është keqklasifikuar në llogarinë 203 ñKoncesione, patenta, licenca e tjera ngjashmeò. Shuma prej 828,000 lekë duhet të ishte njohur në llogarinë 230 ñInvestime Për Aktive Afatgjata jo materialeò, si pjesë investimit që po kryhet në vlerën prej 828,000 lekë.

-Llogaria 212 ñNdërtime e konstruksioneò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën bruto prej 6,585,190 lekë e cila përfaqëson vlerën e Ndërtesës së DPSHP.

Në ñPasqyrën e pozicionit financiarò paraqitet në vlerën neto prej 5,580,577 lekë.

-Llogaria 214 ñInstalime Teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën neto prej 6,939,109 lekë, ku është kontabilizuar vlera e pajisjeve elektronike .

-Llogaria 215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën neto prej 440,651 lekë dhe përfaqëson vlerën e një automjeti qe DPSHP ka në dispozicion, vlerë e cila ka pësuar një rënie në vlerë prej 641,029 lekë nga viti paraardhës në vlerë bruto.

-Llogaria 218 ñInventar ekonomikò, paraqitet në vlerën neto prej 5,376,992 lekë, Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën 1,075,085 lekë, si pasojë e amortizimit.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 7/a *"Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,*ò (me koston historike) është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2019

me vlerën bruto prej 37,970 mijë leke dhe në formatin 7/b me vlerën e tyre neto prej 19,236 mijë lekë, shumë kjo e njëjtë dhe e rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1, llogaria 20 & 21 të pozicionit financiar në zërin ñAktive afatgjataò (rreshti nr.43 dhe 47 i bilancit).

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2019, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 18,724,582 lekë.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2019*	*Viti 2018*
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**18,724,582**	**13,647,541**
66		**I.Pasivet Afatshkurtra**	**18,724,582**	**13,647,541**
67		**1. Llogari te Pagueshme**	**18,724,582**	**13,647,541**
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	8,282,096	4,587,643
69	42	Detyrime ndaj personelit	7,095,235	6,382,866
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	579,717	511,041
75	435	Sigurime Shoqërore	2,091,583	1,902,035
76	436	Sigurime Shëndetësore	290,269	263,956
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	385,682	
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**0**	**0**

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

-Llogaria 401-408 ñFurnitorë e llogari te lidhura me toò në vlerën 8,282,096 lekë përfaqëson detyrimet ndaj furnitorëve për blerje kancelari, pajisje kompjuterike etj.
- Llogaria 42 ñDetyrime ndaj personelitñ në vlerën 7,095,235 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2019, që paguhen në janar të vitit 2020.
- Llogaria 431 ñPersoneli dhe llogari të lidhur me toò në vlerën 579,717 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2019, që paguhen në janar të vitit 2020.
- Llogaria 435&436 ñSigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreñ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 2,091,583 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 290,269 lekë të muajit Dhjetor 2019, e cila likuidohet në muajin Janar 2020.
-Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò në shumën prej 385,682 lekë përfaqëson 5% e garancisë së punimeve të ndërtesës.

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë paraqet shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të institucionit, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.
Nga auditimi i zërave të pasqyrës rezulton se totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 151,014,382 lekë.
Nënrubrika ñAkordim fondesh buxhetore për shpenzime korrenteò që përfaqëson flukset monetare hyrëse që rrjedhin nga akordimet e fondeve buxhetore për shpenzime korrente, është e rakorduar me të dhënat e thesarit në shumën 137,900,000 lekë.
Nënrubrika ñPagesa per detyrime e shpenzime korrenteò përbëhet nga shuma e zërave si: pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara në shumën 120,814,602 lekë, dhe pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor në shumën 133,928,984 lekë.
Rubrika II, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve përbëhet nga zëra si: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale në shumën në vlerën 21,400,000 lekë dhe pagesa për detyrime të investimeve realizuar në vitet e kaluara në vlerën 5,827,243 lekë dhe pagesa për detyrime të investimeve realizuar gjatë vitit ushtrimor në vlerën 4,655,316 lekë.

Rubrika III, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk përputhet me aktrakordimin e thesarit.
Nga auditimi i zërave rezulton se *Rubrika IV* në vlerën 161,931,823 lekë, e cila përfaqëson shtimin neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës, e cila është e barabartë me shumën algjebrike të rubrikave I, II dhe III.
Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur, të cilat rezultojnë në vlerën 0.

- Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.
Totali i Fondeve sipas Pasqyrës Format 4 është i barabartë me totalin e Fondeve në Pasqyrën Format 1, por disa nga zërat e pasqyrës nuk janë plotësuar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme ñ.

Viti 2020
Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve
Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.
Totali i *ardhurave të funksionimit* në *Pasqyrën e Performancës, është i barabartë me totalin e shpenzimeve* vjetore *plus rezultatin e ushtrimit* (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2020 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 134,760 mijë lekë
_____
ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 134,684 mijë lekë
iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)= 76 mijë lekë
_____
Totali ii + iii= 134,760 mijë lekë

Llogaria 85 ñ*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*ñ në kolonën nr.100 të Bilancit (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 ñ*Pasqyra e Performancës*ò.
Llogaria 63 ñNdryshimit të gjendjes së inventaritò në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2019 me 31.12.2020, përkatësisht 2,564,795 ï 2,641,681), rezulton e barabartë sa llogaria 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventaritò në Pasqyrën nr.2, ñ*Performanca financiare e institucionit*ò prej 76,886 lekë.
Nga analiza e llogarisë 2 ñ Gjendje Inventari qarkulluesò rezulton të jenë regjistruar llogaria 31 ñMaterialeò dhe 32 ñInventar i Imëtò.
Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2020, janë plotësuar si më poshtë:

Formati nr. 2: Performanca Financiare/Të ardhurat

Nr	*Nr. llogarie*	*Përshkrimi i operacioneve*	*Viti 2020*	*Viti 2019*
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**134,760,426**	**140,174,590**
2	*70*	***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET***	**0**	**0**
53	*72*	***V.GRANTE KORENTE***	**134,760,426**	**140,174,590**
54	**720**	**1.Grant korrent i Brendshëm**	**134,760,426**	**140,174,590**
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	114,266,922	121,450,008
61	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	20,493,504	18,724,582

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2020, në vlerën 134,760,426 lekë, analizuar si më poshtë:
-Në llogarinë 72 ñGrande korrenteò në vlerën 134,760,426 lekë, paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për DPSHP në vlerën 114,266,922 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 20,493,504 lekë.

Formati nr. 2: Performanca Financiare/Shpenzimet

Nr	*Nr. llogarie*	*Përshkrimi i operacioneve*	*Viti 2020*	*Viti 2019*
	B	*SHPENZIMET*	*134,683,540*	*137,532,001*
75	**600**	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**99,622,026**	**99,166,903**
76	6001	Paga, personel i përhershëm	98,494,392	97,791,484
77	6002	Paga personel i Përkohshëm	1,127,634	1,375,419
80	**601**	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**16,544,837**	**16,511,430**
81	6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	14,904,944	14,875,035
82	6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	1,639,893	1,636,395
83	**602**	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**17,987,750**	**18,746,939**
84	602	Mallra dhe shërbime te tjera	4,955,058	3,755,088
87	6022	Shërbime nga të tretë	3,338,276	4,841,945
88	6023	Shpenzime transporti	728,979	600,145
89	6024	Shpenzime udhëtimi	482,000	1,147,866
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	107,000	238,080
91	6026	Shpenzime për qiramarrje	4,965,600	3,938,685
94	6029	Shpenzime te tjera operative	3,410,837	4,225,130
95	**603**	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
101		**V.TRANSFERIME KORENTE**	**452,041**	**464,140**
102	**604**	**1.Transferime korrente të brendshme**	**0**	**0**
107	**605**	**2.Transferime korrente me jashtë**	**365,511**	**364,140**
108	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare	365,511	364,140
112	**606**	**3.Transferime për Buxhetet familjare e Individe**	**86,530**	**100,000**
113	6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		100,000
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera Org.Pusht.Vendor	86,530	
115		**VI.SHPENZIME FINANCIARE**	**0**	**0**
130	*63*	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**76,886**	**2,642,589**
131		***IX.SHPENZIME TE TJERA***		
132	*85*	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES** ***(Rezultati i Veprimtarisë së vitit Ushtrimor)***	**76,886**	**-2,642,589**

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2020 janë në vlerën 134,683,540 lekë analizuar si më poshtë:
-Llogaria 600 ñPaga e shpenzime personeliò për 99,622,026 lekë, në këtë zë janë paraqitur pagat e personelit të përhershëm në vlerën 98,494,392 lekë, si dhe pagat e personelit të përkohshëm në vlerën 1,127,634 lekë, gjatë vitit ushtrimor 2020, përgjatë muajve Janar 2020-Dhjetor 2020.
-Llogaria 601 ñKontribute të sigurimeve shoqëroreò për 16,544,837 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.
-Llogaria 6020 ñMallra dhe shërbime te tjeraò për 4,955,058 lekë, e cila paraqet shpenzimet që institucioni ka për e cila paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje kancelari, materiale pastrimi, si dhe materiale për funksionin e pajisjeve të zyrës.
-Llogaria 6022 ñShërbime nga të tretëtò për shumën 3,338,276 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni i ka realizuar për shërbime nga të tretët për energji elektrike në vlerën 1,097,409 lekë, ujë në vlerën 44,775 lekë, komunikim në vlerën 871,972 lekë, shpenzime të postës dhe shërbimit korrier në shumën 1,317,220 lekë, shpenzime për shërbime banke në shumën 6,900 lekë.
-Llogaria 6023 ñShpenzime transportiò për shumën 728,979 lekë përfaqësojnë shpenzime për blerje karburant dhe vaj në vlerën 599,982 lekë, shpenzime për pjesë këmbimi, goma dhe bateri në vlerën 66,500 lekë dhe siguracion automjetesh 62,497 lekë.

-Llogaria 6024 ñShpenzime udhëtimiò për shumën 482,000 lekë përfaqësojnë shpenzimet për pagesën e biletave të udhëtimit të punonjësve, shpenzime dieta brenda vendi.
-Llogaria 6026 ñShpenzime për qiramarrjeò për shumën prej 4,965,600 lekë.
-Llogaria 6029 ñShpenzime të tjera operativeò për shumën 3,410,837 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor, si: shpenzime për vendimet gjyqësore në vlerën 2,547,072 lekë, shpenzime për sigurimin e ndërtesave në vlerën prej 799,700 lekë, shpenzime për tatim taksa në shumën prej 64,065 lekë.
-Llogaria 605òTë tjera transferime korrente jashtë shtetitò me vlerën 365,511 lekë.
-Llogaria 606 ñTransferta për buxhetet familjare dhe individëtò për ndihmë ekonomike në shumën prej 86,530 lekë.
-Llogaria 63 ñNdryshim i gjendjes së inventaritò me vlerën 76,886 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.
Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:
-Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Aktrakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në vlerën 17,987,750 lekë, ndërsa Aktrakordimit me Degën e Thesarit vlera është 17,987,750 lekë, ku nuk kemi diferenca.
-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar paraqiten në vlerën 99,622,026 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 99,366,294 lekë, ku diferenca prej 255,732 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2020 me atë të janar 2021.
Në thesar në muajin janar të vitit 2020 kanë kaluar pagat e dhjetor 2019, ndërsa në pasqyrën e performancës vlera e llogarisë ñPaga, përfitime të punonjësveò është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2020, ku vlera e pagave Dhjetor 2020 duhet të kalojë në thesar në janar të 2021. Në llogarinë 601 ò*Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore*ò, nuk kemi diferenca nga pasqyra e performancës me Aktrakordimin e thesarit.

Titulli i Gjetjes:	Mospasqyrim i saktë në Aktrakordimin e thesarit të llogarisë 601ñKontribute të Sigurimeveò
Situata:	Nga auditimi u konstatua se vlera totale e llogarisë 601 òKontribute të sigurimeve shoqëroreò në Pasqyrën e Performancës Financiare, e cila përfshin sigurimet gjatë vitit ushtrimor 2020, nga muaji Janar - Dhjetor 2020 është barabartë me vlerën totale të llogarisë 601 në Aktrakordimin dorëzuar pranë Degës së Thesarit, e cila duhet të përfshijë sigurimet përgjatë muajve Dhjetor 2019-Nëntor 2020, të likuiduara në bankë gjatë vitit 2020. Në Udhëzimin e MFE me nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò në pikën 59/a citohet ... ñ*Ky rast përbën një detyrim të shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme. Për këtë arsye, ky detyrim duhet të jetë real dhe të përfaqësojë vetëm atë pjesë të konstatuar si shpenzim në vitin që raportohet, duke qënë gjithmonë brenda fondit (grantit nga buxheti) të parealizuar të vitit ushtrimor raportues.*ò Vlera e llogarisë 601 në Aktrakordimin me thesarin duhet të paraqitej: (Sigurimet shoqërore/shëndetësore Janar-Dhjetor 2020 minus Sigurimet shoqërore/shëndetësore Dhjetor 2020 plus Sigurimet shoqërore/shëndetësore 2019) *16,544,837-2,236,981+2,381,852 = 16,689,708 lekë.*
Kriteri:	Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018ñ*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò
Ndikimi/Efekti:	Mosparaqitje e saktë e llogarisë 601 òKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò në

	Aktrakordimin e thesarit.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës së DPSHP-së të marrë masa në vijimësi për paraqitjen e saktë të llogarisë 601 ñKontribute të sigurimeve shoqëroreò në aktrakordimin me thesarin.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Analiza e posteve kryesore te bilancit:

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të bilanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2020 në *Aktivin e Bilancit Kontabël* rezulton se:

- Më datë 31.12.2020 ñAktivet afatgjataò zënë 40% të vlerës totale të aktivit, ndërsa ñAktivet Afatshkurtraò zënë 60% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2020*	*Viti 2019*
2		**I. Aktivet Afatshkurtra**	**33,809,342**	**21,751,945**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre**	**0**	**0**
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**2,564,795**	**2,641,681**
12	31	Materiale	1,098,041	1,174,927
13	32	Inventar i imët	1,466,754	1,466,754
21		**3.Llogari te Arkëtushme**	**20,493,504**	**19,110,264**
32	468	Debitorë te ndryshëm	385,682	385,682
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	20,107,822	18,724,582
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**10,751,043**	**0**
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	10,751,043	

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

Klasa 3 ñGjendja e inventaritò, në fund të vitit 2020, rezulton në vlerën 2,564,795 lekë. Në krahasim me vitin 2019 është ulur në vlerën 76,886 lekë, nga ulja e zërit ñMaterialeò në të njëjtën vlerë.

Llogaria 32 ñInventar i imëtò pasqyrohet në vlerën prej 1,466,754 lekë.

Detyrimet e prapambetura

Llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò paraqitet në shumën 10,751,043 lekë, e cila detyrimeve të prapambetura për investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve, të cilat i përkasin periudhës 2019-2020.

Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë:

-në vitin 2016 në shumën prej 456,440 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2019;

-në vitin 2017 në shumën prej 471,482 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2019 dhe 2021;

nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për tû shlyer.

1. Si pasojë, llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2018 - 2020. Ky zë reflektohet me vlerë 0 (zero) lekë sa

i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet.
2. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*ò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 34 dhe 42.
3. Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPSHP për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
(Trajtuar më hollësisht në pikën e vendimeve gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës)

<u>Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve.</u>
<u>Llogari të arkëtueshme:</u>
-Llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò në vlerën 385,682 lekë, e cila përfaqëson 5% e garancisë së punimeve.
-Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetit debitorò paraqitet në vlerën 20,107,822 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka DPSHP ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2020, përkatësisht për pagat në vlerën 6,596,312 lekë, për tatim taksa në vlerën 523,486 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 1,964,367 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 272,614 lekë, si dhe shuma prej 10,751,043 lekë është shuma e detyrimeve të prapambetura. Në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò u konstatua debitimi i shumës prej 10,751,043 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Kjo shumë është debituar dy herë, njëherë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, njëherë në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò.

Titulli Gjetjes:	Mospasqyrim i saktë në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò
Situata:	Nga auditimi i llogarisë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò u konstatua debitimi i shumës prej 10,751,043 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Kjo shumë është debituar dy herë, njëherë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, njëherë në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò dhe kredituar dy herë, njëherë llogarinë 4341ò Operacione me shtetin (detyrime)ò për 10,751,043 lekë, si dhe llogarinë 101 ñTeprica/Deficiti i akumuluarò për të njëjtën shumë. Llogaria 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò dhe kreditohet llogaria 7206 òFinancim i pritshëm nga buxhetiò. Shuma prej 10,751,043 lekë e debituar në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò dhe kredituar në llogarinë 101 ñTeprica/Deficiti i akumuluarò është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është dublikuar, duke mos dhënë paraqitje të saktë të detyrimeve të prapambetura.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së

	Përgjithshmeò
Ndikimi/Efekti:	Mosparaqitje e saktë e llogarisë së të drejtave
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së DPSHP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 10,751,043 lekë, e cila është njohur dy herë në pasqyrat financiare.

Aktivet afatgjata

Në analizë aktivet:

Në formatin nr.1 ñAktivet e Afatgjataò në vlerën neto prej 22,844 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, ñAktive Afatgjata materialeò në vlerën neto 15,516 mijë lekë dhe ñInvestimetò në vlerën neto 7,328 mijë lekë.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2020*	*Viti 2019*
42		**II.Aktivet Afatgjata**	**22,844,253**	**26,563,842**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**898,563**
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme	0	898,563
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**15,516,303**	**18,337,329**
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	5,514,158	5,580,577
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	5,238,912	6,939,109
53	215	Mjete Transporti	352,508	440,651
56	218	Inventar ekonomik	4,410,724	5,376,992
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
62		**4.Investime**	**7,327,950**	**7,327,950**
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale	7,327,950	7,327,950

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 230ò Për Aktive Afatgjata jo materialeò paraqitet në vlerën 0(zero) lekë. Më 05.04.2017 është lidhur kontratë shërbimi projektimi me objekt ñ*Hartim i projektit për ndërtimin e shtesës anësore dhe shtesë kati për Shërbimin e Provës*ò ndërmjet DPSHP-së dhe Z.-06 shpk. Me datë 06.05.2017, operatori ekonomik ka dërguar faturën tatimore të shitjes nr. 28, me vlerë 828,000 lekë. Gjatë vitit 2017 dhe 2018, fatura e operatorit Z.-06 shpk, ka qenë detyrim i prapambetur, pasi shlyerja e është bërë me Urdhër shpenzimin nr. 827 datë 05.11.2019.

Titulli Gjetjes:	Mos pasqyrimi në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 230 òPër Aktive Afatgjata jo materialeò
Situata:	Nga verifikimi analitik i llogarive të aktiveve afatgjata, konstatohet se zëri *230 "Për Aktive Afatgjata jo materiale"* është kontabilizuar në vlerën 0 (zero) lekë. Më 05.04.2017 është lidhur kontratë shërbimi projektimi me objekt ñ*Hartim i projektit për ndërtimin e shtesës anësore dhe shtesë kati për Shërbimin e Provës*ò ndërmjet DPSHP-së dhe Z.-06 shpk. Me datë 06.05.2017, operatori ekonomik ka dërguar faturën tatimore të shitjes nr. 28, me vlerë 828,000 lekë. Gjatë vitit 2017 dhe 2018, fatura e operatorit Z.-06 shpk, ka qenë detyrim i prapambetur, pasi shlyerja e është bërë me Urdhër shpenzimin nr. 827 datë 05.11.2019. Vlera prej 828,000 lekë ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale, të cilat në momentin e konstatimit si investim nga DPSHP duhet të ishin klasifikuar dhe regjistruar në zërin 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò duke kryer veprimin kontabël: debitimin e llogarisë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò dhe kreditimin e llogarisë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò. Në momentin e pagimit të shpenzimeve duhet të ishte bërë veprimi kontabël duke debituar llogarinë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshme dhe kredituar llogarinë 520 òDisponibilitete në thesarò. Keqklasifikimi i regjistrimit kontabël ka

	bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò si dhe nënvlerësimin e llogarisë 520 òDisponibilitete në thesarò në shumën 828,000 lekë.Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ñ i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i gjendjen e aktiveve, e cila ka çuar në nënvlerësimin e llogarisë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò si dhe nënvlerësimin e llogarisë 520 òDisponibilitete në thesarò në shumën 828,000 lekë.
Shkaku:	Keqklasifikim i regjistrimit kontabël nga DPSHP-ja të aktiveve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të DPSHP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 828,000 lekë, në llogarinë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò dhe të mbahet në këtë llogari deri në momentin e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim të ñ*Ndërtimit të shtesës anësore dhe të shtesës së kati për Shërbimin e Provës*ò. Pasi DPSHP të marrë në dorëzim këtë investim, nga financa të bëhet veprimi kontabël dukë kredituar llogarinë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò dhe debituar llogarinë 212 ò*Ndërtesa dhe Konstruksione*ò.

-Llogaria 212 ñNdërtime e konstruksioneò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën bruto prej 5,580,577 lekë e cila përfaqëson vlerën e ndërtesës së DPSHP.
Në ñPasqyrën e pozicionit financiarò paraqitet në vlerën neto prej 5,514,158 lekë.
Vlera e amortizimit të akumuluar të llogarisë 212 ñNdërtime e konstruksioneò nuk është përllogaritur saktë ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2020, duke e mbivlerësuar këtë llogari në vlerën 534,936.5 lekë.
-Llogaria 214 ñInstalime teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 5,238,912 lekë.
-Llogaria 215 ñMjete transportiò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 440,651 lekë dhe përfaqëson vlerën e një automjeti qe DPSHP ka në dispozicion, vlerë e cila ka pësuar një rënie në vlerë prej 352,508 lekë nga viti paraardhës.
Vlera e amortizimit të akumuluar të llogarisë 215 ñMjete transportiò, nuk është përllogaritur saktë ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2020, duke e mbivlerësuar këtë llogari në vlerën 100,679.49 lekë.

Titulli i Gjetjes:	Mosparaqitje e saktë e amortizimit të akumuluar
Situata:	- Gjatë auditimit të pasqyrave financiare konstatohet se për llogarinë 212òNdërtesa dhe konstruksioneò dhe 215 ñMjete transportiò, vlera e amortizimit të akumuluar nuk është përllogaritur saktë ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2020. ***Plani i saktë i amortizimit të ndërtesës paraqitet si më poshtë:***

Viti	Kosto fillestare	Dt e shpenzimeve kapitale	Shpenzime kapitale qe rrisin vleren e aktivit	Vlera kontabel neto	Amortizimi i vitit	Amortizimi i akumuluar	Vlera e mbetur
2009	4,942,561			4,942,561	37,069.21	37,069.21	4,905,491.79
2010				4,942,561	49,425.61	86,494.82	4,893,135.39
2011				4,942,561	49,425.61	135,920.43	4,893,135.39
2012				4,942,561	49,425.61	185,346.04	4,893,135.39
2013				4,942,561	49,425.61	234,771.65	4,893,135.39
2014				4,942,561	49,425.61	284,197.26	4,893,135.39
2015		11.05.2015	950,100	5,892,661.00	58,926.61	343,123.87	5,833,734.39
2016				5,892,661.00	58,926.61	402,050.48	5,833,734.39
2017				5,892,661.00	58,926.61	460,977.09	5,833,734.39
2018				5,833,734.39	291,686.72	752,663.81	5,542,047.67
2019		11.06.2019	946,380	6,488,427.67	300,761.88	1,053,425.69	5,241,285.79
2020				5,241,285.79	262,064.29	1,315,489.98	4,979,221.50

Plani i saktë i amortizimit të mjetit të transportit paraqitet si më poshtë:

Viti	Kosto fillestare		Shpenzime kapitale qe rrisin vleren e aktivit	VKN	Amortizimi i vitit	Amortizimi i akumuluar	Vlera e mbetur
2010	1,674,000			1,674,000.00	231,012.00	231,012.00	1,442,988.00
2011				1,442,988.00	199,132.34	430,144.34	1,243,855.66
2012				1,243,855.66	171,652.08	601,796.42	1,072,203.58
2013				1,072,203.58	147,964.09	749,760.52	924,239.48
2014				924,239.48	127,545.05	877,305.57	796,694.43
2015		21.12.2015	240,000.00	1,036,694.43	143,063.83	1,020,369.40	893,630.60
2016				893,630.60	123,321.02	1,143,690.42	770,309.58
2017				770,309.58	106,302.72	1,249,993.14	664,006.86
2018				664,006.86	132,801.37	1,382,794.51	531,205.49
2019				531,205.49	106,241.10	1,489,035.61	424,964.39
2020				424,964.39	84,992.88	1,574,028.49	339,971.51

Përllogaritja jo e saktë e amortizimit ka mbivlerësuar llogarinë 212 ñNdërtime e konstruksioneò në vlerën 534,936.5 lekë dhe llogarinë 215 ñMjete transportiò në vlerën 100,679.49 lekë.

-Amortizimi i aktiveve është përllogaritur sipas Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò pika 36; ku nga DPSHP përllogaritja është bërë për aktivet në total dhe jo për secilin aktiv më vete***, duke sjellë vështirësi në përcaktimin e vlerave reale të aktiveve (për artikull) që institucioni disponon.***

Kriteri:	Udhëzimi nr. 30 i MFE, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò; SKK5 ñ*AAGJ materiale dhe jomaterialeò*.
Ndikimi/Efekti:	Mungese raportimi të saktë dhe përkatës të zërit 212 dhe 215 në pasqyrat financiare duke mbivlerësuar llogarinë 212 ñNdërtime e konstruksioneò dhe llogarinë 215 ñMjete transportiò.
Shkaku:	Mungesë e akumuluar e raportimit në pasqyra financiare e amortizimit përkatës në vite.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për evidentimin e saktë aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël, duke u analizuar arsyet dhe lidhur rezultatet e nxjerra me aktivet përkatëse, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore në fuqi.

-Llogaria 218 ñInventar ekonomikò, paraqitet në vlerën neto prej 4,410,724 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën 1,075,085 lekë, si pasojë e amortizimit.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr.7/a *"Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*,ò (me koston historike) është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2020 me vlerën bruto prej 18,700 mijë leke dhe në formatin 7/b me vlerën e tyre neto prej 15,516

mijë lekë, shumë kjo e njëjtë dhe e rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1, llogaria 20 & 21 të pozicionit financiar në zërin ñAktive afatgjataò (rreshti nr.43 dhe 47 i bilancit).

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2020, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 20,493,504 lekë.

Nr.	*Ref. Llogarive*	*Emërtimi*	*Viti 2020*	*Viti 2019*
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**20,493,504**	**18,724,582**
66		**I.Pasivet Afatshkurtra**	**20,493,504**	**18,724,582**
67		**1. Llogari te Pagueshme**	**20,493,504**	**18,724,582**
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to		8,282,096
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,596,312	7,095,235
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	523,486	579,717
75	435	Sigurime Shoqërore	1,964,367	2,091,583
76	436	Sigurime Shëndetësore	272,614	290,269
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	385,682	385,682
82	467	Kreditore te ndryshëm		
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	10,751,043	
91		**II.Pasivet Afatgjata**	**0**	**0**

Burimi: DPSHP, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 42 ñDetyrime ndaj personelitñ në vlerën 6,596,312 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2020, që paguhen në janar të vitit 2021.
- Llogaria 431 ñPersoneli dhe llogari të lidhur me toò në vlerën 523,486 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2020, që paguhen në janar të vitit 2021.
- Llogaria 435 & 436 ñSigurime shoqërore dhe shëndetësoreñ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 1,964,367 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 272,614 lekë të muajit Dhjetor 2020, e cila likuidohet në muajin Janar 2021.
-Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò në shumën prej 385,682 lekë përfaqëson 5% e garancisë së punimeve të ndërtesës.
-Llogaria 4341 ñOperacione me shtetin (detyrime)ò në shumën 10,751,043 lekë përfaqëson detyrimet për kreditorë, përkatësisht:

Nr	*Emri i Kreditorit*	*Data e faturës*	*Shuma*
1.	C. shpk	14.09.2020	10,436,115
2.	D. shpk	06.12.2019	288,000
3.	2-RSH shpk	23.12.2020	26,928
	TOTAL		*10,751,043*

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë paraqet shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të institucionit, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Nga auditimi i zërave të pasqyrës rezulton se totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i barabartë me shumën e totalit të zërit akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 140,970,000 lekë.

Rubrika II, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve përbëhet nga zëra si: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale në shumën në vlerën 500,000 lekë dhe pagesa për detyrime të investimeve realizuar gjatë vitit ushtrimor në vlerën 332,618 lekë dhe vlera prej167,382 lekë, e cila përfaqëson transferta në buxhetin e shtetit për fonde të papërdorura për investimin, e cila është keqklasifikuar në zërin dividentë të paguar.

Rubrika III, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk përputhet me aktrakordimin e thesarit.

Nga auditimi i zërave rezulton se *Rubrika IV* në vlerën 140,970,000 lekë, e cila përfaqëson shtimin neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës, e cila është e barabartë me shumën algjebrike të rubrikave I, II dhe III.
Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur, të cilat rezultojnë në vlerën 0.

- <u>Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.</u>
Totali i fondeve sipas Pasqyrës Format 4 është i barabartë me totalin e fondeve në Pasqyrën Format 1, por disa nga zërat e pasqyrës nuk janë plotësuar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme* ñ.

Titulli i Gjetjes:	Mospasqyrim i saktë i pasqyrës së flukseve monetare dhe pasqyrës së ndryshimeve të aktiveve neto
Situata:	-Në pasqyrën e flukseve monetare ka një raportim të pasaktë për sa i përket rubrikës II në vlerën prej 167,382 lekë, e cila përfaqëson transferta në buxhetin e shtetit për fonde të papërdorura për investimin është keqklasifikuar në zërin dividentë të paguar. Gjithashtu rubrika III, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk përputhet me aktrakordimin e thesarit. - Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në nga burimet e brendshme. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme*ò.Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018ñ*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò
Ndikimi/Efekti:	Mosparaqitje e saktë e flukseve monetare dhe ndryshimeve të aktiveve neto
Shkaku:	Zbatim jo i saktë i ligjit të kontabilitetit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së DPSHP-së të marrë për sistemimin e diferencave të konstatuara në zërat e pasqyrës së flukseve monetare dhe ndryshimeve të aktiveve neto të vitit 2020.

2.2 Auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë dhe arkë, inventarizimi i pronës.
-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera përmes bankës, arkës në lekë dhe valutë.

Në zbatim të pikës nr. 2.2 të programit të auditimit nr. 935/1 Prot., datë 14.09.2021, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare ;
- Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë viteve 2018-2021 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Drejtorinë e Përgjithshme të

Shërbimit të Provës rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, te Udhëzimit te Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 janë në vlerën totale 75,563,006 lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë në vlerën totale 143,911,604 lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë në vlerën totale 134,683,541 lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2021-30.06.2021 janë në vlerën totale 61,232,153 lekë;

Urdhër shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*ò veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues*, *Dokumente vërtetues*, *Dokumente të kontabilitetit, etj.*
Nga auditimi rezultoi:
-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.
- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dokumentet autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.
- Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë u përdorën teknikat e auditimit si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

<u>Tejkalimi i afatit 30 ditor të likuidimit të faturave</u>
Detyrimet e prapambetura vijojnë të jenë problem për financat publike. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të viteve të kaluara për kontratë / marrëveshje / vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke mos prodhuar pasqyrim real të realizimit të buxhetit vjetor, pasi përfshihen pagesa për shërbime dhe të mira që janë realizuar në vitet e mëparshme buxhetore.
Grupi i auditimit me zgjedhje kreu testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. Në ligjin Nr.48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*ò neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikohet që *kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e*

aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.

Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor**.** Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për ñMenaxhimin e Sistemit Buxhetorò si dhe ligjin nr.48/2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtareò neni 7, si më poshtë:

Urdhër shpenzime					Përfitues
Nr.	**Datë**	**Fatura**	**Përshkrimi**	**Vlera totale (lekë)**	
14	16.02.2018	30.11.2017	Likuidim Fat Postare Pukë	1,995	Posta Shqiptare Sh.a
15	16.02.2018	30.11.2017	Likuidim Fat Postare Shkodër	10,360	Posta Shqiptare Sh.a
16	16.02.2018	30.11.2017	Likuidim Fat Postare Krujë	2,910	Posta Shqiptare Sh.a
24	16.02.2018	30.09.2017	Likuidim Fat Postare Kukës	6,564	Posta Shqiptare Sh.a
755	18.12.2018	02.10.2018	Likuidim Qira Objekti	12,825	Trajtimi i studenteve sh.a
365	28.05.2020	26.03.2020	Likuidim Fat Postare Tiranë	1,008	Posta Shqiptare Sh.a

Nga tabela e mësipërme rezulton:

a.Tejkalim të afateve që parashikon ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : ñ*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së",*

dhe si pasojë

b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).

Titulli gjetjes:	Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave
Situata:	Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për ñMenaxhimin e Sistemit Buxhetorò si dhe Ligji nr.48/2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtareò neni 7 në 6 urdhër shpenzime, në shumën totale prej 35,662 lekë , duke sjellë: a.Tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, neni 52 (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura)
Kriteri:	Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhurató i ndryshuar, nenit 33; Ligji nr.48/2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtareò neni 7
Ndikimi/Efekti	Mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura
Shkaku:	Mungesë e fondeve buxhetore në dispozicion
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Nëpunësi Zbatues i DPSHP të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-ik, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

-Inventarizimi i pronës, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Inventarizimi i vitit 2018

Nga auditimi u konstatua se DPSHP për vitin 2018, ka ngritur komisionin me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 4060 datë 31.12.2018 ñ*Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Shërbimit të Provës për vitin 2018*ò dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Komisioni i inventarizimit përbehet nga 4 anëtarë, përkatësisht:

1.A.N. ï Drejtor në Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse;
2.E.D. ï Specialist IT;
3.H.M. ï Specialiste Finance në Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse;
4.D.T. - Specialiste në Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare.

Komisioni në përbërje të tij ka patur Drejtorin dhe Specialistin e Financës e Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në këtë proces nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar ku citohet...

82.ñ*Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi*ò.

Gjithashtu veprimet e mësipërme të vendosjes së drejtuesit dhe specialistit të financës në komisionin e inventarizimit, bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, Neni 22, ku citohet:...*3.b ñndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave".*

Titulli i gjetjes:	Ekzistenca e konfliktit të interesit përgjatë kryerjes së inventarizimit.
Situata:	Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u konstatua se në Urdhrin nr. 4060 datë 31.12.2018 ñ*Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Shërbimit të Provës për vitin 2018*ò, komisioni i inventarizimit përbehet nga 4 anëtarë:1.A.N.ï Drejtor në Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse;2.E.D. ï Specialist IT;3.H.M.ï Specialiste Finance në Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse; 4.D.T.- Specialiste në Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare. Në përbërje të Komisioni ka qënë dhe Drejtori dhe Specialisti i Financës e Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në këtë proces nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar ku citohet... 82.ñ*Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi*ò. Gjithashtu veprimet e mësipërme të vendosjes së drejtuesit dhe specialistit të financës në komisionin e inventarizimit, bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 22, pika 3/b ñ*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave".*
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:	Anëtërët e komisionit të inventarizimit në kushtet e konfliktit të interesit.
Shkaku:	Mangësi në procesin e inventarizimit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPSHP të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Me shkresën nr.345 datë 22.02.2019 me lëndë ñRaport mbi inventarizimin fizik në DPSHP dhe ZVSHP për vitin 2018ò, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar se nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet, të mallrave në magazinë dhe në përdorim.
Grupi i auditimit ka konstatuar se gjatë periudhës objekt auditimi, nuk është ngritur asnjë komision për vlerësimin e aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit, në raportin përfundimtar, janë evidentuar aktive të dëmtuara.
Në kundërshtim me udhëzimin e ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPë*r menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*ò, i ndryshuar ku citohet se... *95.ñProcesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi është një proces që kryhet gjate ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale."*
Duke qenë se nuk është ngritur një komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve.
Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit dhe rrjedhimisht të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve qe nuk kanë destinacion tjetër.
Për vitin 2018
-ñNdërtime e konstruksioneò (llog. 212) paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën prej 6,585,190 lekë, e përbërë nga vlera e godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.
- Llogaria 215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën prej 1,914,000 lekë dhe përfaqëson vlerën e një automjeti në dispozicion.
- Llogaria 218 ñInventar ekonomikò paraqitet në vlerën prej 9,237,070 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit, si rezultat i blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash DPSHP.

Në formatin nr. 1 ñGjendja Inventaritò për vitin 2018 në vlerën 5,284,270 lekë janë të pasqyruara sipas zërave dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

28	Klasa 3	I. Gjendja e Inventarit	Viti 2018
			5,284,270 lekë
29	31	Materiale	3,817,516 lekë
30	32	Inventar i imët	1,466,754 lekë

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Llogaria 31òMaterialeò paraqitet në vlerën prej 3,817,516 lekë.
Llogaria 32 ñInventar i imëtò paraqitet në vlerën prej 1,466,754 lekë referuar inventarit më 31.12.2018 dhe përfaqëson gjendjen e materialeve kancelari.

Inventarizimi i viteve 2019 dhe 2020

Nga auditimi u konstatua se përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2019 dhe 2020, DPSHP nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në bazë të të cilit të evidentohej gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, ku

citoheté 74.*"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."*

Për vitin 2019, është ngritur komisioni i inventarizimit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1729 datë 12.12.2019 ñPër ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Shërbimit të Provës për vitin 2019ò. Ky komision ka patur për detyrë kryerjen e inventarizimit për magazinën e në fund të tij nuk ka patur një datë të përfundimit të procesit apo formulimin e një relacioni.

Me shkresën nr. 378 prot. datë 18.03.2020 me lëndë ñInformacion mbi Inventarizimin Fizik në DPSHP dhe ZVSHP për vitin 2019ò, komisioni i inventarizimit shprehet se është kryer inventarizimi fizik në DPSHP dhe disa ZVSHP, por për shkak të situatës të shkaktuar nga pandemia Covid-19, nuk është kryer inventarizimi fizik në të gjitha Zyrat Vendore.

Komisioni nuk ka bërë përmbledhje në një relacion përshkrues të gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Neni 15 ku citohet ... 1.*"Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit*ò dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshmeò, ku citohet... 30.ñ*Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet*ò.

Titulli i gjetjes:	Inventarizimi i pronës shtetërore dhe magazina
Situata:	Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon: -Për vitin 2018 është ngritur komisionin me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 4060 datë 31.12.2018 ñ*Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Shërbimit të Provës për vitin 2018*ò dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. - Për vitin 2019, është ngritur komisioni i inventarizimit urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1729 datë 12.12.2019 ñPër ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Shërbimit të Provës për vitin 2019ò, por procedurat e inventarizimit *nuk rezultojnë të finalizuara*, pasi nuk ka patur një datë të përfundimit të procesit apo formulimin e një relacioni. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, Pika 74, ku citoheté *"Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."* -Për vitin 2020 DPSHP nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në bazë të të cilit të evidentohej gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël. Grupi i auditimit ka konstatuar se gjatë periudhës objekt auditimi, nuk është

	ngritur asnjë komision për vlerësimin e aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit, në raportin përfundimtar të vitit 2018 janë evidentuar aktive të dëmtuara. Duke qenë se nuk është ngritur një komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit dhe rrjedhimisht të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve qe nuk kanë destinacion tjetër.
Kriteri:	-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";* - Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";* -Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.*2018 " Procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme."* -Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e plotë e pozicion financiar dhe risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-DPSHP të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit, të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj; -Titullari i institucionit të DPSHP-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komision i inventarizimit, të nxjerrë urdhrat për ngritjen e komision për vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Regjistri i aktiveve.

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të DPSHP, u konstatua se institucioni ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Vlera e amortizimit të akumuluar të aktiveve nuk është plotësuar për të gjithë vitet radhazi, nëpërmjet të cilës bëhet verifikimi i vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar te shpenzimeve te mirëmbajtjes së tyre etj, si një faktor i rëndësishëm për miradministrim dhe mirë menaxhimin e aktiveve në pronësi. Regjistri nuk është hartuar varësi të llojit të aktiveve, si dhe grupit përkatës brenda llojit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar, citohet...

*26."Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar*ò;

*28.*ñ*Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë*ò;

30. ñ*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes,*

vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia."

Titulli i gjetjes:	Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh
Situata:	Nga auditimi i regjistrit të aktiveve u konstatua se DPSHP ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Vlera e amortizimit të akumuluar të aktiveve nuk është plotësuar për të gjithë vitet radhazi, nëpërmjet të cilës bëhet verifikimi i vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar te shpenzimeve te mirëmbajtjes së tyre etj. si një faktor i rëndësishëm për miradministrim dhe mirë menaxhimin e aktiveve në pronësi. Regjistri nuk është hartuar varësi të llojit të aktiveve, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* pika 26, 28, 30.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e plotë e pozicion financiar
Shkaku:	Mungesa e nxjerrjes së një regjistri të plotë të aktiveve
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPSHP të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor.

-Prokurimi fondeve publike, zbatimi i kontratave, blerjet e vogla.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, në bazë të regjistrave të parashikimit dhe ato të realizimit që i përkasin periudhës nën auditimin, të cilat paraqitur brenda afateve sipas viteve buxhetore të dërguara on-line, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) në bazë të ndryshimeve të pësuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò neni 4 dhe neni 7/2, i ndryshuar dhe ka realizuar vetëm procedura me blerje të vogël të cilat kanë si objekt, blerje karburanti, riparim dhe shërbim automjeti, sigurim i godinës dhe sigurim automjeti, ndërsa procedurat me objekt blerje kancelarie për zyrë realizohen nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) dhe blerjeve pajisje IT, bojë për printer realizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Për vitin 2018, bazuar në rregjistrin e realizimit të prokurimeve, janë realizuar 4 procedura me blerje të vogël me vlerë të fondit limit prej 2,800,000 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate prej 1,824,786 lekë pa TVSH.

Për vitin 2019, bazuar në rregjistrin e realizimit të prokurimeve, janë realizuar 7 procedura me blerje të vogël me vlerë të fondit limit prej 1,610,000 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate në vlerën prej 1,382,204 lekë pa TVSH si dhe janë realizuar 2 procedura vetëm lidhje dhe zbatim kontratë duke paguar vlerën prej **3**,019,529 lekë pa TVSH (1 procedurë është realizuar pranë AKSHI dhe 1 pranë ABP).

Për vitin 2020, bazuar në rregjistrin e realizimit të prokurimeve, janë realizuar 10 procedura me blerje të vogël me vlerë të fondit limit prej 2,456,008 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate në vlerën prej 1,637,472 lekë pa TVSH si dhe janë realizuar 2 procedura vetëm lidhje dhe zbatim kontratë duke paguar vlerën prej 3,424,875 lekë pa TVSH (2 procedurat janë realizuar ABP).

Për periudhën deri në 30.06.2021, në institucionin e DPSHP, sipas rregjistrit të realizimit të prokurimeve, janë realizuar 3 procedura me blerje të vogël me vlerë të fondit limit prej 220,000 lekë pa tvsh dhe me vlerë kontrate në vlerën prej 189.000 lekë pa TVSH.

Për vitin buxhetor është rritur numri i procedurave me blere të vogël dhe si rrjedhim dhe vlera e tyre, ku në total për periudhën nën auditim janë planifikuar me vlerë të fondit limit prej 14,388,008 lekë pa TVSH dhe realizuar në vlerën prej 11,777,866 lekë pa TVSH, duke shpenzuar 81% të vlerës së planifikuar.



-Nga auditimi i të gjithave procedurave me blerje të vogël, duke u mbështetur në gjurmimin e dokumentacionit respektiv, çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës. Auditimi u fokusua në:
-Hartimin dhe njoftimin e rregjistrit të prokurimit publik;
-Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit;
-Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit;
-Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave;
-Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit eletronik (SPE);
-Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj.
Nga auditimi rezultoi:
1.Në strukturën e DPSHP, miratuar nga Këshilli i Ministrave me urdhër të Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020 ñPër disa ndryshime në urdhërin nr.55, datë 20.04.2017 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provësò të ndryshuarò, pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas pozicioneve të punës është 1 specialist për çështjet ligjore dhe prokurimeve, i cili ngarkohet hera- herës me detyra të tjera nga titullari i institucionit, duke mos e përfshirë në komisionin e blerjeve të vogël apo në realizimin e procedurave të prokurimeve publike, ndonëse në dosjen personale pranë sektorit të burimeve njerëzore, në formularin e përshkrimit të punës për pozicionin e specialistit detyrat kryesore në lidhje mbi prokurimet janë:
-Përgatitja e dokumenteve të tenderit në bashkëpunim me njësinë e prokurimit, administrimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit, etj
2. Pranë AK të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 deri më 30.06.2021, ka funksionuar komisioni i prokurimit me blerje të vogël, ngritur nga titullari i AK, sipas urdhërave të prokurimit ñPër krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogëlò respektiv, urdhër nr.1 datë 02.02.2018, urdhër nr.58 datë 10.01.2019 i ndryshuar me urdhër nr.842 datë 07.06.2019, urdhër nr.172 datë 06.02.2020 dhe urdhër nr.04 datë 12.01.2021.

3.Në disa prej procedurave rezultuan mangësi, konkretisht:
-Për vitin 2018, realizimi i procedurës me objekt ñBlerje gazoil për mjetin e DPSHPò është kryer duke u bazuar në përdorimin e sistemit me tollonë, në kundërshtim me VKM nr.561 datë 29.07.2016 ñPër standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, ndërsa për vitet 2019-2020 është përdorur sistemi me kartë eletronike në përputhje me VKM nr.561 datë 29.07.2016.
-Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël me objekt ñRiparime automjeti dhe mirëmbajtjeò për vitet 2018 - 2021, konstatohet se llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë aktuale për kohën e llogaritjes së fondit limit.
-Realizimi i procedurës me blerje të vogël me objekt ñKolaudim i ndërtesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provësò me Urdhër Prokurimi nr.10 datë 21.12.2020 është realizuar 5 muaj më vonë, ndonëse punimet në objekt kanë mbaruar më datë 17.07.2020, si dhe kërkesa nga mbikëqyrësi i punimeve është bërë më datë 28.09.2020. Kjo vonesë është në kundërshtim me ligjin nr.8042 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, të Udhëzimit të KM nr.3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò si dhe të Udhëzimit nr.1 datë 16.06.2011 si dhe me bazën ligjore të LPP.
-Realizimi i procedurës me blerje të vogël me me objekt ñCertifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeveò, me Urdhër Prokurimi nr.3 datë 03.06.2021, është realizuar 6 muaj më vonë, ndonëse ishte realizuar kolaudimi i objektit. Dhe në këtë rast vonesa është në kundërshtim me Ligjin nr.8042 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, Udhëzimin e KM nr.3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò si dhe të Udhëzimit nr.1 datë 16.06.2011 si dhe me bazën ligjore të LPP.
4.Në DPSHP dosjet e prokurimeve për të cilat kanë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.
5.Nga titullarët e DPSHP në cilësinë e Autoritetit kontraktor, janë angazhuar burime njerëzore, të cilët nuk janë trajnuar pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për pasojë kemi raste parregullsie dhe paqartësie mbi ecurinë e realizimit, të afateve, në lidhje mbi proceset e prokurimit publik.

<u>Më poshtë paraqiten procedurat me mangësi, të konstatuara nga auditimi, si vijon:</u>
1.Procedura blerje me vlerë të vogël me objekt "Blerje naftë Gazoil 10ppm", viti 2018.
Nisur nga nevojat e DPSHP, është hartuar dhe miratuar vlera prej 500,000 lekë pa tvsh, për blerjen e karburantit, në bazë të urdhër prokurimi nr.2 datë 27.03.2018, ku mbas realizimit të procedurës të shpalljes së fituesit si dhe në bazë të faturës tatimore nr.691 datë 30.03.2018, është përftuar sasia prej 3,752 litra gazoil 10 ppm në vlerë për litër 133.25 lekë pa TVSH ose në vlerë totale prej 499,985 lekë pa TVSH.
Nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur në bazë të urdhërit nr.1 datë 02.02.2018, më datë 30.03.2018, pasi ka bërë verifikimin e sasisë së ardhur, ka vlerësuar e plotësimit të kërkesave specifike të ofertuesit, duke bërë fletë hyrje në magazinë.
Në lidhje mbi këtë procedurë, në dosjen fizike nuk u konstatua të paraqitur sa është gjendja në magazinë e sasisë së karburantit si dhe për këtë vit buxhetor është përdorur sistemi me tollonë,në kundërshtim me VKM nr.561 datë 29.07.2016 ñPër standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, sipas të cilit OE duhet

të ofrojnë shërbimin nëpërmjet kartës elektronike dhe ligjet e LPP, përgjegjësi e titullarit të AK (E.H.) dhe komisionit të prokurimit me blerje të vogla (E.H., E.G., T.S. dhe E.D.)
Në lidhje mbi auditimin e menaxhimit të konsumit të gazoil, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm z.E.H. (në mungesë dhe me urdhër) është miratuar urdhër nr.2477 prot datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të provës, me targë TR xxxT, brenda Tiranësò, për të cilin nga auditimi, ana formale juridike e hartimit dhe miratimit të urdhërit, u konstatua se:
-Urdhëri është hartuar në mbështetje të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menazhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar neni 4 i cili shprehet se *"……Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë: a) transparenca, parashikueshmëria, gjithëpërfshirja, uniteti dhe universaliteti në menaxhimin e sistemit buxhetor e të fondeve speciale;*
b) disiplina fiskale, në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social;
c) shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjikë të Këshillit të Ministrave;
ç) përdorimi ekonomik, efiçent dhe efektiv i burimeve publike;
d) përgjegjësi të qarta për menaxhimin operacional; dh) respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit.
Transparenca është parimi, që siguron për Kuvendin, këshillat e njësive të qeverisjes vendore dhe publikun e gjerë të dhëna lehtësisht të disponueshme, të shpejta, të kuptueshme e të krahasueshme, në nivel ndërkombëtar, integriteti i të cilit mund të verifikohet në mënyrë të pavarur, në lidhje me:
a) funksionet, mënyrën e organizimit, veprimtaritë, rolet dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes së përgjithshme;
b) produktet për objektivat dhe qëllimet e politikës;
c) procesin e përgatitjes së buxhetit;
*ç) parashikimin makroekonomik dhe fiskal; d) pasqyrat financiare.*ò
- Urdhëri është hartuar në mbështetje të Ligjit nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreòi ndryshuar, neni 3 pika 6 , i cili shprehet ñ(*Neni 3 (Parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore) pika 6. Sipas parimit të ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit, caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësive, si dhe organizimi i administratës shtetërore duhet të sigurojnë efektivitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, efiçencën në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike.*ò
<u>Sa më sipër</u>, baza ligjore mbi të cilin është mbështetur urdhri i mësipërm, nuk përputhet me qëllimin e hartimit dhe miratimit të tij, pasi urdhëri duhet të bazohej në ligjin nr.10160 datë 15.10.2009 ñPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò neni 2, pika 4 dhe 5 ku shprehet se:
ñ*4. Të gjithë funksionarët e tjerë, të cilët nuk janë pjesë e lidhjeve 1, 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij ligji, por që, sipas akteve ligjore në fuqi, kanë në dispozicion automjet dhe shofer, trajtohen sipas kategorisë së dytë, me një përfitim financiar mujor 15, 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.*
*5. Kategoria e katërt, ku përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive, institucioneve qendrore dhe të varësisë, të cilëve shërbimi i transportit, për të përmbushur detyrat e tyre funksionale, do t'u ofrohet nga institucioni përkatës. Ky shërbim do të kryhet me mjetet në përdorim të institucionit, të cilat përdoren, në çdo rast, vetëm me autorizim apo urdhër të titullarit, për shërbime, sipas një programi të miratuar prej tij.*ò
-Gjithashtu, nga auditimi nuk u konstatua asnjë dokument adminstrativ, bashkëngjitur Urdhër nr.2477 datë 31.05.2018, që të faktohej sasi e km të lëvizjeve për punë të DPSHP si dhe sasia mujore që konsumon mjeti i DPSHP gjatë 1 muaj kalendarik brenda Tiranës.

Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, është ***observuar mbi Projektraportin me shkresë nr.120/2 prot të DPSHP datë 28.02.2022, prot nr.935/10 datë 01.03.2022 të KLSH****, nga Drejtori i Përgjithshmëm A.K. (në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare) si dhe z.E.H. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër).*Nga vlerësimi i observacioneve, nuk rezulton të jenë sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet për pasojë observacioni nuk marret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes:	Auditimi i procedurave me blerje të vogël me objekt ñBlerje karburant për nevojat e DPSHPò për periudhën nën auditim 01.01.2018 deri në 30.06.2021
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, DPSHP ka në pronësi 1 automjet tip Hunday (I-30) viti i prodhimit 2010. Për konsumim e karburantit është miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm z.E.H. (*në mungesë dhe me urdhër*) urdhri nr.2477 prot datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë xxx, brenda Tiranësò, me sasi mujore 150 litra për përdorim brenda qytetit të Tiranës. Në bazë të auditimit nga ana juridike e hartimit dhe miratimit të urdhrit, u konstatua se: -Urdhri është hartuar sipas ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 4 dhe ligjit nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò i ndryshuar, neni 3 pika 6, por baza e mësipërme ligjore, nuk përputhet me qëllimin e hartimit të tij, pra për përcaktimin e saktë të sasisë së karburantit mujor, në kundërshtim me ligjin nr.10160 datë 15.10.2009 ñPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò neni 2, pika 4 dhe 5. -Gjithashtu, në momentin e hartimit të urdhërit, nuk u konstatua asnjë dokument administrativ, që të vërtetonte sasinë mujore të km që konsumon mjeti i DPSHP brenda Tiranës.
Kriteri:	Ligji nr.10160 datë 15.10.2009 ñPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò, Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòi ndryshuar Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36.
Ndikimi/Efekti:	Rritje e kostos financiare, në menazhimin e përdorimit të karburantit, duke shpenzuar jo me efektivitet fondet të siguruara nga Buxheti i shtetit.
Shkaku:	Sa më sipër, referencat ligjore mbi të cilat mbështetur urdhri si dhe mungesa e elementëve të dokumentacionit administrativ argumentues dhe justifikues, kanë mundësuar aplikimin e një akti administrativ, mbi baza ligjore të cilat nuk përputhen me qëllimin e hartimit dhe miratimit të tij.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	DPSHP të marrë masa të menjëhershme për shfuqizimin e urdhrit nr.2477 datë 31.05.2018 dhe nxjerrjen urdhrit për përcaktimin e limitit të karburantit sipas dispozitave ligjore të mirëpërcaktuara, me qëllim shmangien e menaxhimit jo efektiv të shpenzimeve financiare nga Buxheti i Shtetit.

Menaxhimi i konsumit të gazoilit.

Nga auditimi rezultoi se:

Në bazë të Urdhër-shpenzimit nr.373 date 24.05.2019, janë paguar dieta +karburant 350 litra gazoil me tollonë, në mbështetje të Urdhër nr.3812 prot datë 22.11.2018 ñPër shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, për specialisten e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës

Kukës, znj J.E.ò, pika 2 paragrafi 2 k shprehet se ñ*karburantin për transportin Kukës-Tropojë-Kukës, prej 196 km (20 litra)*ò. Kështu në bazë të autorizimeve të protokolluara mbas veprimit të levizjes nga ana e znj.E., konkretisht:
-autorizim nr.426 prot datë 05.03.2019, dërgohet me shërbim në datat 27.11.2018, 12.12.2018,07.01.2019 dhe 28.01.2019, kraburanti për 784 km **(80 litra);**
-autorizim nr.419 prot datë 05.03.2019 dërgohet me shërbim nga data 04.12.2018 dhe kthimi më datë 07.12.2018, për 196 km **(20 litra);**
-autorizim nr.422 datë 05.03.2019 dërgohet me shërbim në Tropojë për marrjen pjesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë të datës 18.12.2018, me distancë prej 196 km **(20 litra);**
-autorizim nr.423 datë 05.03.2019 dërgohet me shërbim në Tropojë për marrjen pjesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë të datës 19.12.2018, me distancë prej 196 km **(20 litra);**
-autorizim nr.425 datë 05.03.2019 dërgohet me shërbim në Tropojë për marrjen pjesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë të datës 08.01.2019, me distancë prej 196 km **(20 litra);**
-autorizim nr.421 prot datë 05.03.2019, dërgohet me shërbim në ZV-SHP Tropojë në përbushje të detyrave administrative dhe funksionimit të zyrës, nga data 15.01.2019 deri 17.01.2019me distancë prej 196 km **(20 litra);**
-autorizim nr.420 datë 05.03.2019 dërgohet me shërbim në Tropojë për marrjen pjesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë të datës 21.01.2019, me distancë prej 196 **km (20 litra);**
-autorizim nr.424 datë 05.03.2019 dërgohet me shërbim në ZV-SHP Tropojë në përbushje të detyrave administrative dhe funksionimit të zyrës, nga data 23.01.2019 deri 24.01.2019 me distancë prej 196 km **(20 litra);**
-autorizim nr.3812/1 prot datë 24.04.2019, për mbulimin me karburant për datat 04-05.02.2019;07-08.02.2019;13-14.02.2019;18.02.2019;25-26.02.2019;06-07.03.2019; 12 - 13.02.2019, gjithsej **(140 litra);**
Sa më sipër, znj. J.E., për lëvizjet në ZVSHP-Tropojë në përmbushje të detyrave administrative dhe funksionimit të zyrës, është pajisur me tollona, sasia prej 360 litra gazoil ose në vlerën prej 47,970 lekë me tvsh, në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qëndrës së punës, brenda venditò si dhe nga auditimi nuk u kostatuan dokumentacion justifikues për konsumin e karburantit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.36 ñ*dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime të lexueshme që të eliminonëj mundësinë për gabime, harresa, numër të dyfisht si dhe atë të mashtrimeve*.ò Në Urdhër-shpenzimin nr.373 date 24.05.2019, u konstatua, se dokumentacioni justifikues si dhe fatura e blerjes së karburantit nga ana e Zj.J.E. nuk ishte në koherencë me lëvizjet e saj sipas datave të raportuara në autorizimet e lëshuara nga ish-titullari i DPSHP z.H. dhe nga znj.N..
Për pasojë, **vlera prej 47,970 lekë pa TVSH**, është menaxhuar jo në përputhje me aktet e mësipërme ligjore/nënligjore, duke shkaktuar efekt negativ në buxhetin e institucionit.
Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi z.E.H., në mungesë dhe me urdhër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, znj.A.N. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues me detyrë Drejtor i Financës dhe znj. J.E. me detyrë specialiste pranë ZVSHP-Kukës, në cilësinë e personit përfitues.
2.Procedura blerje me vlerë të vogël me objekt "Blerje naftë Gazoil 10ppm" viti 2019.
Nisur nga nevojat e DPSHP, është hartuar memo me shkresë nr.602 prot datë 08.04.2019, përgatitur nga specialisti i buxhetit dhe miratuar nga drejtori i financës znj.A.N., ku është kërkuar fillimi i procedurës për blerje me karburant si dhe është raportuar se gjendja në magazinë deri më datë 01.04.2019 rezulton 870 litra.

Komisioni (E.G., E.D.dhe G.Z.) për hartimin e çmimin për litër të gazoil 10ppm, është referuar me koherencë elementëve (çmimit të akcizës, taksa e karbonit, taksë e qarkullimit, taksë markim karburanti, taksë skanimi, si dhe buletinit nr.18 datë 06.05.2019, marzhi i fitimit). Në këtë procedurë është përdorur sistemi me kartë eletronike në përputhje me VKM nr.561 datë 29.07.2016.
Sa më sipër, është hartuar dhe miratuar urdhër prokurimi nr.2 datë 06.05.2019 për blerjen e karburantit, ku mbas realizimit të procedurës të shpalljes së fituesit si dhe në bazë të faturës tatimore nr.707 datë 09.05.2019, është përftuar sasia prej 2,920 litra gazoil 10ppm në vlerë për litër 136.9 lekë pa TVSH ose në vlerë totale në vlerën prej 399,745 lekë pa TVSH.
Midis AK dhe OE, është lidhur Kontratë nr.719, datë 09.05.2019, afati kohor i ekzekutimit i kontratës është përcaktuar deri në përfundimin e sasisë së karburantit të kërkuar.
Komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje (A.XH., D.T. dhe E.P.) i ngritur në bazë të urdhërit nr.491 datë15.03.2019, më datë 09.05.2019, ka bërë verifikimin e sasisë së ardhur, nga operatori fitues ñGò, e cila ka rezultuar në përputhje me kërkesat specifike. Për këtë sasi është bërë fletë hyrje në magazinë si dhe është instaluar programi i furnizimit të karburantit me kartë sipas kërkesës së vendosur në ftesën për ofertë, në zbatim të VKM nr.561 datë 29.07.2016 ñPër standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Sasia prej 2,920 litra sipas faturës tatimore lëshuar nga OE ñGò shpk nr.707 datë 09.05.2019 me vlerë prej 399,745 lekë pa tvsh dhe 479,697 lekë me tvsh, është paguar në bazë të urdhër-shpenzimi nr.349 datë 21.05.2019.
Kontratë nr.719, datë 09.05.2019 ka filluar lëvrimin e saj në 03.06.2019 deri në momentin e konsumit të sasisë së karburantit deri në shtator 2020.
Nga auditimi, duke u bazuar në ditarin e daljeve të magazinës mbi mënyrën e përdorimit të kaburantit, për periudhën 10.05.2019 deri në 31.12.2019, u konstatua si vijon:
-Në bazë të urdhërit nr.2477 datë 31.05.2018 sasia limit mujor është 150 litra karburant në muaj, brenda Tiranë, e cila është tërhequr e gjithë por nuk është e konsumuar plotësisht, kjo në bazë të fletëve-udhëtimit sipas muajve përkatës.
-Në bazë të kryqëzimit të të dhënave të konsumit të karburantit mujor me fletët e udhëtimit brenda Tiranës (të hartuara nga shoferi i mjetit dhe miratuar nga titullari i AK), të autorizimeve për lëvizje jashtë Tirane si dhe me USH për pagesat e dietave të shoferit, i cili ka shoqëruar punonjësit në ZVSHP të ndryshme, në disa raste janë konstatuar mospërputhshmëri në hartimin dhe miratimin e dokumentacionit justifikues, si vijon:
-për muajin tetor 2019, në bazë të Autorizimit nr.1386/1 prot datë 02.10.2019 datë 02.10.2019, është caktuar grupi për inspektim në ZV-Kurbin-Lezhë (brenda ditës datë 03.10.2019), ndërsa në fletet-udhëtimi nr.10, rezultoi se në datë 03.10.2019 mjeti ka lëvizur brenda Tiranës 40 km. Ky fakt tregon mospërputhshmëri mbi konsumin e karburantit.
Gjithashtu, nga auditimi, në bazë të Autorizimit nr.1473/1prot datë 21.10.2019, është caktuar grupi për inspektim në ZV-SHP Vlorë datë 22.11.2019 deri 25.10.2019 (datë e kthimit në Tiranë), ndërsa në fletet-udhëtimi nr.10, rezultoi se në datë 24.10.2019 mjeti ka lëvizur brenda Tiranës 80 km dhe në datë 25.10.2019 mjeti ka lëvizuar në Tiranë 50 km. Ky fakt tregon mospërputhshmëri mbi konsumimin e karburantit.
Në total lëvizja brenda Tiranës, për muajin tetor 2019 rezultoi 672 km e shprehur ndryshe është konsumuar 67 litra, bazuar në fletë-udhëtimit nr.10, hartuar nga shoferi S.K. dhe miratuar nga E.H. në cilësinë e titullarit të AK (në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare), ndërkohë është tërhequr 150 litra karburant, në ózbatimò urdhër të nr.2477 datë 31.05.2018. Për sasinë e ngelur prej 83 litra nuk u konstatuan dokumenta justifikuese.
-për muajin nëntor 2019, në bazë të Autorizimit nr.1582/1 prot datë 11.11.2019, makina së bashku me përfaqësuesin e DPSHP ka shkuar në Vlorë për marrjen pjesë në seancën

gjyqësore pranë gjykatës së rrethit, ndërsa në fletet-udhëtimi nr.11, rezultoi se në datë 11.11.2019 mjeti ka lëvizur brenda Tiranës 30 km. Ky fakt tregon mospërputhshmëri mbi konsumin e karburantit.
-në bazë të Autorizimit nr.1581/1 prot datë 11.11.2019, makina së bashku me përfaqësuesin e DPSHP ka shkuar në Vlorë për marrjen pjesë në seancën gjyqësore të datës 13.11.2019 pranë gjykatës së rrethit, ndërsa në fletet-udhëtimi nr.11, rezultoi se në datë 13.11.2019 mjeti ka lëvizur brenda Tiranës 30 km. Faktet tregojnë mospërputhshmëri mbi hartimin e dokumentacionit justifikues, për konsumin e karburantit.
Në total lëvizja brenda Tiranës, për muajin nëntor 2019 rezultoi 860 km e shprehur ndryshe është konsumuar 86 litra, kjo në bazë të fletë-udhëtimit nr.11, hartuar nga shoferi S.K. dhe miratuar nga E.H. në cilësinë e titullarit të AK (Në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare), ndërkohë është tërhequr 150 litra karburant, në ózbatimò urdhër të nr.2477 datë 31.05.2018. Për sasinë e ngelur prej 64 litra nuk u konstatuan dokumenta justifikuese.
-për muajin dhjetor 2019, rezultoi 402 km, kjo në bazë të fletë-udhëtimit nr.12, hartuar nga shoferi S.K. dhe miratuar nga E.H. në cilësinë e titullarit të AK (Në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare), si dhe 792 km, realizuar në drejtim të rrethit të Durrës, pasi me urdhër makina është përdorur nga Ministria e Drejtësisë, për ndihmën e banorëve të dëmtuar nga termeti i 26 nëntorit 2019.
-për muajin janar 2020, u konstatua se janë përdorur 134 litra karburant në bazë të fletë daljeve të magazinës, si vijon:
-FD nr.1 datë 02.02.2020 sasia 50 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N.;
-FD nr.4 datë 22.01.2020 sasi 12 litra, në bazë të autorizimit nr.56/1 datë 15.01.2020 për inspektim pranë ZV-SHP Krujë, datë 15.01.2020;autorizim nr.99/1 datë 20.01.2020;
-FD nr.5 datë 23.01.2020 sasia 22 litra, në bazë të autorizimit nr.107/1 prot datë 22.01.2020 për inspektim në ZV-SHP Fier, datë 23.01.2020;
-FD nr.6 datë 27.01.2020 sasia 100 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N..
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin janar nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 150 litra është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga DPSHP.
-për muajin shkurt 2020, u konstatua se janë përdorur 168 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
-FD nr.7 datë 04.02.2020 sasia 100 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N..
-FD nr.8 datë 17.02.2020 sasia 18 litra, në bazë të autorizimit nr.186/1 prot datë 10.02.2020, për inspektim në ZV-krujë datë 11,12,13.02.2020;
-FD nr.10 datë 21.02.2020, sasi 50 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N.
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin shkurt nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 150 litra është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga DPSHP.
-për muajin mars 2020, u konstatua se janë përdorur 235 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
-FD nr.14 datë 03.03.2020 sasia 31 litra, në bazë të autorizimit nr.310/2 prot datë 03.03.2020, pjesëmarrja e DPSHP në seanacë gjygjësore Vlore më datë 04.03.2020.
-FD nr13 datë 05.03.2020 sasi 100 litra. Me autorizim nga drejtori i financës A.N.
-FD nr.15 datë 06.03.2020 sasia 56 litra, në bazë të autorizimit nr.338/1 prot datë 05.03.2020, inspektim ë ZV-Sarandë brenda datës 06.03.2020.
-FD nr.16 datë 19.03.2020 sasia 48 litra, në bazë të autorizimit nr.341/1 prot datë 06.03.2020, grup inspektimi në ZV-Kukës, Tropojë, për data 09, 11, 11. 03.2020
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin mars nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 100 litra është e

paargumentuar dhe pajustifikuar nga DPSHP. Për këtë muaj duhet të vlerësohet që situata e lëvizjes ishte e kufizuar për shkak të situatës Covid-19, për të krijuar garanci të shëndetit të popullësisë në përputhje më Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò.
-për muajin prill 2020, u konstatua se janë përdorur 100 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
-FD nr.17, datë 10.04.2020 sasia 100 litra, me autorizim të drejtorit të financës.
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin prill nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 100 litra është e paargumentuar dhe justifikuar nga DPSHP. Për këtë muaj duhet të vlerësohet që situata e lëvizjes ishte e kufizuar për shkak të situatës Covid-19, për të krijuar garanci të shëndetit të popullsisë në përputhje me Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò.
-për muajin maj 2020, u konstatua se janë përdorur 100 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
-FD nr.21 datë 06.05.2020, me autorizim nga Drejtori i Financës A.N..
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin maj nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 100 litra është e paargumentuar dhe pajustifikuar nga DPSHP. Për këtë muaj duhet të vlerësohet që situata e lëvizjes ishte e kufizuar për shkak të situatës Covid-19, për të krijuar garanci të shëndetit të popullsisë në përputhje më Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò.
-për muajin qershor 2020,u konstatua se janë përdorur 212 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
-FD nr.32 datë 08.06.2020 sasia 50 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N.;
-FD nr.40 datë 17.06.2020 sasia 100 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N.;
-Fd nr.49 datë 30.06.2020 sasia 62 litra, në bazë të autorizimit nr.647/1 datë 29.06.2020, për marrjen pjesë në seancat gjyqësore pranë gjykatës së rrethit Vlorë me datë 29.06.2020 dhe datë 01.07.2020.
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magëzizës së DPSHP për muajin qershor nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 150 litra është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga DPSHP.
-për muajin korrik 2020, u konstatua se janë përdorur 167 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
-FD nr.49 datë 02.07.2020 sasia prej 150 litra, me autorizim të drejtorit të financës A.N.;
-FD nr.52 datë 24.07.2020 sasia prej 17 litra, në bazë të autorizimit nr.745/1 datë 24.07.2020, për inspektim në ZV-SHP Lushnjë, më datë 24.07.2020.
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin korrik nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 150 litra është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga DPSHP.
-për muajin gusht 2020, u konstatua se janë përdorur 50 litra karburant në bazë të Fletë daljeve si vijon:
FD nr.58 datë 03.08.2020 sasia 50 litra, e dhënë pa asnjë autorizim.
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin gusht nuk ka të paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë sasia prej 50 litra është e paargumentuar dhe e pajustifikuar nga DPSHP.
Sa më sipër, për periudhën 01.01.2020 deri në 31.08.2020, sasia e karburantit për përdorim brenda Tiranës prej 150 litra, është konsumuar duke mos paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës, për rrjedhojë **sasia prej 950 litra gazoil e baravlefshme me vlerën prej 130,055 lekë me TVSH, është përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore, jo** në përputhje me

UMF nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 & 36 dhe Urdhër nr.2477 prot datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë TR xxxT, brenda Tiranësò pika 3.
Veprimet e mësipërme, për mungesën e fletëve të udhëtimit, ngarkojnë me përgjegjësi ish-titullarin e DPSHP z.B.D. , znj.A.N. ish-Drejtor i financës dhe znj.H.M. specialiste e financës.
Gjithashtu, mbas takimit përmbyllës në terren, realizuar në ambjentet e Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) z.A.K., më datë 14.12.2021, ish-Drejtore e Financës znj.A.N. dhe specialistja e financës, reaguan për mungesën e Fletëve-udhëtimeve për brenda Tiranës për muajin janar-gusht 2020, duke justifikuar mungesën e tyre me email të dërguar midis njëra-tjetrës të datës 08.10.2020 ora 1:04 PM dërguar nga znj.M. për znj.N. dhe znj. N. për znj.M. të datës 08.10.2020 ora 1:27 PM, si dhe për këto email është bërë me dijeni z.B.D.. Në observimet në lidhje mbi aktkonstatimin nr.8, nga DPSHP me shkresë nr.1626 prot datë 24.12.2021, nuk u konstatua dokumentacion ligjor origjinal justifikues dhe argumentues, për periudhën 01.01.2020 deri në 30.08.2020.
-për muajin shtator 2020, u konstatua se janë përdorur 130 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.59 datë 10.09.2020 sasia 100 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N.;
-FD nr.94 datë 15.09.2020, në bazë të autorizimit nr.918/1 datë 15.09.2020, për inspektim në ZV-Vlorë.
Nga auditimi u konstatua se, në daljen e magazinës së DPSHP për muajin shtator janë paraqitur Fletë-udhëtimet brenda Tiranës nr.9, ku levizjet e automjetit të DPSHP, kanë realizuar brenda Tiranës 1510 km.
Nga auditimi i fletëve- udhëtimi, u konstatua se, për muajin shtator 2020, mjeti i DPSHP ka shkuar 15 herë pranë Burgut Vaqar x10 km, dmth 150 km **,** e shprehur ndryshe është konsumuar 15 litra, ndërkohë në bazë të Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019, IEVP-Vaqarr është zhvendosur në ambjentet e IEVP ñJordan Misjaò.
-për muajin tetor 2020, u konstatua se janë përdorur 217 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.118 datë 01.10.2020 sasia 100 litra, me autorizim nga drejtori i financës A.N.
-FD nr.119 datë 07.10.2020 sasia 30 litra, në bazë të autorizimit nr.979/4 prot datë 07.10.2020, për të marrë pjesë në seancë gjyqësore në Vlorë.
-FD nr.122 datë 19.10.2020 sasia 62 litra, në bazë të autorizimit nr.1018/1 datë 19.10.2020, për inspektim pranë ZT-Sarandë, Përmet dhe Gjirokastër, në datat 19,20,21,22, kthimi në 23.10.2020.
-FD nr.146 datë 23.10.2020 sasia 25 litra, në bazë të autorizimit nr.1053/1 prot datë 22.10.2020, për inspektim datë 23.10.2020, pranë ZT-SHP Pogradec;
Për datën 23.10.2020, kemi mbivendosje, pasi mjeti duhet të jetë në rrugën e kthimit nga Gjirokastra si dhe në të njëjtën datë rezulton se ka shkuar në në Pogradec, pra në këtë rast kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit, e për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit, duke lenë ñhije dyshimiò mbi mënyrën e hartimit dhe miratimit të konsumit të gazoilit për DPSHP.
Nga auditimi i fletëve- udhëtimi, u konstatua se, përmuajin tetor 2020, mjeti i DPSHP ka shkuar 12 herë pranë Burgut Vaqar x10 km, dmth 120 km e shprehur ndryshe është konsumuar 12 litra, ndërkohë në bazë të Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019, IEVP-Vaqarr është zhvendosur në ambjentet e IEVP ñJordan Misjaò.

Sa më sipër, u konstatua se vetëm për të shkuar në IEVP -Vaqarr, i cili është jashtë funksionit, është konsumuar 27 litra karburant.

3.Procedura blerje me vlerë të vogël me objekt "Blerje naftë Gazoil 10ppm" viti 2020.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, gjendja e magazinës më datë 09.09.2020 rezulton 487 litra gazoil, shprehur në memon me shkresë nr.892 prot datë 09.09.2020, drejtuar z.B.D. në cilësinë e titullarit të AK (Drejtor i Përgjithshëm në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Deges Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, përgatitur nga znj.A.N. në cilësinë e Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Nisur nga nevojat e DPSHP , në bazë të Memo me shkresë nr.923 prot datë 17.09.2020, përgatitur nga komisioni i prokurimeve me blerje të vogël me përbërje (E.G. kryetar, GJ.M. dhe A.XH.) të cilët kanë paraqitur argumentimin e fondit limit, duke u bazuar në çmimin për litër të gazoil 10ppm, janë referuar me koherencë elementëve (çmimit të akcizës, taksa e karbonit, taksë e qarkullimit, taksë markim karburanti, taksë skanimi, buletinit nr.70 datë 14.09.2020, marzhi i fitimit), si dhe në këtë procedurë është përdorur sistemi me kartë elektronike në përputhje me VKM nr.561 datë 29.07.2016 ñPër standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

Sa më sipër, është hartuar dhe miratuar urdhër prokurimi nr.6 datë 18.09.2020 nën vlerën 500,000 lekë pa TVSH, për blerjen e karburantit, ku mbas realizimit të procedurës të shpalljes së fituesit si dhe në bazë të faturës tatimore nr.1256 datë 22.09.2020, është përftuar sasia prej 4,438 litra gazoil 10 ppm në vlerë për litër 112.6 lekë pa TVSH ose në vlerë totale në vlerën prej 499,985 lekë pa TVSH ose 599,982 lekë me TVSH.

Midis AK dhe OE, është lidhur kontratë nr.923, datë 29.09.2020, si dhe ka afati kohor i ekzekutimit i kontratës është përcaktuar deri në përfundimin e sasisë së karburantit të kërkuar, i cili do të terhiqet nëpërmjet kartës eletronike në pikat e karburantit.

Nga komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje (K.S., A.XH., D.T.) ngritur në bazë të urdhërit nr.89 datë 20.01.2020, më datë 22.09.2020, pasi ka bërë verifikimin e sasisë së ardhur, ka vlerësuar e plotësimit të kërkesave specifike të fituesit ñGò shpk, duke bërë fletë hyrje në magazinë si dhe është instaluar programi i furnizimit të karburantit me kartë sipas kërkesës së vendosur në ftesën për ofertë. Sasia prej 4,438 litra është paguar në bazë të Urdhër-shpenzimi nr.796 datë 29.09.2020, sipas faturës tatimore lëshuar nga OE ñGòshpk nr.1256 datë 22.09.2020 me vlerë prej 499,985 lekë pa tvsh ose 599,982 lekë me tvsh.

-për muajin nëntor 2020, u konstatua se janë përdorur 185 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:

-FD nr.150 datë 03.11.2020 sasia 30 litra, në bazë të autorizimit nr.1096/1 datë 02.11.2020, për inspektim pranë ZT-SHP Vlorë për datën 03.11.2020 deri më datë 06.11.2020.

-FD nr.152 datë 09.11.2020 sasia 100 litra për përdorim brenda Tiranës;

-FD nr.155 datë 16.11.2020 sasia 10 litra në bazë të autorizimit nr.1162/1 prot, për inpektim në ZT-SHP Fier, në datë 16.11.2020;

-FD nr.156 datë 24.11.2020 sasia 9 litra, në bazë të autorizimit nr.1180/1 prot datë 24.11.2020, për inpektim në ZT-SHP Lezhë, për datë 25 deri në 27.11.2020.

-FD nr.157 datë 25.11.2020 sasia 36 litra, për përdorim brenda Tiranës.

Nga auditimi u konstatua sasia e lëvizjës 860 km në Tiranë e shprehur ndryshe është konsumuar 86 litra, ku 12 herë ose 120 e shprehur ndryshe është konsumuar 12 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.

-për muajin dhjetor 2020, u konstatua se janë përdorur 227 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:

-FD nr.158 datë 02.12.2020 sasia 30 litra;

-FD nr.159 datë 04.12.2020 sasia 100 litra për përdorim të brendshëm në Tiranë;

-FD nr.160 datë 16.12.2020 sasia 47 litra;

-FD nr.164 datë 28.12.2020 sasia 50 litra.

Nga auditimi u konstatua sasia e lëvizjës 1,070 km në Tiranë, ku 11 herë ose 110 km e shprehur ndryshe është konsumuar 11 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.
-për muajin janar 2021, u konstatua se janë përdorur 120 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.1 datë 08.01.2021 sasia 100 litra për përdorim të brendshëm në Tiranë;
-FD nr.2 datë 11.01.2021 sasia 10 litra, në bazë të autorizimit nr.37/1prot datë 11.01.2021, për inspektim në ZT-SHP Kurbin;
-FD nr.4 datë 28.01.2021 sasia 10 litra, në bazë të autorizimit nr.103/1 prot datë 28.01.2021, për inspektim ZT-SHP-Kurbin, në datën 28.01.2021;
Nga auditimi u konstatua se, në bazë të fletë-udhëtimit nr.1 në datën 11.01.2021 mjeti ka realizuar 80 km brenda Tiranës, i cili duhet të ishtë në ZVSHP-Kurbin si dhe në datën 28.01.2021 mjeti ka realizuar 80 km në Tiranë, i cili dhe në këtë rast duhej të ishte në ZVSHP-Kurbin.
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, sasia e lëvizjes në Tiranë rezultoi 1,520 km, ku 18 herë ose 180 km e shprehur ndryshe është konsumuar 18 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.
-për muajin shkurt 2021,u konstatua se janë përdorur 154 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.4 datë 01.02.2021 sasia 100 litra brenda Tiranës;
-FD nr.6 datë 04.02.2021 sasia 10 litra;
-FD nr.7 datë 08.02.2021, sasia 44 litra;
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, sasia e lëvizjes në Tiranë rezultoi 1,200 km, ku 12 herë ose 120 km e shprehur ndryshe është konsumuar 12 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.
-për muajin mars 2021, u konstatua se janë përdorur 120 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.15 datë 03.03.2021 sasia 10 litra, në bazë të autorizimit nr.236/1 inpektim ZT-SHP Kavajë, më datë 03.03.2021.
-FD nr.16 datë 04.03.2021 sasia 100 litra, për përdorim brenda Tiranës;
-FD nr.12 datë 30.03.2021 sasia 10, inspektim në Kavajë;
Nga auditimi u konstatua se, në bazë të fletë-udhëtimit nr.3 në datën 03.03.2021 mjeti ka realizuar 70 km brenda Tiranës si dhe në datën 03.03.2021 ka qënë në Kavajë, në këto rast kemi mbivendosje, sa më sipër, kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, sasia e lëvizjes në Tiranë rezultoi 1,620 km, ku 18 herë ose 180 km e shprehur ndryshe është konsumuar 18 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.
-për muajin prill 2021, u konstatua se janë përdorur 120 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.19 datë 01.04.2021 sasia 100 litra gazoil për përdorim të brendshëm brenda Tiranës.
-Fd nr.25 datë 23.04.2021 sasia 20 litra.
Nga auditimi u konstatua se, në bazë të fletë-udhëtimit nr.4 mjeti ka realizuar brenda Tiranës 1,620 km, ku 15 herë ose 150 km e shprehur ndryshe është konsumuar 15 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.
-për muajin maj 2021, u konstatua se janë përdorur 100 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.22 datë 04.05.2021 sasia 100 për përdorim brenda Tiranës
Nga auditimi u konstatua se, në bazë të fletë-udhëtimit nr.5 mjeti ka realizuar brenda Tiranës 1,620 km, ku 11 ose 110 km e shprehur ndryshe është konsumuar 11 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.

-për muajin qershor 2021, u konstatua se janë përdorur 231 litra karburant në bazë të fletë-daljeve të magazinës si vijon:
-FD nr.32 datë 01.06.2021 sasia 100 litra për përdorim të brendshëm në Tiranë;
-FD nr.33 datë 04.06.2021 sasia 14 litra, në bazë të urdhër nr.550/1prot datë 31.05.2021, për inspektim në ZT-SHP Kavajë&Krujë më datë 04.06.2021;
-FD nr.34 datë 09.06.2021 sasia 21 litra, në bazë të urdhërit nr.621 prot datë 10.06.2021, për inspektim në ZT-SHP-Berat më datë 11.06.2021;
-FD nr.35 datë 08.06.2021 sasia 20 litra, në bazë të urdhër 597/1 prot datë 08.06.2021, për inspektim në ZT-SHP-Kurbin, Lezhë-Shkodër më datë 08.06.2021;
-FD nr.39 datë 16.06.2021 sasia 35 litra, në bazë të urdhër nr.642 prot datë 21.06.2021, për inspektim në ZT-SHP Krujë datë 16,17,18,21,22 dhe 23;
-FD nr.47 datë 24.06.2021 sasia 30 litra;
-FD nr.49 datë 29.06.2021 sasia 11 litra, në bazë të urdhër nr.655/1 prot datë 29.06.2021, për inspektim në ZT-SHP-Kavajë më datë 29.06.2021;
Nga auditimi u konstatua se, në bazë të fletë-udhëtimit nr.6 në datën 04.06.2021 mjeti ka realizuar 70 km brenda Tiranës, ndërkohë në datë 04.06.2021 ka qënë në Kavajë dhe Krujë si dhe më datë 29.06.2021 mjeti ka realizuar në Tiranë 100 km, ndërkohë ka qënë në Kavajë. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, sasia e lëvizjes në Tiranë rezultoi 1,620 km, ku 14 herë ose 140 km e shprehur ndryshe është konsumuar 14 litra, për të shkuar në IEVP-Vaqarr, ndonëse është i zhvendosur.
mjeti ka shkuar pranë IEVP-Vaqarr.
Sa më sipër, u konstatua se:
(**a**) nga institucioni i DPSHP, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.06.2021, në bazë të fletë-udhëtimit mjeti ka lëvizur brenda Tiranës duke përfshirë lëvizje vetëm në drejtim të IEVP-Vaqarr 1,090 km është konsumuar 100 litra gazoil, ndonëse ky institucion është i zhvendosur në ambjentet e IEVP ñJordan Misjaò, për shkak të amortizimit të godinës, kjo në bazë Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019.
(**b**)Gjithashtu për këtë periudhë, u konstatua se, në hartimin dhe miratimin e fletë-udhëtimeve, kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit,i cili rezoltoi që në të njëjtën datë ñ*është ndodhur në dy vendndodhje të ndryshme*ô e për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit për 320 km ose 32 litra gazoil, duke lenë ñhije dyshimiò mbi mënyrën e hartimit dhe miratimit të konsumit të gazoilit për DPSHP.
Sa më sipër, kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit, e për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit, duke lenë ñhije dyshimiò mbi mënyrën e hartimit dhe miratimit të konsumit të gazoilit për DPSHP.
Sasia prej 132 litra gazoil me vlerë prej 14,871 lekë me TVSH, është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i shtetit.
<u>Në total</u>, për vitet 2019-2020 deri në 30.06.2021, vlera **prej 144,926 lekë** me TVSH **është përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore**, për shkak të konsumit të karburantit, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36.
S**asia e papërdorur e gazoilit** deri më datë 30.10.2021 është 2,770 litra, tregon se nga DPSHP janë planifikuar me shumë se sa konsumohet, për pasojë për vitin 2021 nga ky institucion nuk është realizuar procedurë tenderi për blerje karburanti si dhe në PBA e vitit 2022 nuk është planifikuar blerje të karburantit.

Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, është ***observuar mbi Projektraportin me shkresë nr.120/2 prot të DPSHP datë 28.02.2022, prot nr.935/10 datë 01.03.2022 të KLSH***, nga znj.H. M. në cilësinë e specialistit të financës, me shkresën nr.343 prot datë 25.02.2022, e cila

nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.8, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin, observuar nga z.B.D. në cilësinë ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) me shkresë nr.1452 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.8, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin, nga z.E.H. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), me shkresë nr.350 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.8, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin, nga z.J.E. në cilësinë e ish-specialiste në DTSHP, të cilat janë të pasqyruara më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

1.*(Observimi nga znj.J.E.)* Sipas Urdhërit nr.3812, datë 22.11.2018, për shërbim jashtë qëndrës së punës nga ana e Drejtorisë në pikën 2 të këtij urdhri më është vënë në dispozicion 20 litra naftë për çdo lëvizje Kukës-Tropojë-Kukës.Bëj me dije se nuk ka pasur linje direkte me orar të përcaktuar të transportit publik nga Kukësi për Tropojë apo anasjelltas.Në këto rrethana për të ofruar lehtësira që të dakortësohem me detyrën shtesë, në këtë urdhër është përcaktuar kompesim i transportit me naftë, me mirëkuptim nga ana ime që mjetin do e siguroja vetë.Në Urdhërin nr.3812 datë 22.11.2018 të DPSHP, në asnjë pikë nuk shprehet se kompesimi i transportit në naftë kërkon dokument justifikues.Sasia e karburantit nuk më shtë vënë në dispozicion para ose në përfundim të çdo shërbimi timin, por shumë kohë pasi kam dorëzuar detyrën e punës në zyrën e Tropojës dhe në asnjë moment nuk më shtë kërkuar nga DPSHP që unë duhet të paraqesë faturat e naftës.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

1.Veprimtaria e administratës publike që financohet nga buxheti i shtetit, realizon aktivitetin institucional në bazë të Ligjeve, VKM, Udhëzimeve etj, kështu në rastin e pagesës së karburantit për znj.E, duhej të bëhej në përputhje me VKM nr. 997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qëndrës së punës, brenda vendit, si dhe Udhëzimit nr 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, për rrjedhojë është detyrim ligjor për zbatim si nga drejtuesit e institucionit dhe punonjësit e saj.**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

2.Në bazë të Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019, në këtë godinë nuk ka të paraburgosur ose të dënuar, për rrjedhojë dhe administrata e institucionit nuk kryen veprimtari administrative në një gadinë e cila është mbyllur për shkak të amortizimit të lartë të godinës, kështu hartimi dhe miratimi i fletëve-udhëtimeve brenda qytetit të Tiranës, lënë ñhije dyshimiò, në kundërshtim meligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòi ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 & 36. **Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

3.Gjatë auditimit dhe të observimeve, nuk u konstatua dokumentacion ligjor origjinal justifikues dhe argumentues, për periudhën 01.01.2020 deri në 30.08.2020, për rrjedhojë sasia prej 950 litra gazoil në vlerën prej 130,055 lekë me tvsh, është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit.**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

Titulli i Gjetjes:	Auditimi i procedurave me blerje të vogël me objekt ñBlerje karburant për nevojat e DPSHPò për periudhën nën auditim 01.01.2018 deri në 30.06.2021
Situata:	Për periudhën nën auditim 01.01.2018 deri në 30.06.2021, në lidhje me realizimin dhe menaxhimin e procedurave me blerje të vogël me objekt ñBlerje karburant për nevojat e DPSHPò, u konstatua se: Me Urdhër-shpenzimin nr.373 date 24.05.2019, është paguar karburant 350 litra

	gazoil me tollonë, në mbështetje të Urdhër të ish-titullarit të DPSHP, me nr.3812 prot. datë 22.11.2018 ñPër shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, për specialisten e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kukës, znj J.E.ò, për lëvizjet në ZVSHP-Tropojë në përmbushje të detyrave administrative dhe funksionimit të zyrës. Në Urdhër-shpenzimin nr.373 datë 24.05.2019, nuk u konstatuan, dokumentacion justifikues si dhe faturat e blerjes së karburantit nga znj. E. në koherencë me lëvizjet e saj sipas datave të raportuara në autorizimet e lëshuara nga ish-titullari i DPSHP, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.36. Dhënia e 350 litra karburant me tollonë është në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, për pasojë vlera prej 47,970 lekë pa TVSH, është menaxhuar jo në përputhje me aktet e mësipërme ligjore/nënligjore, duke shkaktuar efekt negativ në buxhetin e institucionit, siguruar nga Buxheti i shtetit. -Për periudhën 01.01.2020 deri në 31.08.2020, në bazë të Fletë daljeve të magazinës së DPSHP, sasia për përdorim brenda Tiranës prej 150 litra në muaj, është konsumuar duke mos paraqitur dokumentacionin argumentues dhe justifikues Fletë-udhëtime mujore, për rrjedhojë sasia prej 950 litra gazoil në vlerën prej 130,055 lekë me TVSH, është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 & 36 dhe Urdhër nr.2477 prot datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë TR xxxT, brenda Tiranësò pika 3. -Nga institucioni i DPSHP, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.06.2021,në bazë të fletë-udhëtimit mjeti ka lëvizur brenda Tiranës duke përfshirë edhe lëvizjet në drejtim të IEVP-Vaqarr të cilat janë 1090 km ose 100 litra gazoil, ndonëse ky institucion është i mbyllur për shkak të amortizimit të godinës, kjo në bazë Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019, duke u zhvendosur në ambientet e IEVP ñJordan Misjaò. -Gjithashtu për këtë periudhë, u konstatua se, në hartimin dhe miratimin e fletë-udhëtimeve, kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit, i cili rezultoi që në të njëjtën datë ñ*është ndodhur në dy vendndodhje të ndryshme*ô e për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit për 320 km ose 32 litra gazoil. Në total, për vitet 2019, 2020 deri në 30.06.2021, vlera prej 144,926 lekë me TVSH është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i shtetit, për shkak të konsumit të karburantit, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar UMF nr.30 datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarët e DPSHP sipas kohës respektive ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) (E. H., B.D. dhe A.K.) dhe znj.A.N. në cilësinë e ish nëpunësit zbatues dhe znj.H.M. në cilësinë e nëpunësit zbatues (në mungesë dhe me urdhër).
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòi ndryshuar Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore në vlerën 144,926 lekë me TVSH për vitet 2019, 2020 deri në 30.06.2021.
Shkaku:	Përdorimi i karburantit, është bërë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit

	publikò pika nr.35 & 36 dhe Urdhër nr.2477 prot datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë TRXXX, brenda Tiranësò pika 3.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga DPSHP të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 144,926 lekë me TVSH është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i shtetit, për shkak të konsumit të karburantit, në kundërshtim me bazën ligjore të sipërpërmëndur.

4. Procedura blerje me vlerë të vogël me objekt "Shpenzime dhe mirëmbajtje dhe riparim automjeti", viti 2019, 2020 dhe 2021.

DPSHP për vitin buxhetor 2019, 2020 dhe 2021, ka realizuar procedurën me blerje të vogël me objekt ñShpenzime dhe mirëmbajttje dhe riparim automjetiò në bazë të Urdhrave të Prokurimit, nr.1 datë 27.02.2019, me fond limit 180,000 lekë pa TVSH, nr.1 datë 19.05.2020 me fond limit 100,000 lekë pa TVSH dhe nr.2 datë 24.05.2021 me fond limit 100, 000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi për tre procedurat e mësipërme u konstatuan mangësitë si më poshtë:

(**i**) llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë aktuale për kohën e llogaritjes së fondit limit.

(**ii**)Vlera e preventivit për tenderim, nuk është bazuar në inventarin dhe të dhënat teknike të automjetit tip Hyundai I30, viti i prodhimit 2009, me nr.shasie xxx , në shpenzimet për riparim/shërbime të automjetit gjatë viteve të mëparshëm, në gjendjen teknike aktuale të automjetit, në sigurimin e gatishmërisë teknike të automjetit, duke e shoqëruar me procesverbaleve respektive.

(**iii**) nuk është paraqitur në dosjen e prokurimit, vlera kontabël dhe norma e amortizimit të mjetit motorrik në përputhje, me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò Udhëzimin nr.30 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò si dhe nuk rezulton gjendja kilometrazhit që ka realizuar mjeti përgjatë vitit të mëparshëm.

Më poshtë po paraqesim mangësitë e konstatuara;

-**Në vitin 2019**, është realizuar procedura me blerje të vogël në mbështetje të UP nr.1 datë 27.02.2019, iniciuar në bazë informacionit të datës 278/1 datë 08.02.2019 hartuar nga S.K. në cilësinë e shofer pranë DPSHP, duke u shprehur se ñ*nga kontrolli fizik që i është bërë mjetit, janë konstatuar një sërë defektesh. Për këtë arsye duhet patjetër të merren masa për rregullimin e tyre që makina të jetë në gjëndje pune.*ò Nga auditimi nuk u konstatua, procesverbale ku të përcaktohen difektet e përmëndura.

-Nga auditimi nuk u konstatua, vlera kontabël dhe norma e amortizimit të mjetit motorrik në përputhje, me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò Udhëzimin nr.30 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò si dhe nuk rezulton gjendja kilometrazhit që ka realizuar mjeti përgjatë vitit të mëparshëm.

-Komisioni i blerjeve të vogla, me përbërje (E.G. kryetar, G.Z. dhe E.D.) kanë përgatitur memo nr.360 prot datë 25.02.2019, ku është paraqitur përllogaritja e fondit limit, duke listuar tre operatorë ekonomikë dhe vlerat ekonomike të tyre, por të pashqëruara me ofertën e marrë si dhe NIPT shoqërues për tre operatorët ekonomikë duke konkluduar se vlerë e prokuruar do të jetë prej 143,054 lekë pa tvsh. Nga auditimi u konstatua se, llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë aktuale për kohën e llogaritjes së fondit limit.

-Nga auditimi në sistemin e prokurimeve elektronike app.gov.al, sipas renditjes përfundimtare rezultoi se, OE ñXXXò SHPK me NIPT XXX, ka paraqitur ofertën prej

100,000 lekë pa tvsh, duke e shpallur fitues si dhe është lidhur Kontrata nr.386 prot datë 01.03.2019 me afat kohor brenda 5 ditëve.
-Komisioni i blerje me vlera të vogël ,më datë 04.03.2019 në prani të shoferit, kanë mbajtur proces-verbalin, pasi kanë bërë verifikimin e shërbimeve sipas specifikimeve teknike të kryera nga subjekti, duke i marrë në dorëzim si dhe duke bërë dhe testimin e makinës e cila është riparuar plotësisht.
-Në vitin 2020, në bazë të UP nr.1 datë 19.05.2020, në mbështetje të nenit 29, pika 5, të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar si dhe në bazë të VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò Kreu IV neni 40, pika 3, është realizuar procedura me blerje të vogël me fond limit në vlerën prej 91,900 lekë pa tvsh.
-Kjo procedurë është e iniciuar me memo nr.472 prot datë 13.05.2020 hartuar nga S.K. në cilësinë e shofer pranë DPSHP, duke u shprehur se ñ*nga kontrolli fizik që i është bërë mjetit, janë konstatuar një sërë defektesh. Për këtë arsye duhet patjetër të merren masa për rregullimin e tyre që makina të jetë në gjëndje pune.*ò Nga auditimi nuk u konstatua procesverbale ku të përcaktohen difektet e përmëndura.
-Nga auditimi nuk u konstatua, vlera kontabël dhe norma e amortizimit të mjetit motorrik në përputhje, me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò Udhëzimin nr.30 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò si dhe nuk rezulton gjendja kilometrazhit që ka realizuar mjeti përgjatë vitit të mëparshëm.
-Në bazë të Memo nr.490 prot datë 19.05.2020, e përgatitur nga komisioni me blerje të vogël me përbërje (E.G., GJ.M. dhe A.XH.), drejtuar titullarit të AK (B.D.), ku është paraqitur argumentimi i fondit limit me vlerë prej 91,900 lekë pa tvsh, duke listuar tre operatorë ekonomikë/ persona fizikë (R.M., Autoservis X dhe A. G.) dhe vlerat ekonomike të tyre, por të pashqëruara me ofertën e marrë si dhe NIPT shoqërues për tre ñoperatorët ekonomikëò duke konkluduar se vlerë e prokuruar do të jetë prej 91,900 lekë pa tvsh.Nga auditimi u konstatua se, llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë aktuale për kohën e llogaritjes së fondit limit.
-Komisioni i blerje me vlera të vogël , i krijuar në bazë të urdhërit 172 datë 01.06.2020 në prani të shoferit, kanë mbajtur proces-verbalin, pasi kanë bërë verifikimin e punimeve sipas specifikimeve teknike të kryera nga subjekti ñA. Xò, duke i marrë në dorëzim si dhe duke bërë dhe testimin e makinës e cila është riparuar plotësisht.

-Në vitin 2021, në bazë të UP nr.2 datë 24.05.2021, është realizuar procedura me blerje të vogël me fond limit në vlerën prej 91,900 lekë pa TVSH, e cila është finalizuar me lidhjen e kontratës me subjektin ñKò shpk me NIPT JXXX , me ofertë vlerën prej 89,000 lekë pa TVSH.
-Nga auditimi nuk u konstatua, vlera kontabël dhe norma e amortizimit të mjetit motorrik në përputhje, me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò Udhëzimin nr.30 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò si dhe nuk rezulton gjendja kilometrazhit që ka realizuar mjeti përgjatë vitit të mëparshëm.
-Në bazë të Memo nr.528/2 prot datë 21.05.2021, e përgatitur nga komisioni me blerje të vogël me përbërje (E.G. kryetar, S.L. dhe J.D.), drejtuar titullarit të AK (A.K.), duke paraqitur argumentimin e fondit limit me vlerë prej 91,900 lekë pa tvsh, duke listuar tre operatorë ekonomikë/ persona fizikë (ñK.òshpk;ñA.M.ò dhe R.M.) në bazë të vlerave ekonomike të paraqitura nga ana e tyre, të cilat janë të pashqëruara me ofertën e marrë si dhe NIPT shoqërues për tre OE, duke konkluduar se vlera e prokuruar do të jetë prej 91,900 lekë pa tvsh.
-Nga auditimi u konstatua se, llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë

aktuale për kohën e llogaritjes së fondit limit.
-Komisioni, në prani të shoferit, kanë mbajtur proces-verbalin, pasi kanë bërë verifikimin e punimeve sipas specifikimeve teknike të kryera nga subjekti ñK.òshpk me NIPT XX , ka paraqitur ofertën prej 89,000 lekë pa tvsh duke i marrë në dorëzim si dhe duke bërë dhe testimin e makinës e cila është riparuar plotësisht.

Titulli i Gjetjes:	Auditimi i procedurave me blerje të vogël me objekt ñShpenzime dhe mirëmbajttje dhe riparim automjetiò për periudhën nën auditim 01.01.2018 deri në 30.06.2021
Situata:	Autoriteti Kontraktor i DPSHP për çdo **viti kalendarik dhe buxhetor 2019, 2020 dhe 2021,** ka realizuar procedurën me blerje të vogël me objekt ñShpenzime dhe mirëmbajttje dhe riparim automjetiò në bazë të Urdhërave të Prokurimit, konkretisht, nr.1 datë 27.02.2019, nr.1 datë 19.05.2020 dhe nr.2 datë 24.05.2021. Nga auditimi për tre procedurat e mësipërme u konstatuan mangësitë si më poshtë: (**i**) llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë aktuale për kohën. (**ii**) Në përcaktimin e vlerës për riparimet dhe shërbimet që do i bëhen automjetit (para llogaritjes së fondit limit) nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit e mjetit motorik në përputhje me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, udhëzimin nr. 30 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Po kështu, nuk ka evidenca për mjetin (letër shërbimesh) se sa kilometra ka përshkruar përgjatë viteve të mëparshme. Pra nuk ka dokumentacion dhe evidenca te mjaftueshme për të argumentuar gjendjen reale të përdorimit dhe nivelin e amortizimit të automjetit, me qëllim identifikimi e saktë të nevojës për riparime dhe shërbim, mbi bazën e të cilave do të llogaritej dhe të kërkohej financimi buxhetor për të vijuar me pas me llogaritjen e fondit limit sipas përcaktimeve te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò.
Kriteri:	Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 ñPër prokurimin publikò, VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò; ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò Udhëzimin nr.30 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik
Ndikimi/Efekti:	Transparenca në menaxhimin e fondeve publike, duke pasqyruar saktë në bazë të dokumentacionit në lidhje mbi shërbimet/difektet e mundshme ndaj mjeteve motorrike në administrim të DPSHP.
Shkaku:	Hartimi i fondit limit, nuk është pasqyruar në vlerat e kohës në bazë të dokumentacionit të përdorur nga AK si dhe nuk është paraqitur vlera kontabël dhe norma e amortizimit të mjetit motorrik .
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	-Nga DPSHP, të merren masa, për të analizuar dhe vlerësuar saktë gjendjen teknike mbështetur në vlerën kontabël, në llogaritjen e amortizimit dhe në dokumentacionit teknik të çdo automjeti. Kjo analizë dhe vlerësim të bëhet me qëllim marrjen në konsideratë të raportit kosto-përfitim (leverdinë ekonomike)për shërbimet që kërkohet të kryhet për mjetin motorrik.

-Zbatimi i Kontratës së Punës nr.01/7 prot datë 13.06.2017 me objekt "Rikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës" (DPSHP).

Për të realizuar objektin e auditimit në lidhje mbi zbatimin e Kontratës nr.01/7 prot, datë 13.06.2017, grupi i auditimit, u fokusua, në zbatimin akteve ligjore dhe nënligjore, në mbështetje të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikñi ndryshuar, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòi ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, të Ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Udhëzimi nr.1 datë 16.06.2011 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ñPër mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e teritoritò i ndryshuar, të VKM-së nr.408 datë 13.03.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi kontratat e prokurimit, duke konstatuar se:

Në vitin 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka realizuar procedurën e hapur me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò (DPSHP) me vlerë investimi prej 18,149,747 lekë me TVSH dhe me grafik punimesh për 38 ditë kalenderike, duke lidhur Kontratë Pune nr.01/7 prot datë 13.06.2017 midis OE fitues ñC.ò shpk me titullarin e AK.

Kjo kontratë ka mbaruar punimet më datë 17.07.2020. Për këtë kontratë janë realizuar dy pagesa për situacionet pjesore 1& 2 me vlerë prej 7,327,950 lekë me tvsh duke mos përfshirë 5% e garancisë së punimeve, në bazë të Urdhër Shpenzimi nr.942 datë 11.12.2019 dhe nr.1017 datë 13.12.2019, ndërsa pjesa tjetër sipas Situacionit Përfundimtar dorëzuar në DPSHP nga operatori ekonomik më datë 29.08.2020 në **vlerën prej 10,436,115 lekë pa TVSH, nuk është e likujduar.**

Gjithashtu, nga AK në dhjetor të vitit 2020 është realizuar procedura me blerje të vogël me objekt kolaudimin e punimeve, ndërsa marrja në dorëzim të përkohshëm i godinës është realizuar në qershor të vitit 2021 (Procedurë me blerje të vogël realizuar pagesa).

Më poshtë po paraqesim ecurinë e zbatimit të Kontratë Pune nr.01/7 prot datë 13.06.2017, sipas problematikave të konstatuara:

1. Nga auditimi, u konstatua se më **datën 26.08.2019, kanë filluar punimet**, kjo në bazë të proces-verbalit mbajtur midis mbikëqyrsit të punimeve (Shoqëria ñD.òshpk; sipërmarrësi i punimeve ñShoqëria C.ò shpk dhe ish-titullarit të AK (z.E.H.), me vonëse kohore prej 26 muaj më vonë, kjo për shkak se, në momentin kur është realizuar procedura e hapur me objekt ñNdërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò sipas UP nr.01 datë 18.04.2017, nga auditimi u konstatua se, AK i DPSHP nuk kishte aplikuar në kohë, për marrjen e Lejes së ndërtimit për objektin, në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e teritoritò i ndryshuar, neni 27 dhe 28, me VKM nr.408 datë 13.03.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar.

Nga Këshilli Kombëtar i Territorit, është miratuar Vendimi nr.13 më datë 02.02.2018 ñPër miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin ñNdërtim shtesë anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò, duke vendosur sipas pikës 3 që ñ*Dokumenti i lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Tiranë*ò, ndërsa Leja e Ndërtimit nr.2256 datë 20.08.2019, është zbardhur dhe dërguar në DPSHP, për shkak se:

-Nga AK (DPSHP) pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Tiranë, është paguar 15 muaj me vonesë, në bazë të USH nr.547 datë 05.08.2019, për shkak se nga ana e Bashkisë së Tiranës, kërkesave të ripërsëtira të DPSHP, i është përgjigjur me

Autorizimin nr. prot 1636/5 datë 31.07.2019, duke përcaktuar dhe vlerën prej 474,159.78 lekë që i përket 2% të vlerës së investimit sipas preventivit, paguar nga DPSHP me U-SH nr.547 datë 05.08.2019.

2.Më datë **22.08.2019** midis titullarit të AK (E.H. në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Inspektimit) dhe OE, shoqëria ñC.ò shpk është miratuar **Amendament (I)** i Kontratës nr.01/7 prot datë 13.06.2017, ku cilësohet sipas neni 2 se ñ... *kontraktori duhet të fillojë punimet brenda datës 26.08.2019, në zbatim të lejes së ndërtimit me nr.2256 prot datë 20.08.2019"*, si rrjedhojë në bazë të grafikut të kontratës bazë, afati i përfundimit duhej të ishte më datë 02.10.2019, gjithashtu është miratuar nga DP Urdhër nr.1195 datë 22.08.2019 ñPër ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të kontratës me objekt ndërtimi ñShtesë anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò, me përbërje (dy ekspertë të fushës ing. ndërtimi, punonjës në Ministrinë e Drejtësisë G.L., E.M. si dhe A.K. specialist në ZVSHP-Tiranë).

3. Nga auditimi u konstatua se, brenda afatit kohor prej 1 muaj nga **Amendament (I)** i Kontratës nr.01/7 prot datë 13.06.2017, më datë **24.09.2019** nga mbikëqyrsi i punimeve shoqëria ñD.ò është kërkuar një shtesë kohë tjetër për mbarimin e punimeve me arsyetimin se për disa kërkesa teknike, të relatuara me shkresë nr.1343 prot datë 24.09.2019 si dhe nga sugjerimi i grupit të monitorimit, titullari i AK (E.H.), me OE ñC.ò shpk dhe mbikqyrsi i punimeve ñD.ò, është miratuar **Amendament (II)** i Kontratës nr.01/7 prot datë 13.06.2017, në datë 25.09.2019, ku sipas neni 2 (Afati i zgjatjes së kontratës) ñ*Autoriteti Kontraktor* ***miraton afatin e zgjatjes maksimale të përfundimit të punimeve prej 60 ditëve shtesë****, brenda vitit buxhetor 2019 (nga data e përfundimit të punimeve të kontratës bazë) Amendamenti realizohet në kushtet hasjes së pengesave që kanë ndikuar në zbatimin në kohë (Nga data e përfundimit të afatit të punimeve të kontratës bazë) si dhe me qëllim përfundimin e punimeve të objektit* ò. Shtyrja për 60 ditë shtesë punimesh është bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, me DST dhe me kontratën bazë, pasi në to është tenderuar për realizimin e punimeve prej 38 ditë kalendarike, pra është thuajse dyfishuar afati i përfundimit nga sa është përcaktuar në kontratën e punimeve.

Në bazë të shtesës kontrata duhet të përfundontë në datën 04.12.2019. Gjithashtu nga specialistët e fushës që janë pjesë e grupit të monitorimit të kontratës, nuk jepet argumentim mbi problematikat teknike të evidentuara, në bazë të planimetrive të azhornuar, mbas pajisjes me leje ndërtimi, kështu që afati prej 60 ditë kalendarike është në kundërshtim me DST.

4. Nga auditimi u konstatua se, <u>pas rënies së tërmetit, të datës 21.09.2019</u>, DPSHP më datë 03.11.2019, i është drejtuar Institutit të Ndërtimit për të bërë verifikimin e qëndrueshmërisë së godinës. **Kërkesa** për vlerësimin për të bërë ekspertizën nuk ka ndodhur në momentet fillestare mbas rënies së termetit, por **43 ditë me vonesë**, ndonëse praktikisht më datën 25.09.2019, është miratuar Amendimi II i Kontratës nr.01/7 prot datë 13.06. 2017 në lidhje mbi shtyrjen e afatit.

Pas verifikimit të kryer nga punonjës së IN, me anë të shkresës nr.1610 prot datë 15.11.2019 me lendë ñDërgim relacioni teknik mbi verifikimin në terren të institucionit publikò, kanë arritur në konkluzion **që nuk mund të lejohet ndërtimi i një kati shtesë dhe se duhet të riparohen elementët jo strukturore si plasaritjet në muret ndarës, rifinitura etj.**

<u>Sa më sipër</u>, nga titullari i kohës i AK z. E.H., me shkresë nr.1636 prot datë 19.11.2019 i është kërkuar kontraktorit ñC.ò shpk dhe supervizorit ñD.ò shpk, që në mbështetje të nenit 36, 45 të kontratës bazë nr.01/7 prot., datë 13.06.2017, për mos ndërtimin e shtetës së katit të tretë.

-Grupi i auditimit, nisur nga këto kushte konstaton se;

(**a**) Leja e Ndërtimit nr.2256 datë 20.08.2019, tashmë e kishte humbur efektin ligjor, pasi është aplikuar për shtesë të katit të sipër dhe shtesë anësore. Nisur nga këto kushte DPSHP, duhet të kishte aplikuar për leje të re, në zbatim të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 ñPër

planifikimin dhe zhvillimin e teritoritò i ndryshuar, neni 27 dhe 28, me VKM nr.408 datë 13.03.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar.
(**b**) Konkluzioni, që nuk mund të lejohet ndërtimi i një kati shtesë, nxjerr në pah mangësinë e produktit të procedurës me blerje të vogël realizuar në vitin 2017 me Urdhër prokurimi nr.03 datë 16.03.2017 me objekt ñHartimi i projektit për ñNdërtim shtesë anësore dhe shtesë kati në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Provësò me fond limit në vlerën prej 699,385 lekë.
Realizimi i procedurës në rastet për hartimin të projektit teknik, ka për objekt kryesor, hartimin e raportin teknik, i cili përmban, projektin e zbatimit/konstruksionin e objektit, plani i strukturave dhe detajet, plani i themeleve, plani i përforcimeve dhe/ose restaurimeve, etj), pra është detyra e projektimit e cila shprehet nëse objekti lejohet të mbajë një katë shtesë.
(**c**) Nga auditimi, u konstatua se, operatori ekonomik fitues i procedurës me objekt ñHartimi i projektit për ñNdërtim shtesë anësore dhe shtesë kati në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Provësò, e cila është realizuar në vitin 2017, është paguar nga DPSHP me USH nr. 827 datë 05.11.2019, ku pagesa është bërë pothuajse në momentin kur nga DPSHP i është kërkuar IN të shprehet për vazhdimesinë e punimeve për katin shtesë.
5. Nga auditimi u konstatua se, me shkresë nr.1630 prot datë 18.11.2019 nga titullari i AK (E.H.) është bërë kërkesë drejtuar kontraktorit ñC.ò shpk dhe supervizorit ñD.ò shpk, të bëjnë disa ndryshime në projektin-zbatimit të objektit, duke i specifikuar ato. Nga auditimi, nuk është konstatuar ndonjë memo apo PV nga grupi i monitorimit të kontratës, në të cilin ka 2 specialistë të fushës së ndërtimit ose nga hartuesi i projektit teknik për këtë objekt, për dakortësinë e ndryshimeve.
- Nga mbikëqyrsi i punimeve ñD.ò shpk, me shkresë nr1648.prot datë 22.11.2019 të, janë paraqitur dhe është kërkuar AK/DPSHP të miratojë ndryshimet e kërkuara në projektin teknik, duke e shoqëruar, bashkëlidhur me vizatimet dhe me ndryshimet e kërkuara të preventivit.
- Me shkresë nr.1679 prot datë 03.12.2019 të DPSHP e hartuar nga shoqëria ñD.ò shpk, drejtuar Sipërmarrësit të Punimeve ñC.ò shpk, i kërkohet që *"...në zbatim të rekomandimeve të Institutit të Ndërtimit dhe të AK kati shtesë nuk të bëhet dhe se shtesa anësore e objektit mbaron në kuatën + 10.20 m. Ju lutemi të merrni masa që punimet ti mbyllni sa më shpejt të jetë e mundur.*ò
-Ndërsa, në bazë të PV të datës 05.03.2020, midis DPSHP, OE fitues dhe të mbikqyrësit, kanë bërë evidentimin dhe sistemimin e punimeve që zbriten dhe që shtohen, të punimeve të ndërtimit të objektit në fjalë, duke lënë të njëjtën vlerë investimi prej 18,149,747 lekë me tvsh.
6. Nga auditimi u konstatua se, nga OE ñC.ò shpk, ka pasur vonesa për realizimin e kontratës sipas grafikut të punimeve dhe mbas amendimeve të kontratës. Për këtë qëllim si nga mbikëqyrsi dhe nga AK janë përcjellë shkresat si vijon:
- datë 30.01.2020 me nr.131 prot të DPSHP;
- datë 03.03.2020 me nr.317 prot të DPSHP;
- nga grupi i monitorimit të kontratës, nëpërmjet memo nr.323 datë 04.03.2020, drejtuar titullarit të AK të kohës z.B. D. (Drejtor i Përgjithshëm, në mungesë dhe me urdhër, Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë) shprehen se *".....në vijim të komunikimeve të mëparshme dhe takimeve të organizuara në kantier me të gjitha palët e përfshira në kontratë është konstatuar se, nga ana e Kontraktorit të Punimeve nuk kanë përfunduar punimet e parashikuara në kontratë të cilat kanë sjellë problematika në mbarëvajtjen e funksionimin e Institucionit"*.
-Me mbarimin e punimeve sipas njoftimit të bërë nga OE ñC.òshpk dhe mbikqyrësi i punimeveòD.òshpk, **data e përfundimit 17.07.2020**, nga grupi i monitorimit të kontratës me përbërje (G.L. dhe E.M., A.K.), sipas memo nr.831 datë 19.08.2020, drejtuar titullarit të AK të kohës z.B. D. shprehen se : *"...duke qenë në kushtet e mosplotësimit të kushteve të*

*kontratës, sugjerojmë kërkesën pranë mbikëqyrësit të punimeve, kontraktorit të punimeve dhe në dijeni të Ministrisë së Drejtësisë për prezantimin e dosjes përfundimtare të kontratës me objekt e mësipërm, në rast të kundërt jemi të detyruar për ndërprerjen e kontratës dhe njoftimin e Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe zbatimin e nenit 37.3 në të cilin cilësohet se :Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likujdueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë AK duhet ti japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.*ò

-Në datën 28.09.2020 mbikqyrësi i punimeve ñD.ò shpk, me shkresë nr.951, ka dorëzuar në DPSHP, dosjen e objektit me dokumentacionin, e dorëzuar në kohë të vonuar, në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, Udhëzimit nr.1 datë 16.06.2011 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ñPër mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.

-Me shkresë nr.514 prot datë 18.05.2021, nga titullari i AK i kohës (z.A.K. në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare) drejtuar shoqërisë ñC.òshpk dhe për dijeni ñD.ò shpk, midis të tjerave shprehet se *"Duke qënë në kushtet e tejkalimit të afateve të përcaktuar në nenin 2, të Amendamentit shtesë, me nr.1356/1 prot datë 25.09.2019 dhe në zbatim të nenit 37.3 të kontratës bazë ku përcaktohet që "AK mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë AK duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyet e zbritjes dhe nenit 38 pika 1, gërma a): "Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punës do të llogarisim me tarifat e mëposhtme: a)Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*ò. *Ju njoftojmë se jemi në proces të llogaritjes së dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve*.ò

-Sipas Memo me nr.530 prot datë 19.05.2021, hartuar nga znj.H. M. në cilësinë e nëpunësit zbatues (në mungesë dhe me Urdhër Specialiste finance në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse) drejtuar titullarit të AK i kohës z.A.K., shprehet duke e informuar se*"..Në Drejtorinë e Financës është dorëzuar kërkesa me nr.prot 01 datë 26.04.2021 për likujdimin e Situacionit Përfundimtar dhe firmosjes të formularit të vlerësimit, ju bëj me dije se, DPSHP nuk disponon fonde të planifikuara për likujdime të Situacionit Përfundimtar të firmës fituese shoqëria "C."shpk në shumën 10,436,115 (dhjetëmilion e katërqind e tridhjetë e gjashtëmijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë. Specialistja e buxhetit duhet të kishte bërë kërkesë për fonde për likujdimin e detyrimeve të prapambetura në vitin 2020, gjë e cila nuk ka bërë kërkesë për fonde për likujdimin e detyrimeve të prapambetura edhe për vitin 2021, unë si nëpunës zbatues me lind e drejta t'ju vë në dijeni për problemet e krijuara në Institucionin e Shërbimit të provës nga mos zbatimi si duhet i ligjit të planifikimit të Projekt Buxhetin 2021, mungesa e fondit nga ana e Institucionit tonë do të sjell pasoja ekonomike e financiare.*ò

Nga auditimi i pasqyrave fincanciare të vitit 2020, u konstatua se, është reflektuar detyrimi i prapambetur. Informacioni i mësipërm nxjerr mos përputhshmëri, midis veprimeve financiare të pasqyruar në pasqyrat financiare, dhe korrespondencën e nëpunësit zbatues me titullarin e institucionit si dhe në parashikimin e PBA për 2020-2021.

-Nga AK është njoftuar OE ñC.ò shpk, vetëm se është në mospërmbushje të detyrimit kontraktor si dhe në rast të ndërprerjes së kontratës mund të njoftojmë APP, por për vlerën e saktë të penalitetin nuk është njoftuar.

Gjithashtu, grupi i auditimit konstaton se nga AK, në përfundim të kontratës, nuk është mundësuar dërgimi i një kopje të këtij raporti APP-së, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914/2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 3

dhe 4.
Nga auditimi u konstatua se, **vlera e penalitetit prej 9,434,247.96 lekë pa TVSH,** është përllogaritur mbi bazën e vlerës së situacionit përfundimtar 10,436,111 lekë x0,004 = 41,744.46 kostoja ditore e penalitetit x 226 ditë të vonuara= 9,434,247.96 lekë, kjo në bazë të nenit 38 pika 1, gërma (a) të Kontratë Pune nr.01/7 prot datë 13.06.2017.
-Me shkresë nr.743 prot datë 15.07.2021 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, titullari i AK, ka bërë kërkesë fondi për vlerën e mbetur të investimit, duke zbritur penalitetin, duke kërkuar sigurimin e vlerës së mbetur 1,002,342 lekë.(Kontrata është lidhur në vlerën 18,149,747 lekë me tvsh, nga të cilat janë paguar vlera prej7,327,950 lekë me tvsh dhe vlera e ngelur nesë nuk do të kishim penalitete do të ishte në vlerën prej10,436,111 lekë me tvsh)

7. Nisur nga **realizimi i kolaudimit si dhe marrja në dorëzim të përkohshëm të objektit nga DPSHP në cilësinë e AK, ndonëse të realizuara me vonesë**, konstatuam se në bazë të Situacionit Përfundimtar dorëzuar më datë 28.09.2020 miratuar nga Autoriteti Kontraktor (z.B.D. në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, nga Kontraktori ñC.òshpk Drejtuesi teknik ing.E.H. dhe Drejtuesi Ligjor N.C. dhe nga Mbikqyrësi i Punimeve ñD.òshpk Drejtuesi Ligjor ing.E.D., i shoqëruar me Faturë Tatimore nr.serisë 18954415 datë 14.09.2020 nga ñC.òshpk me NIPT K07729920F (firmosur vetëm nga OE, likujdimi i vlerës nuk është realizuar), u konstatuan në zërat e preventivit Punime MKZ(Fikse zjarri 30 copë); Instalimi i kamerave vëzhguese 11 copë;Kondicionimi (kondicioner 14 copë).
Nisur sa më sipër, grupi i audituesve të KLSH-së, në cilësinë e anëtarëve të grupit të auditimit më datë 02.11.2021, realizuam kontrollin fizik në magazinën e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në prani znj.H. M. në cilësinë e nëpunësit zbatues në mungesë dhe me urdhër dhe znj. A.K. në cilësinë e Magazinieres, duke mbajtur Akverifikimin nr.1 datë 03.11.2021 me nr.1295 prot të DPSHP, për të konstatuar gjendjen faktike të pajisjeve të cilat në momentin, kur OE ka filluar rikonstruksionin, kondicionerët, kamerat dhe fikset e zjarrit, të cilat ishin gjendje, duhej të kalonin në magazinë, duke verifikuar se, ndodheshin gjëndje në magazinë 11 (njëmbëdhjetë) copë kondicioner, 9 (nëntë) copë fikse zjarri prej të cilave 2 të mëdha dhe 7 të vogla, për të cilat nga Institucioni nuk është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, si dhe nuk janë shoqëruar me fletë-hyrje, veprime në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 37.
Gjithashtu me mbarimin e punimeve OE në preventivin përfundimtar preventivin përfundimtar të shoqërisë ñC.ò shpk, në zërat furnizim/vendosje u konstatua se 14 (katëmbëdhjetë) copë kondicioner, 30 (tridhjetë)copë fikse zjarri dhe 11 (njëmbëdhjetë) kamerave vëzhguese, të vendosura në preventiv janë të pashoqëruara me dokumentacionin financiar, në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 35/b dhe pika 37.
Veprimet e mësipërme nga punonjësit e DPSHP , janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 37 ñHyrja e aktiveve në magazinë dokumentahet në çdo rast me fletë hyrje përkatëse të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë hyrja lëshohet nga magazinieri pasi të jetë bërë më parë verfifikimi fizik i sasisë i cilësisë dhe i çmimit.ò
8. Nga auditimi u konstatua se, shoqëria ñC.òshpk ka paraqitur Formularin e Garancisë së Kontratës nga data 13.06.2016 deri më datë 11.08.2017, dhe nuk është bërë rinovimi i saj, në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar neni 49 pika b/(iii), për shkak se rikonstruksioni i objektit ka filluar punimet më datë 26.08.2019 dhe ka mbaruar më datë 17.07.2020,për pasojë nuk është rinovuar, Formulari i Sigurimit të Kontratës në vlen e 10% të vlerës së investimit, përgjegjësi e Titullarit të AK sipas kohës.

Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, kanë ***observuar mbi Projektraportin me shkresë nr.120/2 prot të DPSHP datë 28.02.2022, prot nr.935/10 datë 01.03.2022 të KLSH****,*z. A.K. ish-Drejtori i Përgjithshmëm (në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare), me shkresën nr.349 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.2, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin, nga z.B.D. në cilësinë ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) me shkresë nr.1452 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.2, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin, nga z.E.H. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), me shkresë nr.350 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.2, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin.

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

1.*(Observimi nga z.A.K.)* Pasi u njoha me e-mail , me Urdhërin nr.56 datë 19.05.2021 kam urdhëruar ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve të kontratës.

Në Memon nr.549 të datës 27.05.2021 jam informuar nga inspektori z.E.G. , se për shkak të konfliktit të interesit, mbi zbatimin e këtij urdhëri, dy ekspertë kanë qenë pjesë e grupit të ndjekjës së kontratës dhe për këtë arsye bazuar në kuadrin ligjor në fuqi nuk mund të jenë anëtarë në komisionin e marrjes në dorëzim.

Në memon nr.570 prot e përgatitur nga specialistja e burimeve njerëzore znj.K.S., jam informuar se me anë të urdhërit nr.60 datë 31.05.2021, është shfuqizuar urdhri datë 19.05.2021, pasi dy ekspertët e fushës kanë deklaruar se janë në konflik interesi si dhe duke marrë shkas nga fakti që në MD nuk ka espertë të tjerë për fushën e ndërtimeve dhe as në DPSHP nuk të punësuar të fushës për marrjen në dorëzim të punimeve, është e nevojshme marrja e ekspertëve të jashtëm me anë të procedurës së prokurimit me qëllim ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të punimeve.

2.*(Observimi nga z.A.K.).*Me memo nr.714 prot datë 07.07.2021 jam informuar nga znj.H.M., specialiste e financës (Nëpunëse zbatuese në detyrë) ndërt të tjera, se *"...Nga përllogaritja e ditëve të vonesës ka rezultuar që punimet nga shoqëria C. shpk, kanë përfunduar me 226 ditë me vonesë, përllogaritja është bërë sipas tabelës së Excel-it..."Në këtë memo kam bërë shënimin "Të vazhdojë procedura sipas memos znj.M., znj. M..*òNë vijim, bazuar në përllogaritjet e bëra sipas memo nr.714 prot datë 07.07.2021, me shkresën nr.743 prot datë 15.07.2021 jemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë për fondet në zërin investime në vlerën prej 1,002,342 lekë.

Sqaroj se punimet sipas kontratës dhe amendimet duhet të përfundonin në datë 04.02.2019. Për vitin 2019 rezulton fondi i plotë për zbatimin e kësaj kontrate, i cili ka qënë i miratuar nga Ministria e Financave në zërin 231 ñinvestimeò

Për vitin 2020 dhe 2021 DPSHP, nuk ka patur të planifikuara dhe të miratuara fonde. Në kushtet kur OE ñC.òshpk nuk përfundoi punimet dhe nuk zbatoi kontratën brenda vitit 2019, fondet që ishin planifikuar për likujdimin e këtij investimi nuk u përdorën dhe për pasojë diferenca e palikujduar shuma prej 10,436,111 lekë , ka kaluar përsëri në buxhetin e shtetit.

3.*(Observimi nga z.B.D.).*Për sa i përket problematikave të pretenduara në aktkonstatimin nr.2, ju parashtroj se realizimi i kolaudimit si dhe marrja në dorëzim të përkohshëm të objektit nga DPSHP në cilësinë e AK është realizuar me vonesë për shkak të afateve të procedurave të prokurimit për realizimin e kolaudimit sipas parashikimeve ligjore.

4.(Observimi nga z.E.H.)Amendimi i dytë është kërkuar nga ana e shoqërisë ñC.ò me kërkesën e datës 02.09.2019, me lëndë ñKërkesë për spostimin e linjës elektrike dhe kanalizimeve të ujrave të zeza për lirimin e SH.t të ndërtimitò.Në datën 20.09.2019 shoqëria , në vijim të kërkesës së datës 02.09.2019, ka kërkuar AK ñkërkesë për zgjatje të afatit të mbarimit të punimeveò. Mbi këtë bazë në datën 24.09.2019, mbikqyrsi i punimeve shoqëria ñD&Cò i është drejtuar AK me kërkesë ñkërkesë për shtyrjen e afatit të mbarimit të punimeveò. Në datën 25.09.2019 grupi i punës për ndjekjen dhe realizimin e kontratës , ka drejtuar AK Memo ku argumenton hartimin e një Amendamenti për zgjatjen e afatit të punimeve me një afat 60 ditor.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>

1. Vendosja e dy ekspertëve të fushës punonjës së MD që në hartimin dhe miratimin e Urdhërit nr.56 datë 19.05.2021 nga titullari i AK, ka qënë në konfliktit të interesit, pasi dy ekspertë kanë qenë pjesë e grupit të ndjekjës së kontratës dhe për këtë arsye bazuar në kuadrin ligjor në fuqi nuk mund të jenë anëtarë në komisionin e marrjes në dorëzim.

Kjo situatë është krijuar si pasojë, pasi Titullari i AK (DPSHP) z.K. ka angazhuar burime njerëzore, të cilët nuk janë trajnuar pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për pasojë kemi raste parregullsie dhe paqartësie mbi ecurinë e realizimit, të afateve, në lidhje mbi proceset e prokurimit publik.**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

2.Nga AK është njoftuar OE ñC.ò shpk, vetëm se është në mospërmbushje të detyrimit kontraktor si dhe nuk është dergura një raport monitorimi APP gjatë ekzekutimit të kontratës dhe mbarimit të saj. Me mbarimin e punimeve, nga AK (DPSHP) nuk është njoftuar me shkresë zyrtare OE, për vlerën e saktë prej 9,434,247.96 lekë pa tvsh, si penalitet shkaktuar nga vonesat për dorëzimin e objektit dhe për rrjedhojë pasqyrohen dhe diferenca e vlerës së mbetur për likujdim.**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

3. Realizimi i procedurave me blerje të vogël, të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të objektit, janë të realizuara me vonesë në kohë nga njëra tjetra duke e kaluar afatin prej 30 ditë, në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, Udhëzimit nr.1 datë 16.06.2011 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ñPër mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.

Vonesa e realizimit të kolaudimit, marrjes në dorëzim të përkohshmëm, është shoqëruara me dokumentacionin jo të plotë financiar nga kontrolli fizik në magazinë u verifikua se, ndodheshin gjëndje në magazinë 11 (njëmbëdhjetë) copë kondicioner, 9 (nëntë) copë fikse zjarri prej të cilave 2 të mëdha dhe 7 të vogla, për të cilat nga Institucioni nuk është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, si dhe nuk janë shoqëruar me fletë-hyrje, veprime në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 37.

Ndërsa sipas preventivin përfundimtar të shoqërisë ñC.ò shpk, në zërat furnizim/vendosje u konstatua se 14 (katëmbëdhjetë) copë kondicioner, 30 (tridhjetë)copë fikse zjarri dhe 11 (njëmbëdhjetë) kamerave vëzhguese, të vendosura në preventiv janë të pashoqëruara me dokumentacionin financiar, në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 35/b dhe pika 37.**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

4.Gjatë procesit të prokurimt për shpalljen e OE fitues, garuesit njihen me kërkesat dhe preventivin, kështu që nga ana e OE dhe mbikqyrsit të punimeve ñnjiheshinò duke marrë përsipër realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit. Gjithashtu ndonëse brenda muajit shtator 2019, nga ana e titullarit të AK, janë bërë dy amendime (e dyta me ndryshim grafiku punimesh) përsëri nga OE nuk u realizua në kohë.Shtesa anësore ishte parashikuar

që në krye të herës, për rrjedhojë në preventiv ishin parashkikuar punimet.**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

Titulli i Gjetjes:	Auditimi mbi zbatimin e Kontratë Pune nr.01/7 prot datë 13.06.2017 I ndryshuar, me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò (DPSHP).
Situata:	Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës së procedurës së prokurimit publik realizuar në vitin 2017, me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò (DPSHP) me vlerë investimi prej 18,149,747 lekë me TVSH, është lidhur Kontrata Punës nr.01/7 prot datë 13.06.2017 me OE fitues ñC.ò shpk , ku grafiku për realizimin e punimeve është 38 ditë kalenderike, pra duhet të mbaronte më datë 31.07.2017, por punimet në objekt kanë filluar kanë më datë 26.08.2019 dhe kanë mbaruar më datë 17.07.2020, për shkak të mangësive si vijon: Sa më sipër , nga auditimi i zbatimit të kontratës janë konstatuar mangësitë si vijon: **(i)** Në vitin 2017, nga AK nuk ishte aplikuar në kohë, për marrjen e Lejes së ndërtimit, shkak i cili ka ndikuar që, fillimi u punimeve në objekt, kanë nisur me vonesë prej 2 vite e 2 muaj, përgjegjësi e AK, si dhe nga ana e institucioneve të tjera shtetërore konkretisht, Bashkia Tiranë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për shkak të vonesave në kohë, për pajisjen e lejes së ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar, neni 27 dhe 28, me VKM nr.408 datë 13.03.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar dhe LPP. **(ii)** Nga titullari i AK i kohës (z. E. H.), janë miratuar dy Amendime të kontratës, duke ndryshuar grafikun e punimeve nga 38 ditë kalendarike në 60 ditë kalendarike, në kundërshtim me DST dhe kontratën bazë dhe rregullat e prokurimit publik. **(iii)** Mbas mbarimit të punimeve më datë 17.07.2020, në funksion të rikonstruksionit të godinës nga AK janë realizuar dy procedura prokurimi me blerje të vogël, me objekt kolaudimin në dhjetor të vitit 2020 dhe marrjen në dorëzim e objektit në qershor të vitit 2021, të realizuara me vonesë në kohë nga njëra tjetra duke e kaluar afatin prej 30 ditë, në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, Udhëzimit nr.1 datë 16.06.2011 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **(iv)** Sipas preventivit përfundimtar të OE fitues ñC.ò shpk, në zërat furnizim/vendosje u konstatuan, 14 (katërmbëdhjetë) copë kondicionerë, 30 (tridhjetë) copë fikse zjarri dhe 11 (njëmbëdhjetë) kamerave vëzhguese, të pashoqëruara me dokumentacionin financiar hyrje dhe dalje, në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 35/b dhe pika 37. **(v)** Për këtë kontratë nga AK i DPSHP, janë realizuar dy pagesa për situacionet pjesore 1& 2 me vlerë prej 7,327,950 lekë me TVSH duke mos përfshirë 5% e garancisë së punimeve, ndërsa pjesa tjetër sipas Situacionit Përfundimtar dorëzuar në DPSHP nga operatori ekonomik më datë 29.08.2020 në vlerën prej 10,436,115 lekë pa TVSH nuk është likuiduar. Për vonesën e pajustifikuar nga OE fitues ñC.ò kontrata prej 226 ditë të vonuara,(punimet kanë filluar më datë 26.08.2019 dhe kanë mbaruar më datë 17.07.2020) është krijuar **vlera e penalitetit prej 9,434,247.96 lekë pa TVSH,** e

	përllogaritur mbi bazën e vlerës së situacionit përfundimtar (i papaguar nga AK) 10,436,111 lekë x0,004 = 41,744.46 kostoja ditore e penalitetit x 226 ditë të vonuara= 9,434,247.96 lekë, kjo në bazë të nenit 38 pika 1, gërma (a) të Kontratë Pune nr.01/7 prot datë 13.06.2017. Për vlerën e saktë të penalitetit, AK ende nuk ka njoftuar OE me shkresë zyrtare. **(vi)** nuk është bërë rinovimi i Formularit të Sigurimit të Kontratës 10% të vlerës së investimit, në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar neni 49 pika b/(iii). **(vii)** Nga AK, në përfundim të kontratës, nuk është dërguar APP-së një kopje të raportit të monitorimit të saj, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914/2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 3 dhe 4. (**viii**) konstatimet e mësipërme, tregojnë se nga ana e DPSHP në cilësinë e AK, ka angazhuar burime njerëzore, të cilët nuk janë trajnuar pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për pasojë kemi raste parregullsie dhe paqartësie mbi ecurinë e realizimit, të zbatimit dhe monitorimit të kontratave të prokurimeve publike.
Kriteri:	Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò; ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò Udhëzimin nr.30 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik
Ndikimi/Efekti:	Zbatimi me vonesë i Kontratës nr.01/7 prot datë 13.06.2017 i ndryshuar, me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò (DPSHP), nga 38 ditë është realizuar për 36 muaj.
Shkaku:	Burime njerëzore angazhuar , të cilët nuk janë trajnuar pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike për pasojë kemi raste parregullsie dhe paqartësie mbi ecurinë e realizimit, të afateve, në lidhje mbi proceset e prokurimit publik.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	-Ministria e Drejtësisë si organ qëndror në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në cilësinë e intitucionit të varësisë, të marrë masa për personat e ngarkuar me përgjegjësi, në lidhje me mangësitë e konstatuara gjatë procesit të zbatimit të kontratës nr.01/7 prot datë 13.06.2017 me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomicitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në Buxhetin e Shtetit. -Nga DPSHP të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, për njoftimin e OE ñC.òshpk, për vendosjen penalitetit në vlerën prej 9,434,247.96 lekë, si pasojë e vonesave në dorëzimin e në kohë të objektit, i cili do të mbahet nga pagesa e mbetur e pa realizuar ende nga DPSHP. -Të merren masa nga DPSHP që në të ardhmen të kërkojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik që të planifikojë trainime të stafit që merret me prokurimet publike, me qëllim rritjen e nivelit profesional në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik si dhe vendosjes së kritereve të konkurrimit.

2.3 Mbi përputhshmërinë ligjore të veprimeve të kryera në lidhje me strukturën organizative marrëdhëniet e punës, paga e shpërblime, bazuar në aktet ligjore në fuqi.

Për të realizuar objektin, auditimiu fokusua, në përputhshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore për çështjet si vijon:

a) Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

b) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

1. Rregullorja e brendshme dhe urdhrat për organizimin dhe funksionimin
2. Urdhrat e Kryeministrit për miratimin e struktures dhe organikes për periudhen objekt auditimit
3. Struktura Organizative e Sherbimit të Provës dhe numri i punonjësve
4. Listepagesa, Urdher Shpenzime të pagave
5. Planet e nevojave për rekrutim, Dosje të personelit të punësuar
6. Vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna
7. Informacion mbi punonjës të larguar nga puna gjatë periudhës 2018, 2019, 2020 deri në fund të muajit qershor të vitit 2021 të cilët kanë ngritur padi.
8. Veprimtaria e komisionit disiplinor.

a) Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

<u>Struktura organizative</u>

DPSHP është pjesë e sherbimit civil, si Institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Organizimi dhe funksionimi i DPSHP mbështetet në Urdhërin nr.55, datë 20.04.2017 të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës" i ndryshuar.* Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.152/2013 *"Për nënpunësin civil"* i ndryshuar, DPSHP përfshihet për herë të pare në skemen e administrimit të shërbimit civil. Përfshirja në listën e intitucioneve të Administratës Shtetëroreò, të cilat janë pjesë e shërbimit civil, është parashikuar në VKM nr.142 datë 12.03.2014 *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e administratës shetërore dhe Intistucionet e pavarura" i ndryshuar.*

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me respektimin e strukturave të Shërbimit të Provës për periudhën 01.01.2018 deri më 30.06.2021, u konstatua se Shërbimi i Provës ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të:

(1) Urdhërit të Kryeministrit nr.55, datë 20.04.2017 ñ*Miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës* ò me numër total të strukturës plan 148 punonjës.

(2) Urdhërit të Kryeministrit nr.149, datë 01.10.2018 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës* ò numri total i strukturës plan u ndyshua pasi nga 148 u bë 147 punonjës. Ky ndryshim vjen pasi në Drejtorinë e Finances dhe Buxhetit është shkurtuar vendi i punës i specialistit të TI.

(3) Urdhërit të Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës*ò numri total i strukturës plan nuk u ndryshua (147 punonjës). Ky ndryshim strukture është kërkuar ñ*Në mungesë dhe me urdhër Drejtori i zyrës vendore të sherbimit të provës"* drejtuar ministrisë së Drejtësisë në bazë të Relacionit me shkresë nr. 175, datë 07.02.2020.
Struktura plan që ka DPSHP deri më datën 30.06.2021.

DPSHP e realizon aktivitetin dhe veprimtarinë e saj nëpërmjet 22 Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës, të cilat janë të shpërndara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë sipas Rretheve Gjyqësore.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës përbëhet nga:
a) Drejtori i Përgjithshëm
b) Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare
c) Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike
d) Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

2. Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës përbëhen nga:
a) Drejtori i zyrës;

b) Specialistët e Shërbimit të Provës

DPSHP është organ përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të Mbikqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Mbikëqyrja elektronike është mekanizmi që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

Në funksion të kësaj ministria e Drejtësisë ka lidhur kontrata nr.8383/10 prot, datë 21.02.2017 me objekt ñPërmirësimi i sistemit të mbikqyrjes elektronike në fushën penaleò me bashkimin e operatorëve ekonomikë ñS. S. & F. & R.ò e cila mundëson blerjen dhe mbikqyrjen elektronike të ñpajisjes së gjurmimit/byzylykut elektronikò.

Në strukturën dhe organiken e DPSHP është Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike (DME), Drejtori e cila garanton zbatimin e mbikëqyrjes elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor. DME në strukturen e saj ka 15 punonjës nga të cilet 1 Drejtor Drejtorie dhe 14 specialistë.

Nga auditimi u konstatua se ministria e Drejtësisë i ka derguar shkresë DPSHP nr.6473/1 prot, datë 20.09.2019 ku e njofton ñse Ministria e Drejtësisë si Autoriteti Kontraktor ka vendosur ndërprerjen e kontratës nr.8383/10 datë 21.02.2017 me objekt ñPërmirësimi i sistemit të mbikqyrjes elektronike në fushen penaleò.

Për pasojë, nga data 20.09.2019, datë në të cilën është zgjidhur zyrtarisht kontrata e sipërcituar e në vijim, funksionimi i DME-së **është jo në përputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit,**pasi nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për të cilat është krijuar dhe gjithashtu nuk ka realizuar procesin e mbikqyrjes elektronike, duke sjellë përdorimin pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në lidhje me shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve të Drejtorisë së mbikqyrjes elektronike në vlerën **14,291,182** lekë. Të dhënat mbi shpenzimet për pagat e punonjësve të DME nga data 20.09.2019 deri 30.06.2021në mënyrë analitike jepen në Aneksi 1/1 tek pjesa ñAnekseò.

<u>Delegimi i komepetencave Drejtorit të Përgjithshem.</u>

Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.5082 prot datë 21.08.2017 i ka kaluar përgjegjësitë për drejtimin administraviv të Sherbimit të Provës z.E.H. i cili është nëpunesi civil i nivelit më të lartë të institucionit. Ky pozicion është mbajtuar për rreth 2 vjet e 4 muaj, deri me datë 30.12.2019 datë kur ka mbushur moshën për pension.

Me shkresë nr.6563 prot datë 31.12.2019 ministri i Drejtesisë i ka kaluar përgjegjesitë për drejtimin administrativ të Shërbimit të Provës z.B. D. i cili do të ushtronte kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës. Pozicion ky të cilin e ka mbajtuar për rreth 1 vit deri me datë 11.02.2021.

Gjithashtu me shkresë nr.875/1 prot datë 11.02.2021 Ministri i Drejtesisë i ka kaluar përgjegjesitë për drejtimin administrativ të Sherbimit të Provës z.A.K., aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Inpektimit dhe Sherbimeve Komunitare, i cili do të ushtronte kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Proves në mungesë te ketij të fundit. Pozicion ky të cilin vashdon ta mbajë ende.

Titulli i gjetje	Delegimi i komepetencave Drejtorit të Përgjithshem.
Situata:	Nga auditimi konstatohet **s**e pozicioni i Drejtorit të Përgjthshëm të Shërbimit të Provës ka qenë dhe është vakant për një periudhën 4 vjecare, nga muaj gusht i vitit 2017. Gjatë kesaj periudhe respektive Ministri i Drejtësisë e ka deleguar në mungesë dhe me porosi, ndërkohë që Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 10, përcakton qartë vetëm emërimin e

	Drejtorit të Përgjithshme dhe kriteret që ai duhet të plotësojë, por nuk parashikon delegim të kompetencave në afate të papërcaktuara. Gjithashtu shkresa e Minstrit të Drejtësisë me nr.875/1 datë 11.02.2021, i cili i ka kaluar kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Sherbimit të Provës z. A.K., i referohet VKM nr.302 datë 25.03.2009, VKM e cila është shfuqizuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr 78/*2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës".*
Kriteri:	Ligji nr.78/2020 ñPër Organizimin dhe Funksionet e Sherbimit të Provësò,
Ndikimi/Efekti	Mungesa e zbatimit të dispozitave ligjore në lidhje me emërminin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Shërbimit të Provës.
Shkaku	Mungesë efektiviteti në drejtimin institucional.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa të menjëhershme për të propozuar pranë Këshillit të Ministrave plotësimin e vendit të lirë/vakant në pozicionin ñDrejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Titullari i DPSHP me shkresë nr.597 prot datë 19.06.2020 ka ngritur grup pune për hartimin e rregullores së veprimtarisë së Sherbimit të Provës. Grupi i punës ka hartuar draft rregulloren dhe ia ka derguar me e mail titullarit të DPSHP me datë 10.08.2020. Po në të njejtën datë titullari i DPSHP i ka derguar me e-mail rregulloren për miratim Ministrisë së Drejtësisë.
Ndërkohë në zbatim të Ligjit nr.78, datë 25.06.2020 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës*ò, me Urdhër të Ministrit nr.8154 prot., datë 31.12.2020 është miratuar Rregullorja e brendshme e shërbimit të provës dhe me VKM nr.421 datë 08.07.2021 është miratuar rregullorja *"Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Sherbimit të provës"*.

Titulli i gjetje	Planifikimi i nevojave për rekrutim dhe Rregullorja e brendshme,
Situata:	-Nga auditimi konstatohet se në zbatim të strukturës dhe organikës së Sherbimit të Provës të Miratuara nga Kryeministri me urdhër *nr.55, datë 20.04.2017, nr.149, datë 01.10.2018 dhe nr.63, datë 07.05.2020*, nuk ka një rregullore që të përcaktojë detyrat funksionale që ka cdo Drejtori, sektor dhe punonjës i DPSHP. Pavarësisht se DPSHP ka hartuar nje draft rregullore që përcakton detyrat funksionale që ka cdo Drejtori, sektor dhe punonjës, ministria e Drejtësisë nuk e ka miratuar ketë rregullore. -Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, KM ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues. Në funksion të këtij detyrimi ligjor DPSHP ka bërë planifikimin e rekrutimit për vitin 2019, ku me datë 14.12.2018, ka dërguar në DAP ñPlanin e nevojave për rekrutim për vitin 2019ò dhe me shkresën nr.1650 prot datë 22.11.2019 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ka dërguar në DAP ñPlanifikimin e nevojave për rekrutim për vitin 2020ò. Gjithashtu DPSHP i ka derguar DAP-it kërkesat për plotesimin e vendeve vakante në cdo rast kur ka pasur vënde të lira me ane te shkresve nr.986 prot datë 07.10.2020, nr.1010 prot 13.10.2020, nr.152 datë 08.02.2021, nr 190 prot datë 16.02.2021, nr.264 prot datë 05.03.2021, nr 265 prot datë 05.03.2021, nr.280/1 datë 12.03.2021, nr.284/1 prot datë 16.03.2021, nr.377 dhe 378 prot datë 08.04.2021, nr.513 prot datë 18.05.2021, nr.540 prot datë 25.05.2021 DAP ka publikuar vendet vakante dhe ka pasur rekrutime, por vakancat e krijuara janë pasi ka pasur dhe largime dhe dorëheqje të punonjësve. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.78, datë 25.06.2020 *"Për organizimin dhe funksionimin e sherbimit të provës"* është ndryshuar fjala nga ñ**Zyrat vendore"** në **"Drejtoritë territoriale"**, ndërkohë që kërkesat për planifikimet dhe

	shpalljet në DAP bëhen me emrin ñZyrat vendoreò sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës* ò.Gjithashtu DPSHP nuk ka dërguar Planin e nevojave për rekrutim për vitin 2021 në kundërshtim me *nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil".* Për veprimet e sipërme persona përgjegjes janë: znj. K.S..
Kriteri:	-Ligji nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, nenit 18, Kreu II, -Vendimi nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave. Ligji nr.78/2020 ñPër Organizimin dhe Funksionet e Sherbimit të Provësò. Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 20 pika c.
Ndikimi/Efekti	Punonjësit e DPSHP i realizojnë detyrat e tyre funksionale pa pasur një rregullore të brëndshme që të përcaktojë detyrat funksionale që ka cdo Drejtori, sektor dhe punonjës i DPSHP.
Shkaku	Mungesë koordinimi midis ministrisë së Drejtësisë dhe DPSHP.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa për miratimin e rregullores së brendshme, në menyrë që cdo pozicion pune dhe punonjës të ketë të përcaktuar detyrat e tij funksional. -Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa për saktësimin e termit nga ñ**Zyrat vendore"** ne **"Drejtoritë territoriale"** tek Urdhëri i Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës* ò me qëllim që ndryshimet ligjore të reflektohen në aktet nënligjore që rregullojnë strukturës organike të DPSHP.

Observacion i subjektit mbi Akt konstatimin nr.9, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 29.12.2021 me nr.935/6 prot.

Pretendimi i subjektit: Për sa i përket mos dorëzimit të planit për rekrutim për vitin 2021 nga DPSHP ju informoj se unë si Nepunës Zbatuese mua me janë deleguar vetem deryrat e NZ dhe jo përgjegjesit e detyrave funsionale për pozicionin e Drejtorit të Finaces dhe Shërbimeve Mbeshtetese.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: ***Observacioni merret në konsideratë.***

Emërimet

Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, në DPSHP janë emëruar gjithsej 54 punonjës, nga të cilët 52 punonjës me status Nëpunësi Civil, dhe 2 punonjës me Kod Pune.
Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në DPSHP janë emëruar gjithsej 22 punonjës, nga të cilët 21 punonjës me status Nëpunësi Civil dhe 1 punonjës me Kod Pune
Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në DPSHP janë emëruar gjithsej 2 punonjës, nga të cilët 1 punonjës është emëruar me status Nëpunësi Civil dhe 1 punonjës me Kod pune.
Për periudhën 01.01.2021-30.06.2020, në DPSHP janë emëruar gjithsej 11 punonjës, nga të cilët 11 punonjës janë emëruar me status Nëpunësi Civil

Largimet

Për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, në DPSHP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 66 punonjësve, për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	12	18%

Largime per shkak te pavlefshmerise se aktit te emerimit dhe mos permbushjes se kritereve per pozicionin ne te cilin ishin emeruar	54	82%
Totali	66	

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në DPSHP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 10 punonjësve për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	8	80%
Dalje në pension	1	10%
Largim me procedure sipas Kodit te Punes	1	10%
Totali	10	

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në DPSHP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 7 punonjësve për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	4	57%
Vendim i Komisionit Disiplinor	2	29%
Largim me procedure sipas Kodit te Punes	1	14%
Totali	7	

Për periudhën 01.01.2021 - 31.03.2021 në DPSHP i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 11 punonjësve për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	8	73%
Vendim i Komisionit Disiplinor	1	9%
Pezullim me afat 2-vjecar	2	18%
Totali	11	

Administrimi i Dosjeve të Personelit.

-Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e DPSHP zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje rastesore të dosjeve të personelit rezultoi se ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 ñPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò.

Për periudhën objekt auditimi 2018-30.06.2021 është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Vlerësimi i fundit periodik është ai i periudhës janar ï qershor të vitit 2021.

U audituan gjithsej 47 dosje personale të punonjësve të DPSHP-së, nga të cilët:

-37 dosje personale të nëpunësve të rekrutuar sipas Ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar;

-1 dosje personale të nëpunësve të punësuar në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

-2 dosje personale të studentëve të ekselencës, të punësuar sipas VKM nr. 766, datë 26.12.2018 ñPër punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019ò dhe VKM Nr. 586, datë 30.8.2019 ñPër

punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetëroreò;
-1 dosje personale të punonjësve mbështetës, të punësuar sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;
- 2 dosje personale të punonjësve me kontratë të përkoshme (6 orë/ditë), të punësuar sipas VKM-së ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò dhe VKM Nr.1151, datë 24.12.2020, ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò.
- 3 dosje personale Drejtor i përgjithshëm *(I komanduar)*
- 1 dosje personale Drejtor Drejtorie

Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se, janë plotësuar në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, ñ*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit*. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : Lidhja nr. 1*"Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe* Lidhja nr. 2*"Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit;4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;"17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).*

a) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Nga auditimi në lidhje me pagat e punonjësve të DPSHP, u konstatua se:
Në bazë të të dhënave në tabelat e mëposhtme pasqyrohen treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese 2018-2020.
Nga auditimi rezultoi se fondi i pagave për vitin 2018, u planifikua në vlerën 93,194,380 lekë dhe u realizua në vlerën 91,744,384 lekë (ose 98.44% ndaj planit përfundimar).
Nga auditimi rezultoi se fondi i pagave për vitin 2019, u planifikua në vlerën 100,794,000 lekë dhe u realizua në vlerën 98,295,919 lekë (ose 97.52% ndaj planit përfundimar).
Nga auditimi rezultoi se fondi i pagave për vitin 2020, u planifikua në vlerën 102,864,000 lekë dhe u realizua në vlerën 99,366,294 lekë (ose 96.6% ndaj planit përfundimar).

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar fondi i pagave plan dhe fakt për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në DPSHP.

Nr	Viti 2018 emertimet	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga (600)	93,194,380	91,744,384	98.44%
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	16,856,000	15,239,973	90.41%
Totali		**110,050,380**	**106,984,357**	**97.21%**

Nr	Viti 2019 emertimet	Plan	Fakt	Realizimi në %

1	Paga (600)	100,794,000	98,295,919	97.52%
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	16,806,000	16,382,243	97.48%
Totali		**117,600,000**	**114,678,162**	**97.52%**

Nr	Viti 2020 emertimet	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga (600)	102,864,000	99,366,294	96.60%
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	16,806,000	16,544,837	98.45%
Totali		**119,670,000**	**115,911,131**	**96.86%**
Nr	**Viti 2021 emertimet deri ne 30.06.2021**	**Plan**	**Fakt**	**Realizimi në %**
1	Paga (600)	115,094,000	47,674,553	41.42%
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	20,506,000	7,949,669	38.77%
Totali		**135,600,000**	**55,624,222**	**41.02%**

-Krahasimi përmbledhës i listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesave të kryera. U bë krahasimi përmbledhëses së listë pagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nënpunësi urdhërues, zbatues (Punonjesi i financës) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit .

-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhornimi periodik i rregjistrit të punëmarrësve (libri i pagave). Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunsve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit , kuvendit, komisionit qëndror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura , institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit , lidhja 1 ñ*Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendim*iò

Nga auditimi rastesor me përzgjedhje i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori I-të dhe të II-të 2018; 3/mujori I-të 2019, 3/mujori II-të 2020 dhe 3/mujori I-të 2021) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhoje rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklarimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ñPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, Ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 ñPër sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar dhe Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar. Listëpagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo

kategori dhe ndalesat janë përllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.
Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës Ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve.
Nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuara nga emërimi, fillimi marrëdhënieve të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.

Fondi Veçantë

Për periudhën objekt auditimi, (Drejtoria e financës dhe shërbimeve mbeshtetëse) në zbatim te *VKM Nr.929, datë 17.11.2010 " Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" i ndyshuar* ka planifikuar dhe realizuar fondin e veçantë, si më poshtë:

Nr.	Viti buxhetor	Fondi i pagave i planifikuar	Fondi i vecante I planifikuar)	Fondit i vecante i Realizuar
1	2018	93,194,380	0	0
2	2019	100,794,000	200,000	**100,000**
3	2020	102,864,000	200,000	**86,530**
4	6 mujori i pare i vitit 2021	115,094,000	200,000	**60,000**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e financës dhe shërbimve mbeshtetëse.

Nga auditimi në lidhje me destinacionin e përdorimit të fondit të veçante në respektim të përcaktimeve të *VKM Nr.929, datë 17.11.2010 I ndryshuar* u konstatua:
Gjate periudhës objekt auditimi fondi veçantë është përdorur në këto destinacione:

Nr.	Vitet	Ndarja sipas natyres se perfitimit		Totali (në lekë) i realizuar
		Ndihma per pension pleqerie (në lekë)	Ndihma per fatkeqesie ose vdekje (në lekë)	
1	2018	**0**	**0**	**0**
2	2019	0	100,000	**100,000**
3	2020	86,530	0	**86,530**
4	Deri 30.06.2021	0	60000	**60,000**
Shuma 2018-2021		**86,530**	**160,000**	**246,530**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e financës dhe shërbimve mbeshtetëse.

Siç tregohet në tabelën me sipër për vitin 2019 janë dhënë ndihmë për sëmundje të rëndë që kërkohet ndërhyrje kirurgjikale për 2 punonjës përkatësisht me urdhër shpenzimet nr.471 datë 15.07.2019 është paguar ne shumën 50,000 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr.558 date 07.08.2019 është paguar në shumën 50,000 lekë, në total janë paguar 100,000 lekë. Për vitin 2020 është dhënë ndihmë për daljen në pension për 1 punonjës me urdhër shpenzimin nr.353 datë 15.05.2020 ne shumën 86,530 lekë.

Gjithashtu për vitin 2021 janë dhënë ndihmë për vdekje të nje anëtari të familjes 2 punonjës përkatësisht me urdhër shpenzimet nr.158 datë 05.03.202021 është paguar në shumën 30,000 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr.434 date 27.05.2021 është paguar në shumën 30,000 lekë. Në total për periudhen objekt auditimi nga fondi i vecantë është paguar 246,530 lekë.

Proceset Gjyqësore

-Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë planifikuar për artikullin buxhetor 602, 74 Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna, si me poshtë:

Vitet	Shpenzimet Gjygjsore	
	Plan	Fakt
2018	0	0
2019	2,014,000	2,784,670
2020	3,480,000	2,547,072
Deri 30.06.2021	370,000	361,440
TOTAL	**5,864,000**	**5,693,182**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Financës dhe shërbimeve mbeshtetëse.

Detyrimi i paguar, ndarë në vlerë detyrimi dhe tarifë përmbarimore, për gjithë periudhën e auditimit, paraqitet në tabelë dhe në listat bashkëlidhur.

Viti	Pershkrimi	Pagese për vendimin gjyqesor	Pagesë përmbarimore	TOTALI
2019	Pagese per Vendimet gjyqesore	2,519,422	265,248	2,784,670
2020	Pagese per Vendimet gjyqesore	2,192,396	354,676	2,547,072
2021	Pagese per Vendimet gjyqesore	565,472	41,720	607,192
	TOTALI	5,277,290	661,644	5,938,934

Shpenzimet gjyqësore për periudhen objekt auditimi së bashku me shpenzimet përmbarimore më të detajuara në tabelën e mëposhtë.

Vendimet Gjygjesore tw likujduara					
Vendimit Gjyqwsore tw formwz sw prerw	Nr Urdhwr Shpenzimeve dhe datat e paguara		Pagese per vendimin gjyqesor	Permbaruesi	Shuma Totale
13.07.2017	145	11.03.2019	231,450	26,400	**257,850**
09.11.2016	183	20.03.2019	420,440	36,000	**456,440**
24.01.2019	304	06.05.2019	477,140	36,000	**513,140**
06.06.2019	538	24.07.2019	702,000	84,240	**786,240**
11.02.2019	1029	31.12.2019	688,392	82,608	**771,000**
10.12.2019	638	07.08.2020	236,760	26,400	**263,160**
01.10.2020	903	13.11.2020	216,840		**216,840**
01.10.2020	1020	16.12.2020	1,738,796	328,276	**2,067,072**
01.10.2020	159	19.03.2021	325,440	36,000	**361,440**
12.09.2017	802	29.09.2021	240,032	5,720	**245,752**
		-	5,277,290	661,644	**5,938,934**

Titulli i gjetje	Zgjidhja e kontratave të punës dhe ekzekutimi me zyrë përmbarimore i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për gjyqfituesit.
Situata:	Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 7 ish-punonjës në vlerën totale 5,938,934 lekë, nga ku për vitin 2019 në vlerën 2,784,670 lekë, për vitin 2020 në vlerën 2,547,072 lekë dhe për vitin 2021 ne vlerën 607,192 lekë. Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat duke paguar tarifa përmbarimore, në vlerë totale prej 661,644 lekë nga ku për vitin 2019 në vlerën 265,248 lekë, për vitin 2020 në vlerën 354,676 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 41,720 lekë. Gjithashtu për periudhën objekt auditimi 01.01.2018ï 30.06.2021,janë në proces gjyqësore 7 çështje me objekt marëdhëniet e punës, si dhe për 6 çështje është marrë vendim i formës së prerë në Gjykatën e Apelit. Për 1 çështje është pranuar sigurimi i padisë për rikthimin në punë të paditesit z.T.K. vendimi i gjykatës vazhdon të mbetet i pa zbatuar. Vendimit gjyqësore janë shpenzim jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e DPSHP-së, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej **5,938,934 lekë.** Veprimet e sipërme nuk janë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveò ku citon se ñ*Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve", nenit 451/a ku citon se "Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët" dhe neni 510/a "Titujt ekzekutivë*ò. Për veprimet e sipërme persona përgjegjes janë: znj.A.N., znj. H. M., z. G.Z. dhe z. G. M.
Kriteri:	-Kodi Procedurës Civile - Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i punës i Republikës së Shqipërisëò -Ligi nr.152/2013, ñPër Nëpunësin Civilò i ndryshuar - Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritò
Ndikimi/Efekti	Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë nga zyrat përmbarimore, sjell kosto shtesë në shpenzimet buxhetore të institucionit.
Shkaku	Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me ekzekutim vullnetar apo me marrëveshje me gjyqfituesin për të evituar kryerjen e tyre me zyrë përmbarimore.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	DPSHP të kryej ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me ekzekutim vullnetar apo të gjejë mekanizmat e nevojshme për arritjen e një marrëveshje me gjyqfituesit për likujdimin e tyre, me qëllim shkëputjen e zyrës përmbarimore në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe si rrjedhojë një reduktim të shpenzimeve të DPSHP-së.

1.Titulli i gjetje	Njohja dhe kontabilizimi i vendimeve e proceseve gjyqësore.
Situata:	Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë:

	-për vitin 2016 në shumën prej 456,440 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2019; -për vitin 2017 në shumën prej 471,482 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2019 dhe 2021, nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për tâu shlyer. Si pasojë llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019,2020 dhe 2021. Konkretisht për vitit 2018-2021, ky zë për vendimet gjyqësore reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, si dheUdhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 34 dhe 42. Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPSHP për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Për veprimet e sipërme persona përgjegjes janë: znj.A.N., znj. H. M.,
Kriteri:	-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*ò, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, pika 34 dhe 42.
Ndikimi/Efekti	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
Shkaku	Mungesë bashkëpunimi të sektorit të finances dhe buxhetit me sektorit sherbimeve mbeshtetëse ceshtje ligjore.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Sektori i Financës dhe i buxhetit të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me sektorit sherbimeve mbështetëse dhe ceshtje ligjore, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit. - Sektori i Financës dhe i buxhetit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura. - Sektorit i sherbimeve mbështetëse dhe ceshtje ligjore, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

2.4 Mbi auditimin e përputhshmërisë me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së Shërbimit të Provës/drejtorive përbërëse dhe drejtorive rajonale në varësi të tij, për arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë.

Shërbimi i Provës është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe është organ i centralizuar, i organizuar në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës (*këtu e më poshtë DPSHP*) dhe në nivel vendor nëpërmjet degëve territoriale të Shërbimit të Provës, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Misioni i Shërbimit të Provës është promovimi i përfshirjes shoqërore të personave nën mbikëqyrje, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së 4 përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të posaçme.

Struktura e DPSHP është miratuar me Urdhrin nr.55, datë 20.4.2017 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provësò, ndryshuar me Urdhrin Nr. 63, datë 7.5.2020 e cila përbëhet nga 3 drejtori: Drejtoria e Inspektimit&Shërbimeve Komunitare, Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike dhe Drejtoria e Financës&Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtoria e Inspektimit&Shërbimeve Komunitare.

Për periudhën 2018 deri në qershor 2020 (*me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.78/2020*), bazuar në nenin 9 të VKM nr. 302, datë 25.3.2009 ñPër miratimin e rregullores ñPër organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò, pika ñaò dhe ñdò, Drejtori i Përgjithshëm kontrollon veprimtarinë e Shërbimit të Provës. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, Drejtori i Përgjithshëm nxjerr urdhrin për inspektim të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës (*këtu e më poshtë ZVSHP*) të cilat kryhen nga inspektorët pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare (*DI&SHK*).

Titulli gjetjes:	Parregullësi në arkivimin e dosjeve të isnpektimit, mos dhënie e rekomandimeve për masa disiplimore për punonjësit e SHP në rastet e konstatimit të shkeljeve dhe mangësive ligjore, mungesa e regjistrit të ankesave nga të dënuarit me mbikqyrje.
Situata:	-Dosjet inspektimit të protokolluara në arkiv të institucionit janë pa fletë inventari jo në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò. -Në asnjë rast nuk janë raportuar pranë ministrit të Drejtësisë përmes analizave vjetore të institucionit dërguar me shkresat respektive nr. 310 prot., datë 14.02.2019, nr. 76 prot., datë 17.01.2020, masa për punonjësit e shërbimit të provës dhe pse evidentohen problematika dhe nxirren përgjegjësitë, shprehur në raportet respektive të inspektimit të ushtruara nga DI&SHK. *Veprimet e sipërme janë përgjegjësi dhe kompetencë e ish Drejtorit të përgjithshëm të DPSHP z. E.H. (*në mungesë dhe me urdhër).
Kriteri:	Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò. VKM nr. 302, datë 25.3.2009, neni 4, pika 1 dhe neni 26, pika ñbò.
Ndikimi:	Studimi jo i plotë i riskut në planifikimin vjetor të inspektimeve, mos dhënie e masave disiplinore për punonjësit e shërbimit të provës, mungesë transparence në regjistrimin e ankesave ndaj punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos zbatimi i kritereve ligjore të përcaktuar në VKM nr. 302, datë 25.3.2009,
Rëndësia:	I ulët
Rekomandimi:	-Të merren masa nga titullari i institucionit në cilësinë e Drejtorit të përgjithshëm të DPSHP, që në rast të konstatimit të shkeljeve disiplinore në dosjet e inspektimit nga inspektorët e SHP-së, të rekomandojë masa disiplinore për ta. -Të merren masa nga DPSHP për inventarizimin e dosjeve të inspektimit.

Në lidhje me Projektraportin nga DPSHP është bërë observacion me shkresën nr.120/2, datë 28.02.2022 nga DPSHP dhe nr. 350, datë 25.02.2022 nga z.E.H. ish Drejtor i DPSHP (në mungesë dhe me urdhër) për të cilin sqarojmë vijon:

Pretendimi i subjektit:

1.Bashkëngjitur shkresës është dërguar ñPlani vjetor i veprimtarisë institucionale të SHP për vitin 2018-2019ò. 2.òJu sqaroj, se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe zyrat vendore kanë regjistrin e kërkesë/ankesave të hartuar sipas Urdhërit nr.4583/1, datë 10.06.2009 të ministrit të Drejtësisë dhe sipas formatit të të miratuar në bazë të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.181, datë 30.06.2009 bashkëngjiturò. 3.òLidhur me pretendimin se nuk ka pasur propozime për masa disiplinorenë vlerësimin tonë nuk është e saktëò. **Qëndrimi i grupit të auditimit**:1.Plani i dërguar për të argumentuar pretendimin është plani i veprimtarisë institucionale dhe nuk është plan vjetor i DI&SHK në lidhje me inspektimet, megjithatë pretendimi **merret në konsideratë** dhe reflektohen ndryshimet në këtë Raport Përfundimtar auditimi. 2. Në lidhje me pretendimin 2, në procesin e auditimit nuk u vu në dispozicion Urdhëri nr.4583/1, datë 10.06.2009 i Ministrit të Drejtësisë dhe urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.181, datë 30.06.2009. Me paraqitjen e këtyre dokumenteve pas shqyrtimit merren në konsideratë dhe reflektohen ndryshimet në këtë Raport Përfundimtar auditimi. 3. Në lidhje me pretendimin 3, sqarojmë se nuk janë raportuar para ministrit të Drejtësisë në analizat vjetore të institucionit, masa për punonjësit e shërbimit të provës dhe pse evidentohen problematika dhe nxirren përgjegjësitë nga inspektimet e ushtruara nga DI&SHK, gjithashtu nuk del se janë rekomanduar në raportet e inspektimit masa disiplinore ndaj inspektorëve, për të cilat ndiqen procedurat e parashikuara nga legjislacioni i nëpunësit civil etj. Në këtë aspekt pretendimi **nuk merret** në konsideratë.

Për vitin **2018** nga DI&SHK janë kryer 19 kontrolle/inspektime (*disa janë të përsëritura*) në ZVSHP-të në lidhje me kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut Në përfundim të inspektimeve janë hartuar raporte duke vënë në dukje problematika mbi bazën e të cilave janë dhënë konkluzione.

Auditimi me zgjedhje i raporteve të kontrolleve të ushtruara për v. 2018 në ZVSHP:

Titulli gjetjes:	Vonesa në përgatitjen e raportit të inspektimit, konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Tiranë.** Nga auditimi u konstatua: -Raporti është paraqitur me vonesë datë 24.09.2018, afati i përcaktuar në urdhër inspektim të Drejtorit të Përgjithshëm është datë 04.09.2018. -Nga Raport Kontrolli i inspektimit kanë dalë disa ñProblematikaònisur nga fakti se ZVSHP Tiranë ka dhe peshën më të madhe të dënimeve dhe problematikat janë të shumta si: ñ..*nga ana e specialistëve duhet patur shumë kujdes në caktimin dhe ndryshimin e frekuencave të takimit... specialistët përdorin arsyetim të përgjithshëm për ndryshimin e caktimin e frekuencës....ndryshimi i frekuencave është bërë pa asnjë argument... në disa raste ... në momentin e paraqitjes së personit nën mbikëqyrje për zbatimin e Vendimit Penal nuk është njoftuar Prokuroria Përkatëse* ..etj.ò Referuar problematikave nga grupi i inspektimit është arritur në ñKonkluzioninò se:ò... *bazuar në VKM nr.302, datë 29.05.2009 dhe të gjitha akteve në fuqi është i mendimit se problematika e konstatuar mbështetur në nenin 21, duke parë dhe ngarkesën e ZVSHP Tiranë, konsiderohen shkelje të lehta, pasi prej tyre nuk ka ardhur asnjë pasojë. Duhet ti bëhet me dije Specialistëve të ZVSHP Tiranë, që shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit të rregullohen dhe të mos përsëriten në të ardhmen*ò. Referuar konkluzioneve të sipërme të inspektimit u konstatua: -nuk është përcaktuar saktë baza ligjore/neni 21, (pika që klasifikon shkeljen),

	-konkluzioni nuk është në raport të drejtë me problematikat, -klasifikimi i shkeljeve si të òlehtaò nuk është në përputhje me nenin 21, pika 3 ku: ñ*shkelje e rregullave të etikës gjatë orarit të zyrtar përbën shkelje të lehtë disiplinore*ò pasi këtu nuk kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës por, me shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullore që lidhen me detyrën funksionale, bazuar në nenin 21, pika 4 VKM nr 302, datë 25.03.2009 ku: ñ*Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore*ò, pasi mos njoftimi i prokurorisë përkatëse referuar nenit 20 të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar, përbën shkelje të VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 5 dhe ngarkon me përgjegjësi specialistin e ZVSHPï së. Gjithashtu shkeljet e konstatuara janë të një game të gjerë dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si ñshkelje të lehtaò. *Veprimet e sipërme të kryer nga inspektorët e kontrollit E.K., A.XH., E.G.dhe S.L. që kanë hartuar Raportin nuk janë në përputhje me VKM Nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, pasi nuk kanë dalë në konkluzion për masë disiplinore për specialistët e ZSHP si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, duke mos nxjerrë përgjegjësinë disiplinore, si dhe z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Përgjithshëm për miratimin e raportit.*
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 5 Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika1 dhe 4.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Vonesa në përgatitjen e raportit të inspektimit, konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Mat.** -Raporti është paraqitur me vonesë datë 22.11.2018, afati i përcaktuar në urdhër nr.3593, datë 31.10.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm është datë 20.11.2018. -Raport Kontrolli i inspektimit datë 22.11.2018, nxjerr si ñProblematikaò: ñ*Mos respektim i procedurës së ndjekur për të dënuarit e nenit 63,....Në dosjen që i përket të dënuarit H.S. është përcaktuar frekuenca e takimit me arsyetimin se i dënuari është i punësuar por nuk ka depozituar vërtetim pune. Nuk është zbatuar detyrimi i cili rrjedh nga neni 20 "Njoftimet gjatë ekzekutimit" të Ligjit Nr.8331, datë 21.04.21998 i ndryshuar*...ò. Referuar problematikave nga grupi i inspektimit është arritur në ñKonkluzioninò señ*në 5 raste janë shkelur dispozitat urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.3.2009....Mbështetur në nenin 21, shikohet si më e arsyeshme këshillimi i Specialistes së ZVSHP Mat,....theksojmë se këto detyra janë lënë dhe në Raportin e Kontrollit të kryer në datën 17-18 korrik 2017....".* Nga auditimi referuar konkluzioneve të inspektimit u konstatua: -Nisur nga problematikat e konstatuara që janë dhe të përsëritura, konkluzioni i nxjerrë për specialistët e ZVSHP Mat, nuk është në raport të drejtë me problematikat, pasi përbëjnë shkelje të rëndë disiplinore bazuar në nenin 21 pika 1

	dhe 4, dhe ndaj specialistes së ZVSHP duhet të ishte aplikuar masë disiplinore, për shkak se ndodhet në kushtet e përsëritjes. Për sa sipër, *veprimi i kryer nga inspektorët e DI&SHP-së E.K., E.G. (A.XH. dhe S.L. nuk kanë nënshkruar) nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores "Mbi procedurat e dhënies së masës disiplinore për punonjësit e Shërbimit të Provës"miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 pasi nuk kanë nxjerrë përgjegjësinë disiplinore për inspektorët e ZVSHP, veprime për të cilat mbajnë përgjegjësi si dhe z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Pergjithshem për miratimin e raportit.*
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4. Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika1 dhe 4.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Përmet, Gjirokastër dhe Sarandë** sipas Urdhrit të inspektimit Nr. 3474, datë 12.10.2018. -Në Raport Kontrollet e mbajtura për ZVSHP-të Përmet, Gjirokastër problematikat e nxjerra janë të njëjta. ñProblematikaò nga inspektimi qëndron në fajktin se ñ..*në momemntin e paraqitjes së personit nën mbikqyrje për zbatimin e Vendimit Penal, duhet të njoftohet menjëherë Prokuroria Përkatëse*.....Detyrim i cili rrjedh nga neni 20 i Ligjit Nr. 8331, datë 21.04.1998 i ndryshuar ....ò. Në lidhje me këtë problematikë është arritur në ñKonkluzionò se ñ....*nga ana e specialistit të ZVSHP janë ndjekur procedurat konform ligjit dhe nga kontrolli nuk u konstatuan shkelje...".* Nga auditimiu konstatua: Problematika e nxjerrë nga inspektimi nuk përputhet me konkluzionin e arritur, pasi mos njoftimi i prokurorisë përkatëse referuar nenit 20 të Ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar, përbën shkelje të VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 5 dhe ngarkon me përgjegjësi specialistin e ZVSHPï së. *Veprimet e sipërme të kryer nga inspektorët e kontrollit E.K., A.XH. dhe E.G.*(S.L. nuk ka nënshkruar) nuk janë në përputhje me VKM Nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4 ku citohet: ñ1) *Shkelja e dispozitave të Ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i ndryshuar, të Kodit të Procedurave Administrative .....ose të kësaj rregulloreje, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore*ò dhe ñ4) *Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore".* -Raporti është paraqitur brenda afatit të parashikuar në Urdhrin Nr.3474, datë 12.10.2018. -Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Sarandë** sipas Urdhrit të inspektimit Nr. 3474, datë 12.10.2018. Nga auditimi u konstatua:

	-Në aktet bashkangjitur praktikës/Memo datë 01.11.2018 (inspektorit E.G.) drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm ka mos përputhje në datat referuese, në kolonën ñlëndaò, periudha e inspektimit është vendosur ñ12-13 Mars 2019 (lapsus)ò . -Shkresë përcjellëse e Raportit nr.735 prot., datë 14.05.2019 nuk përputhet me afatin e kryerjes së kontrollit datë 18-19.10.2018, pra kjo shkresë nuk i korrespondon raportit përkatës të kontrollit. -Raporti i kontrollit nuk i është dërguar për njoftim personit përgjegjës ish drejtorit z A.G. dhe pse rezulton i larguar nga ky institucion, veprim jo në përputhje me Rregulloren ñMbi procedurat e dhënies së masës disiplinore për punonjësit e Shërbimit të Provësò miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 14, pika 2, *tagër i ish Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër Drejtori i Drejtorisë) E. H.*. *Veprimet e sipërme të kryer nga inspektorët e kontrollit E.K., A.XH. dhe E.G.(S.L. nuk ka nënshkruar) nuk janë në përputhje me VKM Nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4 dhe janë kompetencë e tyre dhe e Drejtorit z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Përgjithshëm për miratimin e raporteve.*
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4. Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika1 dhe 4.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Berat**. Nga auditimi u konstatua: -Në Raport Kontroll përgatitur datë 22.01.2018 ñProblematikaò nga inspektimi janë përcaktuar rastet e kapërcimit të afateve të njoftimit të institucioneve ligjzbatuese përsa i përket ekzekutimit të vendimeve penale alternative. Konkretisht nga specialiste Entela Vreko, vërehet se ñ*ka neglizhencë në përpilimin dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të mbarimit të periudhës së provës pranë organit të akuzës për të dënuarin L.Ç.....*ò. Nga inspektorët e kontrollit të DI&SHP megjithëse janë nxjerrë problematikat trajtuar qartë në Raport, nuk është propozuar asnjë masë disiplinore ndaj saj kur është shprehur ñKonkluzioniò. Shkeljet e specialistes janë klasifikuar si shkelje të lehtë disiplinore që nuk sjell pasoja bazuar në nenin 21 të VKM nr.302, datë 25.03.2009. -nuk është përcaktuar saktë baza ligjore/neni 21, (*nuk është vendosur pika konkrete sipas të cilës klasifikohet shkelja*), -konkluzioni nuk është në raport të drejtë me problematikat, - klasifikimi i shkeljeve si të òlehtaò nuk është në përputhje me nenin 21, pika 3 ku: ñ*shkelje e rregullave të etikës gjatë orarit të zyrtar përbën <u>shkelje të lehtë</u> disiplinore*ò pasi këtu, nuk kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës por me shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullore që lidhen me detyrën funksionale, bazuar në nenin 21, pika 4 VKM nr.302, datë 25.03.2009 ku: ñ*Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me*

	*deyuyrën funksionale <u>përbën shkelje të rëndë</u> disiplinore*ò Për sa sipër, *veprimi i kryer nga inspektorët e DI&SHP-së E.K. dhe E.G., (R.L. nuk ka nënshkruar) nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, pasi nuk kanë dalë në konkluzion për masë disiplinore për specialistët e ZSHP si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010*, pasi nuk kanë *nxjerrë përgjegjësinë disiplinore për inspektorët e ZVSHP-së, veprime për të cilat mbajnë përgjegjësi si dhe z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e raporteve.* -Raporti është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në urdhër.
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4. Rregullore miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika1 dhe 4.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, vonesa në përgatitjen e raportit dhe parregullsi në hartimin e tij etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Kurbin**. Nga auditimi u konstatua: -Raporti i kontrollit nuk ka datën e përgatitjes së tij në mënyrë që të vlerësohet nëse është përgatitur brenda afatit të përcaktuar në Urdhrin e inspektimit Nr.1055, datë 07.03.2018, nuk ka nënshkrimin dhe inspektorët që përgatitën Raportin. -Bashkëlidhur praktikës nuk gjendet shkresa përcjellëse për dërgimin e Raportit. -Në Raport Kontrolli, tek seksioni ñProblematikaò shprehen mangësitë e konstatuara mbi mënyrën e ekzekutimit të dënimeve alternative, realizimin e ndjekjes së procedurave funksionale nga kuadri ligjor në fuqi, për të cilën është arritur në ñKonkluzionò se specialisti/a A. M. ñ*ka mangësi të theksuara lidhur me ndjekjen e procedurave të pezullimit të ekzekutimit të punës në interes publik, etj.dhe bazuar në VKM nr.302, datë 25.03.2009 .... është i mendimit se problematika e konstatuar mund të sjellë pasoja të cilat cënojnë objektivat e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Provës*ò. Referuar këtij ñKonkluzionitò, konstatohet se nuk argumentohen shkeljet ligjore të kryera nga specialisti/ja pasi mungon baza ligjore si dhe nuk klasifikohet shkelja disiplinore (*e lehtë apo e rëndë)*. Nga inspektorët mbahen 2 qëndrime në lidhje me të njëjtat problematika. Konkretisht në kontrollin e ushtruar në ZVSHP Berat trajtuar më sipër, nxirren përgjegjësitë dhe arrihet në konkluzion duke klasifikuar shkeljet disiplinore (*pavarësisht klasifikimit të shkeljes disiplinore jo të saktë*). Në rastin konkret problematikat e konstatuara dhe pse përbëjnë shkelje shumë të rëndë disiplinore, nga inspektorët nuk arrihet në një ñKonkluzionò të saktë, pasi nuk rekomandohet asnjë masë për specialistin/en dhe pse janë konstatuar shkelje, veprime këto jo në përputhje me VKM Nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 5 dhe nenin 31, germa ñaò dhe ñivò, kompetencë e inspektorëve *R.L., E.K., dhe A.XH. që kanë ushtruar kontrollin në këtë subjekt dhe e Drejtorit z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Pergjithshem për miratimin e raporteve.*

Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 5 dhe neni 31, germa ñaò dhe ñivò.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika 5 dhe neni 31, germa ñaò dhe ñivò.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Vlorë**. Nga auditimi u konstatua: -Raport kontrolli përgatitur datë 03.10.2018 nxjerr si ñproblematikëò se ñ*në disa raste nga ana e specialistit të ZVSHP Vlorë në momentin e paraqitjes së personit nën mbikëqyrje për zbatimin e Vendimit Penal, nuk është njoftuar Prokuroria Përkatëse*.....ò duke arritur në ñKonkluzioninòseñ*specialistët e ZVSHP Vlorë në momentin e paraqitjes së personit nën mbikëqyrje për zbatimin e vendimit penal, duhet të njoftojnë menjëherë prokurorinë përkatëse...”.* -nuk është cituar nëse problematika e nxjerrë përbën shkelje disiplinore nga specialistët e ZVSHP-së. *Për sa sipër, veprimi i kryer nga inspektori/ët e DI&SHP-së E.G., (E.K. dhe S.L. nuk kanë nënshkruar) nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 2, pasi nuk kanë dalë në konkluzion nëse ka shkelje disiplinore dhe si klasifikohet ajo,si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 duke mos nxjerrë përgjegjësinë disiplinore dhe është kompetencë e tyre dhe e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Pergjithshem z. E. H..* -Raporti është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në urdhër.
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 2 Rregullore miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika 2 .
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Dibër.** Nga auditimi u konstatua: -Raporti kontrolli përgatitur datë 22.11.2018 nxjerr si ñproblematikaò: ñ*P.I.T.(program individual trainimi) është firmosur mbas 1 muaji, nuk është përpiluar shkresa për asistim drejtuar Komisariatit të Policisë, në dosje që i përket*

	të dënuarit H.K.është vendosur frekuenca e takimit një herë në 2 javë dhe nga kqyrja e procesverbaleve konstatohet se është mbajtur 1 herë në muaj etjò dhe arrihet në ñKonkluzioninò se ñ*janë shkelur dispozitat urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.3.2009....si dhe dispozitat urdhëruese të ligjit që sjellin pasoja.....Mbështetur në nenin 21, shikohet si më e arsyeshme këshillimi i drejtuesit të ZVSHP Dibër, .. që shkeljet e konstatuara të mos përsëriten...".* Referuar konkluzioneve të grupit të inspektimit u konstatua: -ñkonkluzioniò nuk është në raport të drejtë me problematikat, në një kohë që është shprehur se janë shkelur dispozitat urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.3.2009, duke sjellë pasoja, por nuk ka nxjerrë përgjegjësitë dhe klasifikuar shkeljen në bazë të nenit 21, -baza ligjore klasifikimi i shkeljeve si të òlehtaò nuk është në përputhje me nenin 21, pika 3 ku: ñ*shkelje e rregullave të etikës gjatë orarit të zyrta përbën <u>shkelje të lehtë</u> disiplinore*ò pasi këtu nuk kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës por me shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullore që lidhen me detyrën funksionale dhe nenin 21, pika 4 VKM nr.302, datë 25.03.2009 ku: ñ*Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale <u>përbën shkelje të rëndë</u> disiplinore*ò. Për sa sipër, *veprimi i kryer nga inspektorët e DI&SHP-së E.K. dhe E.G. (E.K. dhe S.L. nuk kanë nënshkruar) nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, pasi nuk kanë dalë në konkluzion për masë disiplinore për specialistët dhe drejtuesin e ZVSHP-së, si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 duke mos nxjerrë përgjegjësinë disiplinore dhe është kompetencë e tyre dhe e Drejtorit z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Përgjithshëm për miratimin e raporteve.*
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 4 Rregullore miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika 4 .
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Raportet e kontrollit/inspektimit të cilat u audituan nga KLSH por që rezultuan në përputhje ose kishin devijim të vogël nga kriteret, janë paraqitur në Aneksin 2/1 pjesë përbërëse e këtij Projektraport auditimi.

2019

Për vitin 2019 nga DI&SHK janë ushtruar 21 kontrolle/inspektime në ZVSHP ku, në përfundim të inspektimeve janë hartuar Raporte duke vënë në dukje problematika mbi bazën e të cilave janë dhënë konkluzione.

Bazuar në analizën vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës për vitin 2019, dërguar ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.76, datë 17.01.2020 rezulton se referuar konkluzioneve të pasqyruara në Raportet e Kontrollit por dhe nga problemet e ngritura nga Zyrat Vendore, problematikat kanë të bëjnë me infrastrukturën si dhe marrëdhënieve me prokurorinë.

Auditimi me zgjedhje i raporteve të kontrolleve të ushtruara për v.2019 në ZVSHP:

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Korçë.** Nga auditimi konstatohet: Grupi i inspektimit në Raportin e përgatitur datë 06.03.2019 ka nxjerrë disa ñproblematikaò të tilla si: ñ*Raport vlerësimet nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit penal dhe VKM nr.302, datë 25.03.2009, vonesa në tejkalim të afati 5 ditor të vendosjes së kontaktaktit të parë, mungesë të relacioneve përkatëse shoqëruese për zhvillimin e seancave gjyqësore etj*...ò Bazuar në problematikat e konstatuara ka arritur në ñkonkluzioninò mbështetur në nenin 21 të VKM nr.302, datë 25.03.2009 se ñ*problematikat e konstatuara konsiderohen shkelje të lehta dhe prej tyre nuk ka ardhur ndonjë pasojë.... problematikat t'u bëhen me dije specialistëve të ZVSHP-së*ò. Nga auditimi referuar konkluzioneve të grupit të inspektimit u konstatua: -nuk është përcaktuar saktë baza ligjore/neni 21, (*nuk është vendosur pika sipas të cilës është klasifikuar shkelja*), -konkluzioni nuk është në raport të drejtë me problematikat, - klasifikimi i shkeljeve si të òlehtaò nuk është në përputhje me nenin 21, pika 3 ku: ñ*shkelje e rregullave të etikës gjatë orarit të zyrta përbën shkelje të lehtë disiplinore*ò pasi këtu nuk kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës por me shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullore që lidhen me detyrën funksionale, bazuar në nenin 21, pika 4 VKM nr.302, datë 25.03.2009 ku: ñ*Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me deyuyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore*ò Për sa sipër, *veprimi i kryer nga inspektorët e DI&SHP-së E.K., dhe E.G. (S.L. nuk ka nënshkruar) nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, pasi nuk kanë dalë në konkluzion për masë disiplinore për specialistët e ZSHP si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, duke mos nxjerrë përgjegjësinë disiplinore dhe është kompetencë e tyre dhe e z. E. H. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Pergjithshem për miratimin e raporteve.* -Raporti është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në urdhër.
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 3dhe 4. Rregullore miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika 3 dhe 4 .
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Berat.** Nga auditimi konstatohet: ñProblematikaò e dala nga inspektimi i dosjeve dhe trajtuar në Raport kontrolli datë 29.03.2019 janë:shtyrja e frekuencave të takimeve nga një periudhë 1 herë në javë në 1 herë në 3 muaj, pa patur argumenta dhe dokumentacion justifikues, që bën të pamundur qëllimin kryesor që ka Shërbimi i Provës, riintegrimin e të dënuarit në

	shoqëri, në të gjitha rastet përsa i përket zbatimit të detyrimit me punë në interes publik sipas nenit 63 të Kodit Penal nuk ka procesverbal konstatimi në terren mbi detyrimin me punë në interes publik që kryen i dënuari etj. Bazuar në këto problematika, grupi i inspektimit ka arritur në ñkonkluzioninò se ñnë 11 raste janë shkelur dispozitat urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.03.2009 si dhe dispozitat urdhëruese ligjore që sjellin pasoja. Mbështetur në nenin 21 të VKM-së ka rekomanduar këshillimin e dy specialsitëve që shkeljet e konstatuara të rregullohen ...ò. Referuar konkluzioneve të grupit të inspektimi u konstatua: -nuk është përcaktuar saktë baza ligjore/neni 21, pasi nuk është vendosur në bazë të së cilës pikës është klasifikuar shkelja, -konkluzioni nuk është në raport të drejtë me problematikat, -klasifikimi i shkeljeve nuk është në përputhje me nenin 21, dhe bazuar në nenin 21, pika 4, të VKM nr.302, datë 25.03.2009 duhet trajtuar shkelje e rëndë disiplinore pasi vetë inspektorët, shprehen se ñjanë shkelur dispozitat urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.03.2009 si dhe dispozitat urdhëruese ligjore që sjellin pasojaò. Për sa sipër, *veprimi i kryer nga inspektorët e DI&SHP-së S.L., E.G. dhe A.XH. nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, pasi nuk kanë dalë me konkluzion për masë disiplinore për specialistët e ZVSHP si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, duke mos nxjerrë përgjegjësinë disiplinore dhe është janë kompetencë e tyre dhe e z. E. H. në cilësinë eish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Pergjithshem për miratimin e raporteve.*
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4. Rregullore miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika 3 dhe 4 .
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Titulli gjetjes:	Konkluzionet e dala nga inspektimi nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, vonesa në hartimin e Rportit të Kontrollit etj.
Situata:	Praktika e kontrollit të kryer në **ZVSHP Fier.** Nga auditimi konstatohet: -Raportit i kontrollit datë 24.05.2019 është paraqitur me vonesë jo në përputhje me afatin e Urdhrit nr. 617, datë 12.04.2019. -ñProblematikatò e dala nga inspektimi si:Drejtori i zyrës dhe specialistët nuk janë pajisur me dosje personale të akteve, mos dërgimi i njoftimit me informacion mbi të dënuarin në provë drejtuar Policisë së Shtetit për mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve të caktuara nga gjykata etj.nuk janë në raport të drejtë me ñKonkluzionetò e grupit të inspektimit,pasi për Drejtuesin e zyrës dhe specialistët kërkohet që të mos përsëriten në të ardhmen në një kohë që, ato janë trajtuar si shkelje të dispozitave urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.03.2009 si dhe e dispozitave urdhëruese ligjore që sjellin pasoja. -Klasifikimi i shkeljeve si të òlehtaò nuk është në përputhje me nenin 21, pika 3 por bazuar në nenin 21, pika 4 VKM nr.302, datë 25.03.2009 duhet trajtuar shkelje e rëndë disiplinore, pasi në konkluzion është arritur se ñjanë shkelur dispozitat

	urdhëruese të VKM nr.302, datë 25.03.2009 si dhe dispozitat urdhëruese ligjore që sjellin pasojaò. Për sa sipër, *veprimi i kryer nga inspektorët e DI&SHP-së S.L., E.G. A.XH. dhe E.K. nuk është në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4, pasi nuk kanë dalë me konkluzion për masë disiplinore për specialistët e ZVSHP Fier si dhe nenin 7, pika 1, të Rregullores miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010, duke mos nxjerrë përgjegjësi disiplinore për inspektorët e ZVSHP Fier dhe është kompetencë e tyre dhe e z. E. H. në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë dhe ish Drejtorit te Pergjithshem për miratimin e raporteve.*
Kriteri:	Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 òPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar VKM nr.302, datë 25.03.2009 neni 21, pika 1 dhe 4. Rregullore miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 7, pika 1.
Ndikimi:	Mos nxjerrja e përgjegjësive disiplinore dhe rekomandimi i masave të punonjësve të shërbimit të provës.
Shkaku:	Mos respektimi i drejtë i kritereve ligjore të VKM Nr.302, datë 25.03.2009, neni 21, pika 3 dhe 4 .
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Raportet e kontrollit/inspektimit të cilat u audituan nga KLSH por që rezultuan në përputhje ose kishin devijim të vogël nga kriteret, janë paraqitur në Aneksin 2/2 pjesë përbërëse e këtij Projektraport auditimi.

Konkluzion:

Për vitin **2018-2019** rezultoi:

-Dosjet inspektimit janë pa inventarizuar sipas Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò.

-Në asnjë rast nuk janë raportuar pranë ministrit të Drejtësisë përmes analizave vjetore të institucionit masa për punonjësit e shërbimit të provës dhe pse evidentohen problematika dhe nxirren përgjegjësitë, shprehur në raportet respektive të inspektimit ushtruar nga Drejtoria e Inspektimit & Shërbimeve Komunitare

Për periudhën objekt auditimi 2018-2019, veprimet e kryera nga isnpektorët e Drejtorisë së Inspektimit & Shërbimeve Komunitare për praktikat e inspektimit/raportet e kontrollit audituara me zgjedhje, nuk janë në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 pasi:

-Nuk kanë bashkëngjitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm si: urdhrin e inspektimit apo shkresën përcjellëse.

-Në shumicën e rasteve paraqitja e raportit është në tejkalim të afatit të vendosur në urdhrin e inspektimit.

-Konkluzionet e dala nga grupi i inspektimit, nuk kanë të përcaktuar qartë bazën ligjore për klasifikimin e shkeljeve disiplinore, pasi nuk përcaktohet klasifikimi i shkeljeve disiplinore sipas nenit 21 VKM nr.302, datë 25.03.2009 me të cilin është trajtuar shkelja e nxjerrë si problematikë.

-Konkluzioni nuk është në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, pasi nuk propozohen masa disiplinore konkrete.

-Klasifikimi i shkeljeve në disa raste si shkelje të òlehtaò nuk është në përputhje me nenin 21, pika 3 të VKM nr.302, datë 25.03.2009, pasi referuar problematikave të konstatuara nuk kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës apo shkelje të ñlehtaò siç trajtohet në këto raporte, por me shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullore që lidhen me detyrën funksionale të inspektorit të ZVSHP-ve e cila klasifikohet si shkelje e ñrëndë disiplinoreò

-Në një rast (ZVSHP Sarandë) Raporti i kontrollit nuk i është dërguar për njoftim personit përgjegjës ish drejtorit z A.G. dhe pse rezulton i larguar nga ky institucion, jo në përputhje me Rregulloren ñMbi procedurat e dhënies së masës disiplinore për punonjësit e Shërbimit të Provësò miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 14, pika 2.

Viti 2020

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2020, referencat ligjore dhe nënligjore, mbi të cilat ka funksionuar DPSHP dhe njësitë e varësisë së saj, Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, për personat nën mbikëqyrje, janë respektivisht, Ligji nr.7895 datë 27.01.1995 ñKodi Penal i republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr.8485 datë 12.05.2003 ñKodi i Procedurës administrativeò i ndryshuar; Ligji nr.8331 datë 21.04.1998 ñPër ekzekutimin e vendimeve penaleò i ndryshuar; VKM nr.302 datë 25.03.2009 ñPër miratimin e Rregullores ñPër organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standarteve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò; Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë nr.4583/1 datë 11.06.2009 ñPër miratimin e modelit të regjistrave të Shërbimit të Provës, raportit të vlerësimit dhe raportit përfundimtarò; Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.1673, datë 01.12.2010 ñPër miratimin e Rregullores ñMbi procedurat e dhënies së masave disiplinore për punonjësit e Shërbimit të Provësò; Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.189, datë 03.07.2009 ñPër miratimin e modelit të dokumentit ñProgram individual i trajtimitò të të dënuarve me dënime alternativeò; Urdhër nr.1385 datë 25.02.2012 i Drejtorit të Përgjithshëm ñPër aplikimin e Sistemit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë (SVR) në hartimin e raporteve të vlerësimit për të dënuarin/personin nën hetim/ të pandehurin dhe PIT për të dënuarinò; Udhëzim nr.773 datë 19.03.2012 ñPër aplikimin e Sistemit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë (SVR) në hartimin e raporteve të vlerësimit për të dënuarin/personin nën hetim/ të pandehurin dhe PIT për të dënuarinò; Udhëzim nr.710 datë 12.03.2012 ñPër mënyrën e mbikqyrjes të përmbushjes së detyrimeve financiareò; Urdhër nr.194 datë 04.02.2013 ñPër krijimin e dokumentit standart për mbylljen dhe arkivimin e dosjes personale të të dënuaritò; Urdhër nr.1520 datë 08.06.20212 i Drejtorit të përgjithshëm ñPër përdorimin e formularit standart ñGrafiku i shpërndarjes të orëve të punës, për kryerjen e punës me interes publik nga i dënuariò; Urdhër nr.6325 i Ministrit të Drejtësisë, datë 31.07.2009 ñPër miratimin e rregullores ñPër bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-rë dhe Shërbimin e Ndërmjetësimitò.

Në datë 10.07.2020, ka hyrë në fuqi Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, ndërsa VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provësò, ka shfuqizuar VKM nr.302 datë 25.03.2009 ñPër miratimin e Rregullores ñPër organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standarteve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò si dhe aktet e tjera juridike, në mbështetje të saj.

Sa më sipër, nga Drejtoria e Inpektimit dhe Shërbimeve Komunitare për vitin 2020, në bazë të shkresës nr.276 prot datë 25.02.2020, ka paraqitur Planin e veprimit për Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare për Janar-Dhjetor 2020, i cili është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm në mungesë dhe me urdhër z. B.D. Në bazë të metodës krahasimore midis Plani Inspektimi të miratuar, ZVSHP të cilat janë inspektuar nuk janë të njëjta. Gjatë periudhës janar-mars janë inspektuar ZVSHP-Berat, Krujë,Kukës, për periudhën mars deri në tetor të vitit 2020 nuk janë realizuar inspektime për shkak të situatës së krijuar nga pandemi Covid-19, ndërsa për periudhën tetor deri më 30.12.2020, janë inspektuar ZVSHP- Fier, Sarandë, Përmet,Gjirokastër,Vlorë,Lezhë, Mat, Dibër, Durrës, pra **në total janë inspektuar 12 zyra vendore dhe 1 inspektim tematik** pranë ZVSHP-Krujë, nga 22 zyra vendore që ka në administrim dhe varësi DPSHP.

Në bazë të Raporteve të Kontrollit të realizuar në disa Zyra Vendore të Shërbimit të Provës (Krujë, Kukës, Berat, Përmet, Gjirokastër dhe Sarandë) nga Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare me grupin e inspektimit (E.K., A.XH., S.L., E.G.) në DPSHP dhe miratuara nga DP (në mungesë dhe me urdhër z.B.D.), nga auditimi u konstatua se:
(i) Në materialet e paraqitura nuk është dhënë informacion i qartë, mbi aktivitetin total që ushtron ZVSHP, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga ZVSHP si dhe numri total të dosjeve aktive, në mënyrë tillë për të nxjerr ne pah ñngarkesën individualeò të secilit punonjës.
(ii) Nuk është relatur mbi çfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP .
(iii) Dosjet e inspektimit, nuk rezultuan të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.
(iv) Në rubrikën e problematikave të evidentuara nga grupi inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë respektive, por rekomandimet e propozuara janë mjaft më të lehta, duke mos cilësuar neni 21 pika 4 i VKM-së nr.302 datë 25.03.2009, që shprehet se *"Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore.",* për periudhën deri më datë 10.07.2020 ku ka hyrë në fuqi ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò.Kjo situatë paraqitet pothuajse e njëjtë dhe për periudhën deri në 30.06.2021,ndrësa për aplikimin e masave displinore mbas korrik 2020 aplikohet ligji 153/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, i referohet te gjitha akteve ligjore dhe nenligjore të këtij departamenti në rastin në fjale nenev 58 për lloje te masave disiplinore, 59 pika 2 dhe 4 gërma b.
Të njëjtin qëndrim dhe në vendimamarrje ka mbajtur titullari i DPSHP, duke zbehur procesin e inspektimit, duke mos marrë masa për përmirësimin e gjendjes në përputhshmëri me legjislacionin bazik dhe atë sekondar.
Më poshtë po paraqesim mangësitë e paraqitura, sipas ZVSHP respektive si vijon:
1. Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë), Drejtor i Drejtorisë nr.186 datë 10.02.2020 ñPër inspektimin e ZV-SHP Krujëò në datat **11-13.02.2020**, duke dërguar Raport Kontrollin me shkresë nr.277prot datë 25.02.2020.
Nga auditimi u konstatua se, nga grupi inspektimit me përbërje E.G., A.XH. dhe S.L., janë kontrolluar dosjet aktive të specialistëve z. E.K. (drejtues i ZVSHP-Krujë në mungesë dhe me urdhër)si vijon:
- 25 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 4 dosje për të dënuar në bazë të neni 59/a të Kodit Penal (qëndrim në shtëpi);
Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen A.Lisha, si vijon:
- 15 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 5 dosje për të dënuar, neni 63 periudha e provës me disa orë pune në interes publik
- 1 dosje për të dënuar në bazë neni 64.
Në total janë inspektuar, 50 dosje. Në këtë material nuk është relatur mbi cfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP, nuk është paraqitur qartësisht, aktivitetin që ushtron ZVSHP-Krujë, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga ZVSHP si dhe numri total të dosjeve aktive si dhe dosja e inspektimit,

nuk rezulton të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Konluzioni i paraqitur nga grupi inspektimit me përbërje (E.G., A.XH. dhe S.L.) shprehen se ñ*Vihen re se janë shkelur dispozitat urdhëruese të VKM nr.302 datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe përcaktimin e standarteve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"neni 28 pika 2 (Në takimin e dytë me të dënuarin, punonjësi i SHP i caktuar i paraqet dhe shpjegon të dënuarit përmbajtjen e programit individual.Programi individual i trajtimit të të dënuarit, diskutohet më të dënuarin. Ky program mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së të dënuarit.pika 3(Programi individual nëshkruhet nga punonjësi dhi i dënuari dhe, kur i dënuari është i mitur, edhe nga mbrojtësi i tij), neni 29,neni 37 (Programi Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë, ku përcakton të drejtat dhe detyrimet e tëdënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit në përputhje me nenin 28 të kësaj rregullore), neni 38 pika 2(Punonjësi i SHP përcakton në programin individual numrin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe vendin e takimeve me të dënuarin në provë, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje).*

Ndërsa rekomandimi i dhënë nga grupi inspektimit si vijon *"Mbështetur të VKM nr.302 datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe përcaktimin e standarteve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative" neni 21, të shikohet si më e arsyeshme zbatimet e kritereve të përcaktuara në pikën 4 të nenit 21 të të VKM nr.302 datë 25.03.2009. Në përcaktimin e masës disiplinore duhet të kihet parasysh, ngarkesa e ZVSHP Krujë, pasi ka një specialist më pak, eksperienca në punë si dhe për drejtuesin e ZV, i cili është akoma i pa konfirmuar".*

Të njëjtin qëndrim dhe vendim marrje ka marrë z.B.D. në cilësinë e DP(në mungesë dhe me urdhër) përcjellë me Raport Kontrollin me shkresë nr.277 prot datë 25.02.2020.

2.Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë), Drejtor i Drejtorisë nr.1735 datë 13.12.2019 ñPër inspektimin e ZV-SHP **Berat"** në datat **16-20.12.2019**, duke dërguar Raport Kontrollin me shkresë nr.24 prot datë 09.01.2020.

Nga auditimi u konstatua se, nga grupi inspektorëve të caktuar me Urdhër të DPSHP(në mungesë), janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen E.V., si vijon:

- 10 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 3 dosje për të dënuar, për të përfituar ñLirim me kushtò në bazë të nenit 64 të Kodit Penal;
- 2 dosje për të dënuar në bazë neni 59/a , (qëndrim në shtëpi)

Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen B.Gega, si vijon:

- 5 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 5 dosje për të dënuar, neni 63 periudha e provës me disa orë pune në interes publik
- 2 dosje për të dënuar në bazë neni 64.

Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen E.Z., si vijon:

- 10 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 2 dosje për të dënuar, neni 63 periudha e provës me disa orë pune në interes publik
- 1 dosje për të dënuar në bazë neni 64.

Në total janë inspektuar, 40 dosje.Në këtë material nuk është relatur mbi cfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e

organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP, nuk është paraqitur qartësisht, aktivitetin që ushtron ZVSHP-Berat, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga ZVSHP si dhe numri total të dosjeve aktive si dhe dosja e inspektimit, nuk rezulton të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Problematika e paraqitur nga grupi inspektimit me përbërje (E.K., A.XH., S.L., E.G.) shprehen se ñ*Për sa i përket të procedurave të trajtimit të dosjeve në ngarkim nga specialitët e Zyrës Vendore të Shërbimit të provës Berat, rreth mënyrës së ekzekutimit të dënimeve plotësuese të dhëna nga Gjykata e rretheve Gjyqësore u konstatuam se zbatimi i detyrave funksionale të specialistëve të kësaj zyre është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.*ò

Konkluzione e grupit të inspektimit janë ñ*Nga ana e specialistëve të ZVSHP janë ndjekur procedurat konform ligjit dhe nga kontrolli nuk u konstatuan shkelje. Po kështu u konstatua se prombletika e hasur në Inspektimin e mëparshëm është kuptuar dhe rregulluar nga specialistët e kësaj zyre.*ò

3.Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë), Drejtor i Drejtorisë nr.233 datë 14.02.2020 ñPër inspektimin e ZV-SHP **Kukës** dhe Tropojëò në datat **17-20.02.2020**, i cili nuk është realizuar nga DPSHP si dhe në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë), Drejtor i Drejtorisë nr.341 datë 06.03.2020 ñPër inspektimin e ZV-SHP Kukës dhe Tropojëò në datat **12-13.03.2020**si duke dërguar Raport Kontrollin me shkresë nr.919 prot datë 15.09.2020.

Ky raport nuk është realizuar në kohë si dhe për ZVSH-Tropojë nuk është realizuar inspektimi, për shkak tëtë situatës Covid-19, pasi nga Këshilli i Ministrave është miratuar akti nënligjor, për të krijuar garancitë shëndetit të popullsisë në përputhje më Aktin Normativ të Qeverisë nr.243 datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore dhe Pandemia Botërore shpallur nga OBSHò

Nga auditimi u konstatua se, nga grupi inspektimit me përbërje E.G., A.XH. dhe S.L., janë kontrolluar dosjet aktive të specialistes znj. J. Elezajsi vijon:

- 36 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 1 dosje për të dënuar në bazë të neni 59/a të Kodit Penal (qëndrim në shtëpi);

Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen znj.M.G., si vijon:

- 23 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 2 dosje për të dënuar në bazë neni 64.

Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen z. B.B., si vijon:

- 37 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 1 dosje për të dënuar në bazë neni 64.
- 2 dosje për të dënuar në bazë të neni 63

Në total janë inspektuar, 105 dosje.Në këtë material nuk është relatur mbi cfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP, nuk është paraqitur qartësisht, aktivitetin që ushtron ZVSHP-Kukës, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga ZVSHP si dhe numri total të dosjeve aktive si dhe dosja e inspektimit, nuk rezulton të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-

protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Problematika e paraqitur nga grupi inspektimit me përbërje (A.XH., S.L., E.G.) shprehen se ñ*Për sa i përket të procedurave të trajtimit të dosjeve në ngarkim nga specialitët e Zyrës Vendore të Shërbimit të provës Kukës, rreth mënyrës së ekzekutimit të dënimeve plotësuese të dhëna nga Gjykata e rretheve Gjyqësore u konstatuam se zbatimi i detyrave funksionale të specialistëve të kësaj zyre është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.*ò

Konkluzione e grupit të inspektimit janë ñ*Nga ana e specialistëve të ZVSHP janë ndjekur procedurat konform ligjit dhe nga kontrolli nuk u konstatuan shkelje. Po kështu u konstatua se prombletika e hasur në Inspektimin e mëparshëm është kuptuar dhe rregulluar nga specialistët e kësaj zyre.*ò

4.Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë), Drejtor i Drejtorisë nr.42 datë 16.10.2020 ñPër inspektimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës, **Përmet, Gjirokastër dhe Sarandë**ò në datat 19-20.10.2020 në DTSHP-Përmet, në datat 20-22.10.2020 në DTSHP Gjirokastër dhe në datat 22-23.10.2020 në DTSHP-Sarandë, duke dërguar Raport Kontrollin me shkresë nr.1156 prot datë 12.11.2020 nëDTSHP-Sarandë; me nr.1157 prot datë 12.11.2020 në DTSHP-Gjirokastër; me shkresë nr.1155 prot datë 12.11.2020 në DTSHP-Përmet, si vijon:

Nga auditimi u konstatua se, nga grupi inspektimit me përbërje E.G., E.K., A.XH. dhe S.L., në Degën Territoriale **Sarandë**, janë kontrolluar dosjet aktive të specialistit z. A.B. si vijon:

- 25 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);
- 3 dosje për të dënuar në bazë të neni 63 të Kodit Penal (periudhë prove duke realizuar ore pune në interes publik).
- 1 dosje për të dënuar në bazë të neni 59/a të Kodit Penal (qëndrim në shtëpi);

Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen znj. A.B., si vijon:

- 16 dosje për të dënuar në bazë të neni 59 të Kodit Penal (periudhë e provës për një kohë të caktuar nga gjykata);

Janë kontrolluar dosje aktive për punonjesen znj.I.M., si vijon:

- 4 dosje për të dënuar në bazë të neni 63 të Kodit Penal (periudhë prove duke realizuar ore pune në interes publik).
- 1 dosje për të dënuar në bazë të neni 59/a të Kodit Penal (qëndrim në shtëpi);

Në total janë inspektuar, 50 dosje. Në këtë material nuk është relatur mbi cfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP, nuk është paraqitur qartësisht, aktivitetin që ushtron ZVSHP-Sarandë,Gjirokastër dhe Pëmet, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga ZVSHP si dhe numri total të dosjeve aktive si dhe dosja e inspektimit, nuk rezulton të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Problematika e paraqitur nga grupi inspektimit shprehen se ñ*Për sa i përket të procedurave të trajtimit të dosjeve në ngarkim nga specialitët e Zyrës Vendore të Shërbimit të provës Kukës, rreth mënyrës së ekzekutimit të dënimeve plotësuese të dhëna nga Gjykata e rretheve Gjyqësore u konstatuam se zbatimi i detyrave funksionale të specialistëve të kësaj dege, në vija të përgjithshme, vërehet se zbatimi i detyrave funksionale të specialistëve sipas*

*kuadrit ligjor.Nga kontrolli është konstatuar ndryshim frekuence pa depozituar dokumentacionin e nevojshëm*ò

Konluzione e grupit të inspektimit janë ñ*Nga ana e specialistëve të ZVSHP janë ndjekur procedurat konform ligjit dhe nga kontrolli nuk u konstatuan shkelje. Po kështu u konstatua se prombletika e hasur në Inspektimin e mëparshëm është kuptuar dhe rregulluar nga specialistët e kësaj zyre*.ò

Për periudhën deri më 30.06.2021,nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Inpektimit dhe Shërbimeve Komunitare, nuk ka inspektuar në bazë të Plani i Veprimit për Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare, pasi nga Drejtori i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) z.A.K., nuk është miratuar në kohë Plani, por është miratuar me shkresë nr. 846 Prot, datë 01.09.2021. Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, janë realizuar inspektime pranë DTSHP, Elbasan, Dibër, Mat, Pukë,Fier dhe Tiranë (proces), ku po paraqesim DTSHP ku janë konstatuar problematika si vijon:

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, është realizuar inspektimi pranë Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-**Tiranë,** në bazë Urdhërit nr.31 datë 02.03.2021, i ndryshuar me Urdhër nr.31/1 datë 12.03.2021, për shkak të ngarkesës dhe numrit të madh të dosjeve të cilat do inspektohen.

1.Grupit të auditimit, iu vu në dispozicion vetëm Projekt Raport Kontrolli, i dërguar me shkresë nr.636 prot datë 17.06.2021, ndërsa në lidhje mbi materialin e Raportit të Kontrollit, ndërsa Raporti i Kontrollit, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion, me pretendimin se produkti është përtej periudhës së auditimit të datës 30.06.2021.

Grupi i auditimit, në lidhje mbi materialin e Projekt Raport Kontrolli, konstatoi se:

Grupi inspektimit me përbërje E.G., E.K., A.XH. dhe S.L., në Degën Territoriale të Shërbimit të Provës-Tiranë, e ka dorëzuar këtë material më **datë 19.05.2021**, ndërsa nga z.K. është **përcjellë më datë 17.06.2021**.

Nga grupi i inspektimit janë kontrolluar 72 dosje aktive të specialistit znj. D.M., 75 dosje aktive të specialistit T.Ç., 57 dosje aktive të specialistit G.A. ,55 dosje aktive të specialistit J.D.,55 dosje aktive të specialistit E.V.,36 dosje aktive të specialistit E.H., 60 dosje aktive të specialistit E.Z. (H.), 65 dosje aktive të specialistit M.S., 54 dosje aktive të specialistit S.H., 69 dosje aktive të specialistit L.J., 50 dosje aktive të specialistit R.K., 37 dosje aktive të specialistit M.M.,73 dosje aktive të specialistit L.L., 51 dosje aktive të specialistit J.H., 43 dosje aktive të specialistit E.Papa,100 dosje aktive të specialistit E.K.(konform ligjit) , 72 dosje aktive të specialistit E.B. (konform ligjit), 31 dosje aktive të specialistit J.M., 82 dosje aktive të specialistit F.D., 80 dosje aktive të specialistit F.XH.. Gjithsej **janë inspektuar 1217 dosje aktive.**

Në këtë material nuk është relatur mbi cfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP, nuk është paraqitur qartësisht, aktivitetin që ushtron DTSHP-Tiranë, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga DTSHP si dhe numri total të dosjeve aktive si dhe dosja e inspektimit, nuk rezulton të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Problematikat më kryesore të evidentuar, në lidhje mbi zbatimin e procedurave të trajtimit të përsonave nën mbikëqyrje dhe rreth mënyrës së ekzekutimit të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, sipas dosjeve që hartohen dhe plotësohen nga specialistë të DTSH-Tiranë, si vijon:

-Mungesa e proces-verbaleve të takimeve, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 23 pika 6;
-mungesa e kartës ID për vërtetimin e të dënuarit;
- Proces-verbale pa firmat përkatëse;
- Proces-verbale e takimeve nuk përputhen me frekuencën e caktuar në Planin Individual të Trajtimit, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 23;
- Kartela shoqëruese pa firmosur nga specialisti;
- Njoftimi i Prokurorisë mbi fillimin e ekzekutimit të dënimit jashtë afateve të përcaktuara ligjore, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 21 pika 1;
- Në dosje nuk ndodhen Memo për caktimin e ndryshimit të frekuencës së takimeve, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 23;
- Programi Individual i Trajtimit konceptuar e miratuar jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 23;
- Sistemi i Vlerësimit të Rrezikshmërisë jo i plotë, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 20 germa ç;
- Nuk janë realizuar proces-verbalet e takimeve ku të jenë të pasqyruar komunikimi nëpërmjet aparatit telefonik bazuar në planin e masave të ndërmarra për pandeminë Covid-19;
-Mos hartimi i shkresës dhe mosbashkëpunimi me Policinë e Shtetit apo institucioneve të tjera,në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 29 dhe 31.

Nga auditimi u konstatua se, për secilin nga specialistët janë relatuar problematikat e konstatuara si dhe për Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-Tiranë z.B.D., nga grupi inspektimit është konstatuar duke shprehur se ñ*nuk janë marrë masa për zbatimin e nenit 21 pika 1 dhe nenit 23 pika 1 e ligjit nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës", pasi drejtori i Degës Territoriale Tiranë, është përgjegjës për drejtimin, bashkëpunimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave nga specialistët e degës territoriale të Shërbimit të Provës bazuar në neni 11 pika 1 e ligjit 78/2020.*ò

2.Në bazë të Urdhërit nr.49 datë 13.11.2020 ñPër inspektimin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-**Fier**ò, ku Raporti i Kontrollit është përcjellë me shkresë nr.38 datë 11.01.2021 nga Drejtor i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë) z.B.D., duke kontatuar se;

Në total janë inspektuar, 202 dosje. Në këtë material nuk është relatur mbi cfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP, nuk është paraqitur qartësisht, aktivitetin që ushtron ZVSHP-Fier, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të përsonave të dënuar të cilët janë nën mbikqyerje nga ZVSHP si dhe numri total të dosjeve aktive si dhe dosja e inspektimit, nuk rezulton të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Problematika e paraqitur nga grupi inspektimit shprehen se ñ

- Proces-verbale e takimeve nuk përputhen me frekuencën e caktuar në Planin Individual të Trajtimit, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 23;
- Kartela shoqëruese pa firmosur nga specialisti;
- Njoftimi i Prokurorisë mbi fillimin e ekzekutimit të dënimit jashtë afateve të përcaktuara ligjore, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 21 pika 1;
-nuk janë hartuar Raportet e Vlerësimit në fazë hetimi për 5 të pandehur, brenda afatit ligjor, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 18 pika 1."
Konluzione e grupit të inspektimit janë *"Mbështetur në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësit civil", shikohet më e arsyeshme duke parë dhe situatën e krijuar nga Pandemia, këshillimet ndaj specialistëve, që shkeljet e konstatuara nga grupi i inpektimit të rregullohen dhe të mos përsëriten në të ardhmen. Po ashtu, duke parë mangësitë e specialistit brenda kuadrit ligjor, nqs shkeljet e konstatuara vazhdojnë të përsëriten dhe nuk janë kuptuar nga specialistët, lind nevoja e trajnimit të specialisteve sipas përcaktimit të bërë nga ligji nr.78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës" neni 17. Kjo gjithmon në të mirë të punës, zbatimin me përpikmëri të procedurave ligjore në zbatimin e detyrave funksionale, arritjeve të rezultateve më të mira dhe në ngritjen profesionale."*
Sa më sipër, në rubrikën e problematikave të evidentuara nga grupi inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë respektive, por rekomandimet e propozuara janë mjaft më të lehta, përgjëgjësi e grupit të inspektimit. Të njëjtin qëndrim dhe në vendimamarrje ka mbajtur titullari i DPSHP (z.B.D.), duke zbehur procesin e inspektimit, duke mos marrë masa për përmirësimin e gjendjes në përputhshmëri me legjislacionin bazik ligjit nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, të ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësit civilò dhe VKM nr.115 datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, pika 2, përgjegjësi e titullarit të institucionit.

Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, është ***observuar mbi Projektraportin me shkresë nr.120/2 prot të DPSHP datë 28.02.2022, prot nr.935/10 datë 01.03.2022 të KLSH***, nga z. A.K. ish-Drejtori i Përgjithshmëm (në mungesë dhe me urdhër Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare), me shkresën nr.349 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.10, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin, nga z.B.D. në cilësinë ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) me shkresë nr.1452 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.10, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin.

Pretendimi i subjektit:
1*.Observime nga z.A.K.*
ñ***Për vitin 2021*** *nga auditmi u konstatua se Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare, nuk ka inspektuar në bazë të planit të veprimit për Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare për periudhën janar deri në 30 qershor 2021, pasi nga drejtori i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër z. A.K., nuk është miratuar Plani i Veprimit për Drejtorinë Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare"* ky konstatim **duhet të rikonsiderohet nga grupi i auditimit**, pasi më duhet të sqaroj se jam emëruar në detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare në datë 10.02.2021, plani i veprimit për këtë drejtori duhet të ishte miratuar nga paraardhësi në fillimin të vitit.
Më tej, me shkresën nr. 846 Prot, datë 01.09.2021 kam miratuar Planin e Veprimit për Drejtorinë e

Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare shtator-dhjetor 2021 si dhe në vazhdimësi do të miratohet plani i veprimit për këtë drejtori për vitin pasardhës, vitin 2022 (bashkëlidhur do të gjeni planin e veprimit).
Lidhur me konstatimin e grupi të auditimit se ñ*Raporti i kontrollit për Degën Territoriale Tiranë, grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion, me pretendimin e Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) z. A.K., se produkti është përtej periudhës së auditimit të datës 30.06.2021"* **duhet të rikonsiderohet nga grupi i auditimit**, pasi:
Me e-mailin e dërguar në datë 18.10.2021, nga znj. M. H. (përgjegjëse e grupit) është kërkuar vënia në dispozicion të auditimit të dokumentacionit si më poshtë..... ndër të tjera, citoj:
ñ*Planet e punës dhe urdhrat respektive për kryerjen e inspektimeve në Shërbimin e provës/degët Rajonale për vitin 2018-6/mujori 1-2021, në zbatim të nenit 9 pika "d" të V.K.M 302, si dhe raportet mbi inspektimin dhe rekomandimet përkatëse për periudhën nën auditim."*
Me e-mailin e datës 18.10.2021 kam kaluar për trajtim punonjësve të D.P.SH.P (z. E.G. inspektor D.I.SH.K, A.XH. inspektor D.I.SH.K, z. GJ.M.specialist i prokurimeve dhe ceshtjeve ligjore, znj. K.S. specialiste e burimeve njerezore si dhe (sekretare e Drejtorit të Përgjithshëm në detyrë), znj. T.S. specialiste statistikave dhe analizës ligjore, H. M. specialiste finance dhe (nëpunëse zbatuese në detyrë), znj. D.T. speciliste arkive), me shënimin citoj: *"Në vijim të kërkesave të dërguara me email nga grupi i auditimit të K.L.SH të merren masa për vënien në dispozicion këtij grupi mbi informacionet dhe materialet e kërkuara."*
2. (Observime nga z.B.D.) Nisur nga sa më sipër lidhur me pikën një(i)) dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj se grupi i inspektimit të DISHK operon dhe vepron me një urdhër të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm. Në Urdhër janë të përcaktuar qartë detyrat dhe misionin dhe veprimtarine e DISHK lidhur me përshkrimin e punës dhe përcaktimin e detyrave funksionale.
Për sa i përket pikës (ii) DISHK nuk mban përgjegjsi për mungesën e një rregullore dhe se përzgjedhja e dosjeve të inspektuara është bërë në përputhje me urdhrin e nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm.
Referuar pikës (iii) në formularin e përshkrimit të punës të DISHK-së në gërmën c e cila lidhet me Detyrat Teknike dhe pika 3 e saj ku shprehet se : ñ DISHK krijon dosjen përkatëse të inspektimit, në përbërje të së cilës administrohen urdhri përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm, provat shkresore, burimi i krijimit të tyre dhe hartojnë raportin përfundimtar sipas standardeve të miratura nga Drejtori i Pergjithshëm.ò
Nisur me pikën (iv) do të doja të sillja në vëmendjen tuaj se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës tashmë pjesë e shërbimi civil që me hyrjen në fuqi të ligjit 153/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, i referohet te gjitha akteve ligjore dhe nenligjore të këtij departamenti në rastin në fjale nenev 58 për lloje te masave disiplinore , 59 pika 2 dhe 4 gërma b për kopetenca dhe procedura e masave disiplinore të ligjit 153/2013 ñ Për nëpunësin civil si dhe specifikisht në pikën 1 të Udhëzimit Nr. 01, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike në të cilën përcaktohet se *"Eprori direkt kryesisht, ose nëpërmjet ankesave, rekomandimeve, bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara, përkundrejt nënpunësit civil dhe i klasifikon ato"* si dhe pikën 2 e cila flet për kompetencën e fillimit të procedimit disiplinor te vendimit nr.115, datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò. Nga sa me siper del qartësisht se natyra e veprimtarisë dhe punës së DISHK është e karakterit rekomandues dhe konstatues të të gjitha shkelje që vërehen nga ana e kësaj të fundit gjatë ushtrimit të kontrolleve pranë ZVSHP dhe jo e karakterit vlerësues siç pretendohet nga ana e grupit të auditimit. Nga dispozita e sipërcituar kuptohet lehtësisht se është kompetencë dhe përgjegjësi e eprorit për vlerësimin dhe klasifikimin e shkeljeve disiplinore.
3.(Observime nga z.E.G., z. E. K., z.A. XH. dhe z.Sh. L.). Nisur nga sa më sipër lidhur me pikën (i) dëshirojmë të sjeliml në vëmendjen tuaj se grupi i inspektimit të DISHK operon dhe vepron me urdhër të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm. Në Urdhër janë të përcaktuar qartë detyrat dhe misionin dhe veprimtarine e DISHK lidhur me përshkrimin e punës dhe përcaktimin e detyrave funksionale.
Për sa i përket pikës (ii) DISHK nuk mban përgjegjsi për mungesën e një rregullorej dhe se përzgjedhja e dosjeve të inspektuara është bërë në përputhje me urdhrin e nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm.
Referuar pikës (iii) në formularin e përshkrimit të punës të DISHK-së në gërmën c e cila lidhet me

Detyrat Teknike dhe pika 3 e saj ku shprehet se ñDISHK krijon dosjen përkatëse të inspektimit, në përbërje të së cilës administrohen urdhri përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm, provat shkresore, burimi i krijimit të tyre dhe hartojnë raportin përfundimtar sipas standardeve të miratura nga Drejtori i Pergjithshëm.ò

Nisur me pikën katër(iv) do të doja të sillja në vëmendjen tuaj se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës tashmë pjesë e shërbimi civil që me hyrjen në fuqi të ligjit 153/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, i referohet te gjitha akteve ligjore dhe nenligjore të këtij departamenti në rastin në fjale neneve 58 për lloje te masave disiplinore 59 pika 2 dhe 4 gërma b për kopetenca dhe procedura e masave disiplinore të ligjit 153/2013 é é é

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>

1.Me marrjen e detyrës së DP (Në mungesë dhe me urdhër) z.K. është Drejtor Inspektimi në Shërbimin e Provës, ku në detyrën funksionale është inspektimi, kështu që hartimi i Planit Vjetor të Inspektimit dhe me marrjen e detyrës së re më datë 10.02.2021, duhej të përmirësohej mungesa e Planit, në mënyrë të tillë që institucioni të këtë vazhdimësinë e ecurisë në normalitet.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

2.Për vitin 2020, z.D. është dhe në cilësinë e DPSHP (në mungesë dhe me urdhër) si dhe për muajin tetor 2020 e në vazhdim deri më 30.06.2021, grupi i auditimit është shprehur se **"**në rubrikën e problematikave të evidentuara nga grupi inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë respektive, por rekomandimet e propozuara janë mjaft më të lehta, përgjëgjësi e grupit të inspektimit. Të njëjtin qëndrim dhe në vendimamarrje ka mbajtur titullari i DPSHP (z.B.D.), duke zbehur procesin e inspektimit, duke mos marrë masa për përmirësimin e gjendjes në përputhshmëri me legjislacionin bazik ligjit nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, të ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësit civilò dhe VKM nr.115 datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, pika 2, përgjegjësi e titullarit të institucionit.ò**Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.**

3.Grupi i auditimit, gjatë auditimit të dosjeve të inspektimit, i është referuar konstatimeve të evidentuara nga grupi i inspektimit, duke konstatuar se, në rubrikën e problematikave të evidentuara nga grupi inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë respektive, por rekomandimet e propozuara janë mjaft më të lehta, përgjëgjësi e grupit të inspektimit.Padyshim që përgjegjësia më e lartë është e titullarit të institucinit, por produkti i grupit të inspektimit është baza esenciale, e cila ka për qëllim me njohjen e problematikave gjate ecurisë së procesit të punës nese ka, si dhe me marrjen e masave për përmiresimin e punës në DPSHP.Gjithashtu dosjet e inpektimit nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit.**Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.**

Titulli i Gjetjes:	Auditimi i përputhshmërisë me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së shërbimit të provës/drejtorive përbërëse dhe drejtorive vendore në varësi të tij, për arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.06.2021.
Situata:	Plani i Veprimit për Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare (DISHK), për vitin 2020, është miratuar nga DP në bazë të shkresës nr.276 prot datë 25.02.2020, duke përcaktuar ZVSHP për inspektim. Nga auditimi u konstatua se, ZVSHP të cilat janë inspektuara nuk janë të njëjta me ato të cilat ishin miratuar në Planin e Veprimit, kjo për shkak të situatës së krijuar nga pandemi Covid-19. Gjithsej, janë realizuar 12 inspektime dhe 1 inspektim tematik në ZVSHP, nga 22 zyra vendore që ka në administrim dhe varësi DPSHP. Ndërsa, për periudhën 01.01.2021 deri më 30.06.2021, DPSHP nuk ka miratuar Planin e Veprimit për DISHK, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, përgjegjësi e Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) z. A. K.. Plani i Veprimit është miratuar më datë 01.09.2021 me shkresë nr.846 prot. Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, janë realizuar 6 inspektime rast pas rasti

	në Degët Territoriale të Shërbimit të Provës (DTSHP) emërtimi sipas ligjit të mësipërm. Nga auditimi i raporteve përfundimtare të inspektimit nga DISHK për vitin 2020 dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, u konstatua se: **(i)** Në rubrikën e problematikave të raporteve të inspektimit, të evidentuara nga grupi inspektimit për vitin 2020, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë në kundërshtim me VKM-së nr.302 datë 25.03.2009 neni 21 pika 4, të bëra nga specialistët dhe nga drejtuesit e ZV/DTSHP, ndërsa rekomandimet e propozuara prej tyre, e më pas të miratuara nga titullari i institucionit, ishin mjaft më të lehta, ndonëse akti nënligjor shprehet se *"Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore."* Kjo situatë paraqitet pothuajse e njejtë dhe për periudhën 01.101.2021 deri në 30.06.2021, ku problematikat e evidentuara në raportet përfundimtare të inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 11 pika1;neni 18 pika1; neni 21 pika 1 dhe neni 23, të bëra nga specialistët dhe nga drejtuesit e ZV/DTSHP, ndërsa rekomandimet e propozuara prej tyre, e më pas të miratuara nga titullari i institucionit, ishin mjaft më të lehta. Në këtë rast për vendosjen e masave disiplinore, duhej të aplikohej ligji 153/2013 ñPër Nëpunësin Civilò dhe VKM nr.115 datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, pika 2. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi grupin e inspektimit me përbërje (E.G., E.K., A.XH. dhe S.L.,) dhe ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) (B.D. dhe A.K.), të cilët, duke mos marrë masa për përmirësimin e gjëndjes në përputhshmëri me legjislacionin bazik dhe atë sekondar , përbën shkak për rritjen e risqeve të veprimtarisë së DPSHP. **(ii)** Në raportet përfundimtare nuk është dhënë informacion i qartë, mbi aktivitetin total që ushtron ZVSHP/DTSHP, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të personave të dënuar të cilët janë nën mbikëqyrje nga ZVSHP/DTSHP si dhe numri total të dosjeve aktive, në mënyrë tillë për të nxjerr ne pah ñngarkesën individualeò të secilit punonjës. **(iii)** Nuk është relatuar mbi çfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP . **(iv)** Dosjet e inspektimit, nuk rezultuan të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.
Kriteri:	VKM nr.302 datë 25.03.2009 ñPër miratimin e Rregullores ñPër organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standarteve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternativeò, ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provësò si dhe aktet e tjera juridike, në mbështetje të saj.
Ndikimi/Efekti:	Në rubrikën e problematikave të evidentuara nga grupi inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë respektive, por rekomandimet e propozuara janë mjaft më të lehta, duke mos cilësuar neni 21 pika 4 i VKM-

	së nr.302 datë 25.03.2009, që shprehet se *"Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore."*, për periudhën deri më datë 10.07.2020 ku ka hyrë në fuqi ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò.Kjo situatë paraqitet pothuajse e njëjtë dhe për periudhën deri në 30.06.2021,ndërsa për aplikimin e masave displinore mbas korrik 2020 aplikohet ligji 153/2013 ñPër Nëpunësin Civilò dhe akteve ligjore dytësore të tij.
Shkaku:	Të njëjtin qëndrim dhe në vendimamarrje ka mbajtur titullari i DPSHP, duke zbehur procesin e inspektimit, duke mos marrë masa për përmirësimin e gjendjes në përputhshmëri me legjislacionin bazik dhe atë sekondar.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga titullari i DPSHP të merren masa që në fillim viti të miratohet Plani i Veprimit të Inspektimin si dhe të ngihet niveli i marrjes së masave disiplinore në rastet kur është e nevojshme, me qëllim arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë të institucionit.

Regjistri elektronik i të dhënave të zyrave vendore/territoriale,dixhitalizimi i Shërbimit të Provës.

-Në zbatim të VKM nr. 302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3, Drejtoria e Shërbimit të Provës (DPSHP), kishte detyrimin ligjor për krijimin e regjistrit elektronik ku regjistrohen të dhënat e zyrave vendore. Në lidhje me auditimin e këtij regjistri nga grupi i auditimit u kërkua vënia në dispozicion e tij në format elektronik, kërkesë e cila nuk u përmbush nga subjekti i auditivit, pasi nuk kishte një regjistër të tillë.
-DPSHP ka ngritur një sistem elektronik për dixhitalizimin e sistemit të Shërbimit të Provës i cili është implementuar në vitin 2015 me lidhjen e kontratës nr.1853, datë 28.09.2015 me objekt ñDixhitalizimin e sistemit të Shërbimit të Provësò me palë kontraktuese AKSHI-i dhe BOE ñF.ò(*ku përfitues është SHP*), me vlerë 7,899,680 lekë pa TVSH, me afat 4 vjet për mirëmbajtjen duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të shërbimeve të implementuara (afati për implementimin e shërbimeve 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës).
Me akt marrëveshjen nr.7552/6 prot., datë 06.12.2019 të palëve kontraktuese (AKSHI dhe ñF.ò) bazuar në shkresën nr.603 prot., datë 23.06.2020 të ish Drejtorit të Përgjithshëm në mungesë dhe me porosi z.B.D., drejtuar AKSHI-t dhe ministrisë së Drejtësisë, është zgjidhur kontrata nr.1853, datë 28.09.2015 pa asnjë kosto për palët duke ju referuar nenit 8 të kontratës së sipërcituar sipas të cilës ò*Në rast se, Qeveria Shqiptare vendos, të mos miratojë fondin vjetor lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes, kontrata do të ndërpritet pa kosto për palët*ò.

Titulli gjetjes:	Për periudhën **2018-2019** nuk rezulton të jenë hedhur në regjistrin elektronik të dhënat e regjistruara nga ZVSHP-të si dhe të jetë bërë dixhitalizimi i dosjeve të ZVSHP-ve, administruar nga DPSHP.
Situata:	Për periudhën **2018-2019** nuk rezulton të jenë hedhur të dhënat e regjistruara nga ZVSHP-të dhe administruar nga DPSHP, jo në përputhje me termat e referencës, Aneksi 1, versioni 1.1., pika 2.1 pjesë përbërëse e kontratës nr.1853, datë 28.09.2015 dhe VKM nr. 302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3. Sipas këtyre termave objekti i kontratës është krijimi i sistemit të menaxhimit të dosjeve të SHP ku përfshihet ñ*rritja e efikasitetit të shërbimit të zyrave vendore dhe DSHP, korrektësi në plotësimin e dosjeve, transparencë ndaj personave që hyjnë në programin e Shërbimit të Provës dhe monitorimin në kohë reale nga ana e Shërbimit të Provës/ministrisë së Drejtësisë të proceseve të dosjeve*ò si dhe bazuar në pikën 2.3 të termave të referencës rezultatet e kërkuara nga kontraktori

	(BOE) ka qënë ñ*dixhitalizimi i plotë i dokumentacionit, ruajtja e sigurtë, ngritja e sistemit për shërbimin me anë të një portali për përdoruesit e SHP si dhe raportimi në kohë reale mbi statusin e të dënuarve dhe statistika sipas periudhave*ò. (**Shënim**:ò*Statistikat" nënkuptojnë të dhënat për regjistrin elektronik parashikuar VKM nr. 302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3 pasi ky sistem përfshin dhe regjistrat e SHP sipas pikës 4.2 të termave të referencës*). Për pasojë, për periudhën nga 2018-2019, periudhë e cila përfshihet në afatin 4 vjeçar të kontratës nr.1853, datë 28.09.2015, nuk rezulton të jenë hedhur të dhënat e regjistruara nga ZVSHP-të dhe administruar nga DPSHP, jo në përputhje me VKM nr.302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3, e cila ka sjellë si pasojë përdorimin pa eficencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 7,899,680 lekë pa TVSH, vlerë e cila është shpenzuar për ngritjen e sistemit/dixhitalizimit të Shërbimit të Provës dhe mirëmbajtjen e tij, por që nuk është përdorur dhe nuk ka gjurmë dokumentare të qarta për të vërtetuar cilët kanë qenë shkaqet, nga mos përdorimi i sistemit si pasojë e mos kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes apo mos hedhja në kohë e të dhënave si pasojë e mos përdorimit të sistemit nga vetë Shërbimi i Provës, i cili është përgjegjësi e ish titullarëve respektivë të DPSHP z.E. H. dhe z.B.D..
Kriteri:	VKM nr. 302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3. Kontrata nr.1853, datë 28.09.2015 lidhur mes AKSHI-t dhe BOE ñF. & I.ò, termat e referencës, Aneksi 1, versioni 1.1., pika 2.1 pjesë përbërëse e kontratës.
Ndikimi:	Përdorimi pa eficencë dhe efektivitet i fondeve publike në vlerën 7,899,680 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Mos hedhja e të dhënave/dixhitalizimi i dosjeve në kohë reale.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Projektraport auditimi në lidhje me dixhitalizimin e Shërbimit të Provës/hedhjes së të dhënave, me qëllim që në të ardhmen të vihet në eficencë ky sistem përmes përmbushjes të termave të referencës të kontratës nr. 1201 prot., datë 25.02.2021 me vlerë prej 2,292,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e DPSHP **për vitet 2020 dhe 2021, mbi detyrimin up-date të sistemit të dosjeve aktive mbi ecurinë e personit nën mbikëqyrje deri** në momentin e mbarimit të periudhës së provës, në formatin elektronik, u konstatua se:

Për mirëmbajtjen e sistemit, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është realizuar procedura e prokurimit në rolin e AK me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP), është në cilësinë e institucionit përfitues, me afat 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës nr.1201 prot datë 25.02.2021.

Të gjitha veprimet duhet të kryhen nga specialistët e Shërbimit të Provës për përmbushjen e qëllimit të rehabilitimit të personave në mbikqyrje, në bazë të dokumentacionit të up-date, ku krahas dosjeve fizike duhet e dokumentuar paralelisht dhe në sistemin elektronik për çdo dosje individuale aktive, që nga momenti i hapjes dhe deri në momentin e arkivimit.

Këto veprime administrative janë në mbështetje të Ligjit nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 24 pika 3 dhe pika 5, ku citohet se ñ*Çdo degë territoriale e Shërbimit të Provës, në përmushje të detyrave funksionale, mban në formë shkresore rregjistrat,*

a)rregjistrin e personave nën mbiqyrje;

b)rregjistrin e kërkesë –ankesave;

c)rregjistrin e shkeljeve dhe mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendim gjyqësor;

ç)rregjistrin e organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose subjekteve private, që ofrojnë këshillimin dhe asistencë të çdo forme për të dënuar me alternativa të dënimit me burgim.
d)regjistrin për raportet e vlerësimit të kërkuara nga gjykata ose prokuroria.
5.Formati, përmbajtja dhe mënyrat e krijimit dhe të administrimit të regjistrave, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
-Nga auditimi rezultoi se:
Titullari i AK (AKSHI) ka miratuar Urdhërin nr.75 datë 01.03.2021 ñPër caktimin e ndjekësve të kontratës nr.prot 1201 datë 25.02.2021 ñMirëmbajtja e Sistemit të Shërbimit të Provës-për DPSHPò, me përbërje (I.P. dhe L.M.), të cilat janë punjonjëse të AKSHI-t dhe punojnë për Ministrinë e Drejtësisë, ku në bazë të Procesverbalit *datë 08.04.2021*, kanë konstatuar funksionalitetin e plotë të sistemit si dhe bazuar në kërkesat e kontratës së cituar më lart, kanë vlerësuar se zëri i shërbimeve të realizuara nga operatori gjatë periudhës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit, është konform specifikimeve teknike të parashikuara në kontratë.
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se:
Sipas e-mail të datës 14.09.2021 nga L.M. shprehet se ñ*Pas trajnimeve ka filluar përditësimi i sistemit dhe hedhja e dosjeve aktive në sistem nga ana e specialistëve dhe deri më datë 14.09.2021 rezultojnë të hedhura në sistem **2633** dosje nga të cilat **1833** janë dosje të reja dhe **1175** Plane Individuale Trajnimi për të mbikqyrit. Specialistët e Shërbimit të Provës japin feedback-un e tyre lidhur me sistemin dhe raportojnë problematikat të cilat menaxhohen nga administratori i sistemit ose i përcillen operatorit ekonomik fitues.*ò
\ngs auditimi rezultoi se, bashkëlidhur nuk është paraqitur dokumentacion justifikues dhe argumentues, në rakordim të numrit të dosjeve të hedhura në sistem.
Në përfundim, fillimisht sipas procesverbalit datë 08.04.2021, shprehen se, jemi në kushtet e funksionalitetit të plotë të sistemit si dhe bazuar në kërkesat e kontratës së cituar, por nga DPSHP përgjatë muajit prill-maj, janë kërkuar ndryshime/shtesa të rubrikave të cilat nuk ishin të caktuar në kërkesat e kontratës së cituar, në momentin e realizimit të tenderit nga AKSHI.
Nisur nga këto ndryshime, grupi i auditimit, në mënyrë sistematike pranë drejtuesit aktual të DPSHP z.K. dhe anëtarëve të grupit të AKSHI, në takimet formale dhe nëpërmjet e-mail, kemi kërkuar mundësinë e vënies në dsipozicion të bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me AKSHI në përgatitjen e termave të referencës dhe kërkesave të kontratës, si institucion përfitues, por nuk është mundësuar, respektivisht L.M.@akshi.gov.al dërguar më datë 01.12.2021 dhe A.K.@sherbimiproves.gov.al datë 25.11.2021.
-Nga auditimi, i Kontratës nr.1201 prot datë 25.02.2021, nga pikpamja formale u konstatua:
Baza ligjore e saj, është ligji nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikò i ndryshuar nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, VKM nr.673 datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò i ndryshuar.
Nga institucioni i DPSHP (z.A.K.) me shkresë nr.612 prot datë 10.06.2021, i është drejtuar AKSHI-it, ku shprehet se ñ *Në zbatim të nenit 9, të VKM nr.945 datë 02.11.2012 "Për miratimin e rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore", i ndryshuar, bashkëlidhur kësaj shkresë po ju përcjellim, formatin e kërkesës për rregjistrimin e Sistemit të Shërbimit të Provës si databaze shtetërore, formatin e dokumentacionit teknik së bashku me aneksin, si dhe versionin eletrinikisht në CD të nënshkruar elektronikisht.*
Për sa i takon, Sistemit të Shërbimit të Provës për të cilin nuk ka ende një akt krijimi, në funksion e zbatim të detyrimeve ligjore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka ngritur grupin e punës me Urdhër të DP nr.62 datë 04.06.2021 "Për hartimin e draftit të

*projektvendimit për Sistemin e Shërbimit të Provës", me qëllim përcjelljen e këtij akti pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe institucionit tuaj.*ò
Bashkëlidhur, u konstatua, që grupi i punës ngritur në bazë të Urdhër të DP nr.62 datë 04.06.2021 ñPër hartimin e draftit të projektvendimit për Sistemin e Shërbimit të Provësò, ka paraqitur në datë 30.06.2021, draft projekt-vendimin ñPër miratimin e rregullores administrimi i sistemit të dhënave shtetëroreò i ndryshuar si dhe nga titullari i DPSHP z.A.K. (me urdhër dhe në mungesë) është dërguar në Ministrinë e Drejtësisë me shkresë nr.673/1 prot datë 30.06.2021, për të cilën nuk është marrë miratim ose ndonjë interpretim juridik.
Nisur nga ky interpretim i DPSHP-së, nga ana e AKSHI-t, realizimi i procedurës së prokurimit është bërë jo në përputhshmëri me Ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò , ndonëse produkti/shërbimi i këtij prokurimi është në zbatim e sipër pranë institucionit të Shërbimit të Provës, për të cilin janë realizuar tre pagesa në bazë të Urdhër-Shpenzimi nr.360 datë 11.05.2021 për periudhën 25.02.2021-24.03.2021, Urdhër-Shpenzimi nr.435 datë 28.05.2021 për periudhën 25.03.2021-24.04.2021 dhe Urdhër-Shpenzimi nr.657 datë 04.08.2021 për periudhën 25.04.2021-25.05.2021, çdo urdhër shpenzim është në vlerën 114,600 lekë me TVSH dmth deri më datë 02.08.2021 janë paguar nga DPSHP për këtë shërbim 343,800 lekë me TVSH.
Grupi i auditimit konstaton se, sipas Ligjit nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 24 pika 3 pika 5 shprehet se ñ*Formati, përmbajtja dhe mënyrat e krijimit dhe të administrimit të regjistrave, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës",* në mbështetje të kësaj pike është miratuar VKM nr.421 datë 08.07.2021 *"Për miratimin e rregullores së përgjithshme të shërbimit të provës"* neni 10 (Rregjistrat e shërbimit të provës) pika 2 shprehet se *"Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës krijon rregjistrin eletronik, në të cilin rregjistron të dhënat e degëve territoriale. Të dhënat e këtij regjistri përditësohen çdo javë."* kështu në mbështetje të tyre, DPSHP duhet të ketë sistem elektronik mbi ecurinë e mbikqyrjes dhe për rrjedhojë dhe ecurinë e dosjeve aktive në formatin eletronik deri në mbarim të periudhës së provës.

-Në funksion të eficencës së këtij sistemi elektronik, nga auditimi i ushtruar pranë Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-Tiranë, u konstatua se:
Në bazë të punës së disa specialistëve, në lidhje mbi hedhjen e dosjeve aktive në sistemin elektronik për të parë ecurinë e zbatimit të Kontratës nr.prot 1201 datë 25.02.2021 me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò dhe përputhshmërinë ligjore të tyre, u konstatua se për vitin 2020 DTSHP-Tiranë ka 1730 dosje aktive dhe për 6 mujorin e parë të vitit 2021 rezultoi 1028 dosje aktive(burimi i informacionit specialisti i statistikës në DPSHP) nga të cilat deri në momentin e hartimit të këtij materiali janë hedhur 681 dosje aktive, ku për një pjesë të tyre, u konstatua se, specialistja D.M. ka hedhur 100 dosje; I.Y 20 dosje dhe L.J. 50 dosje.
Në bazë të metodës krahasimore të dosjeve fizike respektive me dosjet e e hedhura në sistem, u konstatua se, dosjet nuk janë hedhur të plota, janë hedhur të dhëna personale, vendimi i gjyqësorit, hartimi dhe miratimi i Planit Individual të Trajnim, ndërsa takimet periodike, pasqyrimi periodik mbi trajtimet e personave nën mbikqyrje, nuk janë reflektuar në sistemin elektronik të Shërbimit të Provës.
Mos hedhja në sistemin eletronik, të elementëve të plotë të dosjeve aktive, përbën shkak për rritjen e pritshmërisë së riskut të implemetimit të shërbimit përfitues për institucionin e DPSHP, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 24 pika 3 pika 5 dhe VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të shërbimit të provësò neni 10 (Rregjistrat e shërbimit të provës)

pika 2, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtuesin aktual Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-Tiranë z.B. D..
Gjithashtu, grupit të auditimit, përveç informacionit me e mail të datës 14.09.2021 nga L.M. në cilësinë e përfaqësueses së AKSHI-it drejtuar Drejtorit tëPërgjithshëm në mungesë dhe me urdhër z.K.,ku shprehen se ñ*ka filluar përditësimi i sistemit dhe hedhja e dosjeve aktive në sistem nga ana e specialistëve dhe deri më datë 14.09.2021 rezultojnë të hedhura në sistem **2633** dosje nga të cilat **1833** janë dosje të reja dhe **1175** Plane Individuale Trajnimi për të mbikqyerit",* **nuk kemi pasur** asnjë informacion si dhe asnjë dokumentacion argumentues zyrtar për hedhjen e dosjeve aktive në sistemin elektronik, sipas DTSHP-Vendore në territorin e vendit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 24 pika 3 pika 5 dhe VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të shërbimit të provësò neni 10 (Rregjistrat e shërbimit të provës) pika 2, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtuesin aktual Drejtorin e Përgjithshëm në mungesë dhe me urdhër z.A.K..

Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, është ***observuar mbi Projektraportin me shkresë nr.120/2 prot të DPSHP datë 28.02.2022, prot nr.935/10 datë 01.03.2022 të KLSH***, nga z. B.D. në cilësinë ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) me shkresë nr.1452 prot datë 25.02.2022, i cili nuk ka sjellë dokumenta apo prova të reja në lidhje me problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.1, kështu qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me projektraportin.

Pretendimi i subjektit:
1*.(Observimi nga z.A.K.)***Grupi përgjegjës për zbatimin e kësaj kontrate, është përcaktuar me urdhrin Nr. 75, datë 01.03.2021 të Autoritetit Kontraktor (A.K.SH.I) duke përcaktuar punonjësit znj. I.P., dhe znj. ***L.M.,*** kjo e fundit ushtron detyrën e specialistit IT në aparatin e Ministrisë së Drejtësisë dhe në Shërbimin e Provës, pra rezulton se ka një grup përgjegjes të ngritur për zbatimin e kësaj kontrate. Nga grupi i ndjekjes së kontratës sic është përmendur dhe nga grupi i auditimit në aktin e konstatimit, sipas procesverbaleve të mbajtura nga ky grup cdo muaj (procesverbal për mirëmbajtjen e sistemit të Shërbimit të Provës), rezulton se <u>është konstatuar funksionalitet i plotë i sistemit bazuar në kërkesat e kontratës përkatëse,</u> si dhe bazuar në e-mailin e datës 14.09.2021 dërguar nga znj. L.M., rezulton se <u>dosjet përditësohen nga stafi i SH.P në mënyrë të vazhdueshme dhe cdo të premte bëhet një raportim tek specialistja znj. T. Sh. lidhur me dosjet e hedhura në sistem gjatë javës</u> (bashkëlidhur do të gjeni e-mailin e cituar).
2*.(Observimi nga z.B.D.)* Për sa i përket pretendimit lidhur me moshedhjen në sistemin elektronik të dosjeve aktive të D.T.SH.P Tiranë, pas lidhjes së kontratës Nr. 1201 Prot, datë 25.02.2021, me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò ju parashtroj si vijon;
Së pari: Pas lidhjes së kontratës Nr. 1201 Prot, datë 25.02.2021, me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò, u trajnuan specialistët Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë dhe ka vijuar hedha në sistemin elektronik të dosjeve aktive.
Së dyti: Ju informoj se mungon një rregullore për përcaktimin e detyrave mënyrën dhe afatet e hedhjes në sistemin elektronik të dosjeve aktive. Në këto kushte, hedhja në sistemin elektronik të dosjeve aktive është kryer në varësi të ngarkesës në punë të specialistëve dhe kohës fizike në dispozicion për këtë qëllim. Gjithashtu për sasinë e hedhur në sistemin elektronik të dosjeve aktive është raportuar çdo javë në DPSHP.
<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>
1. Detyrimin kontraktor të mirëmbajtjes së sistemit e ka AKSHI, kjo si detyrim kontraktor i Kontratës nr.prot 1201 datë 25.02.2021 me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò lidhur midis AKSHI dhe OE fitues, ndërsa DPSHP ka detyrimin up-date të dosjeve aktive në formatin eletronik mbi ecurinë e mbikqyrjes deri në mbarim të periudhës së provës, të cilat duhet të jenë në në përputhshmëri me të dhënat e dosjes fizike për çdo person, duke ecur paralel me njëra tjetrën, në mënyrë të tillë që të funksionojnë sistemet e kontrollit të brëndshëm, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit të sistemit informatik të Shërbimit të Provës.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë. **2**. Mos hedhja në sistemin eletronik, të elementëve të plotë të dosjeve aktive për personat nën mbikqyrje, përbën element me pasojë negative, për të mos garantuar kontrate të sukseshme deri në ekzekutimin e plotë të saj nga strukturat e DPSHP, e për pasojë mund të rrisë riskun e përdorimit dhe shpenzimit pa efiktevitet, pa eficiencë dhe pa ekonomicitet të vlerës së kontratës nr.prot 1201 datë 25.02.2021, e financuar nga Buxheti i Shtetit. **Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

Titulli i Gjetjes:	Mbi monitorimin dhe ecurinë e Kontratës nr. 1201prot., datë 25.02.2021, e me afat 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
Situata:	Nga auditimi mbi veprimtarinë e DPSHP për vitet 2020 dhe 2021, mbi detyrimin up-date të sistemit të dosjeve aktive mbi ecurinë e personit nën mbikëqyrje deri në momentin e mbarimit të periudhës së provës, në formatin elektronik, u konstatua se: -Për mirëmbajtjen e sistemit, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është realizuar procedura e prokurimit në rolin e AK me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP), është në cilësinë e institucionit përfitues, me afat 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës nr.1201 prot datë 25.02.2021. -Kështu, për të parë funksionin e veprimtarisë së detyrave funksionale të DPSHP si dhe ecurinë e sistemit të mësipërm, u fokusuam pranë DTSHP-Tiranë, pasi ka në mbikqyrje numrin më të lartë të dosjeve fizike, kështu për vitin 2020 rezultoi me 1720 dosje aktive dhe për 6 mujorin e parë të vitit 2021 rezultoi 1028 dosje aktive, nga të cilat u konstatuan se janë hedhur 681 dosje aktive në formatin elektronik. -Në bazë të metodës krahasimore të dosjeve fizike respektive me dosjet e hedhura në sistem, u konstatua se, dosjet aktive në formatin elektronik nuk janë hedhur të plota, duke hedhur vetëm, të dhëna personale, vendimin e gjyqësorit, hartimin dhe miratimin e Planit Individual të Trajnim, ndërsa takimet periodike, pasqyrimi periodik mbi trajtimet e personave nën mbikëqyrje, nuk janë reflektuar në sistemin e dosjeve aktive në formatin elektronik të Shërbimit të Provës. -Mos hedhja në sistemin elektronik, të elementëve të plotë të dosjeve aktive, përbën shkak për rritjen e pritshmërisë së riskut të implemetimit të shërbimit përfitues për institucionin e DPSHP, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 24 pika 3 pika 5 dhe VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të shërbimit të provësò neni 10 (Regjistrat e shërbimit të provës) pika 2, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtuesin aktual Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-Tiranë z.B. D. si dhe titullarin e DPSHP (në mungesë dhe me urdhër z.A.K.) ka kontrolle të dobëta, si pasojë e mos ngritjes së strukturave të dedikuara për ecurinë e up-date të dosjeve aktive në sistemin elektronik.
Kriteri:	Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të shërbimit të provësò, Kontrata nr.prot 1201 datë 25.02.2021 objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò.
Ndikimi/Efekti:	Mos hedhja në sistemin eletronik, të elementëve të plotë të dosjeve aktive, përbën shkak për rritjen e pritshmërisë së riskut të implemetimit të shërbimit përfitues për institucionin e DPSHP si dhe mund të mos garantojë kontrate të sukseshme deri në ekzekutimin e plotë të saj nga strukturat e DPSHP, e për pasojë mund të rrisë riskun e përdorimit dhe shpenzimit pa efiktevitet, pa eficiencë dhe pa ekonomicitet të vlerës së kontratës nr.prot 1201 datë 25.02.2021, e financuar nga Buxheti i Shtetit.

Shkaku:	Nga titullari i DPSHP (në mungesë dhe me urdhër z.A.K.) ka kontrolle të dobëta, si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e Kontratës nr.prot 1201 datë 25.02.202 objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga DPSHP, të merren masa, për të analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e veprimtarisë së DPSHP detyrimeve mbi detyrimin up-date të sistemit të dosjeve aktive mbi ecurinë e personit nën mbikëqyrje deri në momentin e mbarimit të periudhës së provës, në formatin elektronik, me qëllim arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë të institucionit.

-Mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës/Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike.

Struktura e DSHP është miratuar me Urdhrin nr.55, datë 20.4.2017 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provësò, ndryshuar me Urdhrin Nr. 63, datë 7.5.2020 e cila përbëhet nga 3 drejtori: Drejtoria e Inspektimit&Shërbimeve Komunitare, Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike dhe Drejtoria e Financës & Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtoria e Mbikqyrjes Elektronike (DME)

DME-është drejtori përbërëse e Shërbimit të Provës e cila realizon mbikqyrjen elektronike në përputhje me Ligjin nr.10494, datë 22.12.2011 ñPër mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësorò neni 3, pika ñaò. ñ*Mbikqyrja elektronike (ME) është mekanizmi që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij*ò si dhe përcaktimit të bërë në Ligjin nr. 78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provesò neni 3, pika 7. ME, funksionon nëpërmjet një ñbyzylyku elektronik/njësia personaleò dhe një njësie qëndrore/njësia e shtëpisë.

Në kuptim të detyrimeve ligjore të cituara, kufizimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, mbikqyren nëpërmjet pajisjes së gjurmimit/byzylykut elektronik që vendoset në trupin e personit nëpërmjet sallës operative të ngritur për këtë qëllim. Pajisja i komunikon sallës operative daljen nga zona e lejuar apo hyrjen në zonën e ndaluar.

Në zbatim të Ligjit nr.10 494, datë 22.12.2011 neni 4 dhe Udhëzimit të përbashkët nr.827/7, datë 28.02.2013 ñPër bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësorò, pika 2, përdorimi i mbikëqyrjes elektronike urdhërohet nga gjykata me vendim gjyqësor, pas informimit nga Shërbimi i Provës për mundësinë teknike të realizimit të saj. Në funksion të kësaj nga ministria e Drejtësisë është lidhur kontrata nr.8383/10 prot., datë 21.02.2017 me object ñPërmirësimi i sistemit të mbikqyrjes elektronike në fushën penaleò me bashkimin e operatorëve ekonomikë ñS.ò e cila mundëson blerjen dhe mbikqyrjen elektronike të ñpajisjes së gjurmimit/byzylykut elektronikò. Procedura e tenderimit me objekt ñPërmirësimi i sistemit të mbikqyrjes elektronike në fushën penaleò me fond limit 196,046,666 lekë (pa TVSH), është kryer nga ministria e Drejtësisë dhe është audituar nga KLSH në bazë të Programit të Auditimit nr.940/1 datë 07.09.2017 miratuar me Vendimin nr.196, datë 27.12.2017 e Kryetarit të KLSH-së.

Titulli Gjetjes:	Mos funksionimi i Drejtorisë së Mbikqyrjes elektronike.
Situata:	Për periudhën 2018-2019, DME nuk ka qënë në eficencë të plotë për të

	përmbushur shërbimin e ME sipas detyrimeve ligjore, pasi funksionimi i ñpajisjes së gjurmimitò ka paraqitur një sërë problematikash të cilat nuk kanë mundësuar teknikisht funksionimin e saj.Për këtë qëllim, nga gushti i vitit 2017 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP) nuk ka zbatuar asnjë urdhër ekzekutimi për mbikqyrje elektronike, pasi pasjisja e gjurmimit kishte probleme teknike të cilat nuk garantonin sigurinë publike për implementimin e masave të sigurisë ñarrest në shtëpiò me mbikqyrje elektronike. Nisur nga kjo, DPSHP me shkresën nr.1740 prot., datë 11.08.2017 të ish Drejtorit të Përgjithshëm z. Ilir Qafa, ka njoftuar drejtuesit e Prokurorisë së çdo rrethi gjyqësor në lidhje me vlerësimin e masave që duhen marrë për subjektet në mbikqyrje elektronike, si pasojë e anomalive gjatë funksionimit të sistemit dhe zëvëndësimin e saj nga gjykata, si dhe me shkresën e ish ministrit të Drejtësisë z. G.B. nr. 4716/15, datë 10.08.2017 drejtuar ish Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ka kërkuar në kushtet për sa kohë që rezulton të mos jetë bërë kolaudimi i pajisjeve që realizojnë mbikqyrjen elektronike, marrjen e masave nga ana e Policisë së Shtetit, me qëllim vëzhgimin e 86 personave aktualisht nën mbikqyrje elektronike. Pas dy vitesh testim dhe monitorim të sistemit të mbikqyrjes elektronike ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 6473 prot, datë 19.09.2019 drejtuar palës konstraktuese (BOE-ve), si dhe shkresën nr.6473/1, prot., datë 20.09.2019 drejtuar Shërbimit të Provës, ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën nr.8383/10 prot., datë 21.02.2017, për shkak se ka dështuar funksionimi efektiv i pajisjes. Mosfunksionimi i ñpajisjes së gjurmimitò, është bërë i ditur nga ana SHP/DME që në fillim të implementimit të saj përmes korrespondencës të mbajtur/e-maileve me Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat dhe prokuroritë si dhe në analizat vjetore 2018-2019 vënë në dispozicion të grupit të auditimit, ku evidentohen problematikat e dala nga procesi i monitorimit. Në analizën vjetore të institucionit raportuar pranë ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 68, datë 19.01.2021, konstatohet se për vitin 2020 nuk analizohet veprimtaria e DME. Për pasojë, nga data 20.09.2019, datë në të cilën është zgjidhur zyrtarisht kontrata e sipërcituar e në vijim (*deri 30.06.2021 periudhë nën auditim*), DME, nuk ka qënë eficente dhe nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për të cilat është krijuar, pasi nuk ka realizuar procesin e mbikqyrjes elektronike, duke sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në lidhje me shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve të drejtorisë së ME në vlerën 14,291,182 lekë llogaritur për periudhën tetor 2019 deri në Qershor 2021 lekë.
Kriteri:	Ligji nr.10494, datë 22.12.2011 ñPër mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësorò neni 3, pika ñaò.
Ndikimi/Efekti:	Mosfunksionimi i DME ka sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore për shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve të drejtorisë së ME në vlerën 14,291,182 lekë llogaritur për periudhën tetor 2019(kur është zgjidhur kontrata për ñòpajisjen e gjurmimitò deri në Qershor 2021 lekë.
Shkaku:	Mosfunksionimi i ñpajisjes së gjurmimitò. për të cilat është krijuar, pasi nuk ka realizuar procesin e mbikqyrjes elektronike,
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, të marrë masa të menjëhershme që të kërkojë nga organi qëndror/ministria e Drejtësisë vënien në eficencë të DME dhe stafit të saj, me qëllim funksionimin e kësaj drejtorie.

Gjatë vitit 2020, DPSHP, struktura e varësisë Drejtoria e Mbikëqyrjes Elektronike, nëpërnjet Ministrisë së Drejtësisë është angazhuar për pjesëmarrjen në grup pune, konkretisht, DPSHP i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë me shkresë nr.730 prot., datë 16.07.2020, me objekt, caktimin e përfaqësuesve të SHP pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

për përcaktimin e termave të referencës për projektin e ri të ofrimit të mbikqyrjes elektronike, duke përcaktuar grupin e punës me përbërje;
z.B.D., me detyrë Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës.
z.E. SH., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike.
z.E.G., me detyrë Inspektor pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare.
Grupi i sipërm ka realizuar disa takime me përfaqësuesit e AKSHI-it, si dhe ka shkëmbyer emaileve, për caktimin e termave të referencës që janë dorëzuar në formë elektronike, por nga AKSHI nuk është ndërmarrë asnjë veprim administrativ për fillimin e realizimit të procedurës së prokurimit, për të siguruar pajisjet të cilat do të mundësojnë rifillimin e aktivitetit të Drejtorisësë Mbikëqyrjes Elektronike, e cila si gjatë viti 2020 dhe 6 mujorit të paraë të vitit 2021, nuk realizon detyrën funksionale të mbikëqyerjes eletronike, për të cilën është krijuar.
Gjithashtu, nga ana e z.E. SH., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike, duke u nisur nga fakti i keqfunksionimit të projektit të mëparshëm të mbikëqyrjes eletronike, i cili shkaktoi probleme serioze në procesin ligjor penal, për subjektet të cilat do të kishin përfituar nga ky sistem masa të buta survejimi dhe kontrolli, ku nuk u arrit qëllimi final për të cilin u projektua, si dhe të gjendur edhe në kushtet e Pandemisë botërore të Covid-19, ku rreziku i përhapjes së Coronaviruesit, në popullatën e sistemit peniterciar mbetet i lartë, lindi si domosdoshmëri rikthimi i këtij sistemi në funksionalitet të plotë. Për këtë qëllim ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme pranë selive dimplomatike të Shqipërisë në vendet e zhvilluara, me arsyetimin që duke marrë në konsideratë faktin e mungesës, në tregun e brendshëm të kompanive të cilat prodhojnë dhe ofrojnë pajisje dhe shërbim të monitorimit eletronik konkretisht:
-Ambasadës në Berlin me adresë e-mail embassy.berlin@mfa.gov.al, datë 03.11.2020;
- Ambasadës në Izrael me adresë e-mail embassy.telaviv@mfa.gov.al, datë 26.10.2020;
Nga auditimi u konstatua se, për këto veprime janë informuar Ministria e Drejtësisë dhe AKSHI.
Nuk është marrë ndonjë informacion apo detaj më i qartë në lidhje me kerkesën e bërë nga z.SH..
Sa më sipër arrihet në konkluzion:
-Për periudhën 19. 09.2019 deri në 6 mujorin I-2021, Drejtoria e Mbikqyrja Elektronike nuk ka funksionuar për përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr.10 494, datë 22.12.2011, Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provesò dhe Udhëzimi i përbashkët nr.827/7, datë 28.02.2013 ñPër bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësorò. Mos funksionimi i kësaj drejtorie ka qënë për shkak të dështimit të funksionimit efektiv të ñpajisjes së gjurmimitò e cila është konfrirmuar me shkresën nr.6473/1, prot., datë 20.09.2019 të ministrisë së Drejtësisë drejtuar Shërbimit të Provës, ku ka njoftuar zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratës nr.8383/10 prot., datë 21.02.2017, për shkak se ka dështuar funksionimi efektiv i pajisjes. Mos funksionimi i pajisjes, logjistikë kjo e domosdoshme për misionin e kësaj drejtorie, ka sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në lidhje me shpenzimet e bëra për pagat e punonjësit të drejtorisë në vlerën **14,291,182 lekë** (llogaritur për periudhën tetor 2019 deri në Qershor 2021). Efektiviteti i Drejtorisë së Mbikqyrjes Elektronike përmes rivënies në eficencë të logjistikës/pajisjes së gjurmimit është në kompetencën e ministrisë së Drejtësisë si institucion qëndror në varësi të të cilit është Shërbimi i Provës.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë dhe arkë, konkretisht testimeve të kryera mbi urdhër shpenzimet për muajt Janar, Shkurt, Nëntor, Dhjetor të vitit 2018, Janar, Shkurt, Tetor, Dhjetor të vitit 2019, Janar, Shkurt, Gusht, Dhjetor të vitit 2020 dhe Janar, Mars, Prill të vitit 2021, u konstatua në 6 praktika, likuidim faturash mbi afatin e parashikuar 30 ditor, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, neni 52, si dhe Ligjin nr.48/2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareò neni 7 pika a, duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 10-38 të Raportit të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues i DPSHP të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-ik, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të DPSHP, u konstatua se institucioni nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve. Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh sjell problematika në kryerjen e një procesi të saktë inventarizimi dhe vlerësimi aktivesh, për shkak të mungesës së informacionit mbi amortizimin e akumuluar, vlerën e tyre dhe kostot nëse mbahen apo nxirren jashtë përdorimi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, Kreu Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik, pika 26, 28 dhe 30.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 10-38 të Raportit të Auditimit)
2.1.Rekomandimi: DPSHP të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inventarit të DPSHP-së u konstatua se:
-Në zbatim të Urdhrit përkatës të titullarit të DPSHP-së për vitin 2018/2019 janë ngritur komisionet e inventarizimit.
Për vitin 2019, është ngritur komisioni i inventarizimit, por procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara, pasi nuk ka patur një datë të përfundimit të procesit apo formulimin e një relacioni. Për vitin 2020, DPSHP nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në bazë të të cilit të evidentohej gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Neni 15 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshmeò pika 30.
-Titullari i institucionit të DPSHP-së nuk ka ngritur asnjë komision për vlerësimin e aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit, në raportin përfundimtar, janë evidentuar aktive të dëmtuara. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit dhe rrjedhimisht të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër.Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 74, 95.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 10-38 të Raportit të Auditimit)
3.1.Rekomandimi: DPSHP të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit, të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

Në vijimësi

3.2.Rekomandimi: Titullari i institucionit të DPSHP-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komisioni i inventarizimit, të nxjerrë urdhrat për ngritjen e komision për vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se Komisioni i Inventarizimit për vitin 2018, i ngritur me urdhrin nr. 4060, datë 31.12.2018 ñPër ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit të Shërbimit të Provës për vitin 2018ò, ka patur anëtar Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe specialistin e sektorit të financës. Në praktikën e inventarizimit nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit, në kushtet ku është verifikuar ekzistenca dhe plotësia e aktiveve nga punonjësit që i kanë në ngarkim apo i kontabilizojnë ato. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit, Pika 3/b dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, kreu Përgjegjësitë për inventarizimin, pika 82.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 72-85 të Raportit të Auditimit)
4.1. Rekomandimi: DPSHP të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të DPSHP-së rezultoi se:
-Nga verifikimi i llogarive të shpenzimeve dhe rakordimi i tyre me situacionet e thesarit, është konstatuar se vlera totale e llogarisë 601 òKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò në Pasqyrën e Performancës Financiare, e cila përfshin sigurimet e konstatuara gjatë vitit ushtrimor 2020, nga muaji Janar-Dhjetor 2020 është barabartë me vlerën totale të llogarisë 601 në Aktrakordimin dorëzuar pranë Degës së Thesarit, e cila duhet të përfshijë sigurimet përgjatë muajve Dhjetor 2019-Nëntor 2020, të likuiduara në bankë gjatë vitit 2020. Veprimi i mësipërm është kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò në pikën 59/a.
-Nga verifikimi analitik i llogarive të arkëtueshme, konstatohet se në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta) është dublikuar shuma prej 10,751,043 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Kjo shumë është debituar dy herë, njëherë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, njëherë në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò,si dhe kredituar dy herë, njëherë llogarinë 4341ò Operacione me shtetin (detyrime)ò për 10,751,043 lekë, si dhe llogarinë 101 ñTeprica/Deficiti i akumuluarò. Shuma prej 10,751,043 lekë e debituar në llogarinë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò dhe kredituar në llogarinë 101 ñTeprica/Deficiti i akumuluarò është veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë dhe duke mos dhënë paraqitje të saktë të detyrimeve të prapambetura.

-Nga verifikimi analitik i llogarive të aktiveve afatgjata, konstatohet se zëri *230 "Për Aktive Afatgjata jo materiale"* është kontabilizuar në vlerën 0 (zero) lekë. Më 05.04.2017 është lidhur kontratë shërbimi projektimi me objekt ñ*Hartim i projektit për ndërtimin e shtesës anësore dhe shtesë kati për Shërbimin e Provës*ò ndërmjet DPSHP-së dhe Z.-06 shpk. Me datë 06.05.2017, operatori ekonomik ka dërguar faturën tatimore të shitjes nr. 28, me vlerë 828,000 lekë. Gjatë vitit 2017 dhe 2018, fatura e operatorit Z.-06 shpk, ka qenë detyrim i prapambetur, pasi shlyerja e është bërë me Urdhër shpenzimin nr. 827 datë 05.11.2019.
Vlera prej 828,000 lekë ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale, të cilat në momentin e konstatimit si investim nga DPSHP duhet të ishin klasifikuar dhe regjistruar në zërin 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò duke kryer veprimin kontabël: debitimin e llogarisë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò dhe kreditimin e llogarisë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò. Në momentin e pagimit të shpenzimeve duhet të ishte bërë veprimi kontabël duke debituar llogarinë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshme dhe kredituar llogarinë 520 òDisponibilitete në thesarò. Keqklasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò si dhe nënvlerësimin e llogarisë 520 òDisponibilitete në thesarò në shumën 828,000 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò.
- Gjatë auditimit të pasqyrave financiare konstatohet se për llogarinë 212 òNdërtesa dhe Konstruksioneò dhe 215 ñMjete Transportiò, vlera e amortizimit të akumuluar nuk është përllogaritur saktë ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2020.
Amortizimi i aktiveve është përllogaritur për aktivet në total dhe jo për secilin aktiv më vete, duke sjellë vështirësi në përcaktimin e vlerave reale të aktiveve (për artikull) që institucioni disponon, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò pika 36
Në pasqyrën e flukseve monetare ka një raportim të pasaktë për sa i përket rubrikës II në vlerën prej 167,382 lekë, e cila përfaqëson transferta në buxhetin e shtetit për fonde të papërdorura për investimin është keqklasifikuar në zërin dividentë të paguar. Gjithashtu rubrika III, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk përputhet me aktrakordimin e thesarit.
- Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshmeò, Seksioni 3.5 dhe 3.6.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 10-38 të Raportit të Auditimit)*
5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës së DPSHP-së të marrë masa në vijimësi për paraqitjen e saktë të llogarisë 601 ñKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò në aktrakordimin me thesarin.

Menjëherë e në vijimësi

5.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së DPSHP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 10,751,043 lekë, e cila është njohur dy herë në pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

5.3.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të DPSHP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 828,000 lekë, në llogarinë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò dhe të mbahet në këtë llogari deri në momentin e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim të ñ*Ndërtimit të shtesës anësore dhe të shtesës së kati për Shërbimin e*

*Provës*ò. Pasi DPSHP të marrë në dorëzim këtë investim, nga financa të bëhet veprimi kontabël dukë kredituar llogarinë 230 ñInvestime për Aktive Afatgjata jo materialeò dhe debituar llogarinë 212 ò*Ndërtesa dhe Konstruksione*ò.

Menjëherë e në vijimësi

5.4.Rekomandimi: Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse te marrë masa për evidentimin e saktë aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël, duke u analizuar arsyet dhe lidhur rezultatet e nxjerra me aktivet përkatëse, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

5.5.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së DPSHP-së të marrë për sistemimin e diferencave të konstatuara në zërat e pasqyrës së flukseve monetare dhe ndryshimeve të aktiveve neto të vitit 2020.

Menjëherë e në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës së procedurës së prokurimit publik realizuar në vitin 2017, me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò (DPSHP) me vlerë investimi prej 18,149,747 lekë me TVSH, është lidhur Kontrata Punës nr.01/7 prot., datë 13.06.2017 me OE fitues ñC.ò SHPK, grafiku për realizimin e punimeve parashikuar në 38 ditë kalendarike, punimet duhet të përfundonin më datë 31.07.2017. Rezultoi se punimet në objekt kanë filluar më datë 26.08.2019 dhe kanë mbaruar më datë 17.07.2020, për shkak të mangësive si vijon:

(i) Në vitin 2017, nga AK nuk ishte aplikuar në kohë, për marrjen e Lejes së ndërtimit, shkak i cili ka ndikuar që, fillimi u punimeve në objekt, kanë nisur me vonesë prej 2 vite e 2 muaj, përgjegjësi e AK, si dhe nga ana e institucioneve të tjera shtetërore konkretisht, Bashkia Tiranë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për shkak të vonesave në kohë, për pajisjen e lejes së ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar, neni 27 dhe 28, me VKM nr.408 datë 13.03.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar dhe LPP.

(ii) Nga ish titullari i AK (z. E. H.), janë miratuar dy Amendime të kontratës, duke ndryshuar grafikun e punimeve nga 38 ditë kalendarike në 60 ditë kalendarike, në kundërshtim me DST dhe kontratën bazë dhe rregullat e prokurimit publik.

(iii) Mbas mbarimit të punimeve më datë 17.07.2020, në funksion të rikonstruksionit të godinës nga AK janë realizuar dy procedura prokurimi me blerje të vogël, me objekt kolaudimin në dhjetor të vitit 2020 dhe marrjen në dorëzim e objektit në qershor të vitit 2021, të realizuara me vonesë në kohë nga njëra tjetra duke e kaluar afatin prej 30 ditë, në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, Udhëzimit nr.1 datë 16.06.2011 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.

(iv) Sipas preventivit përfundimtar të OE fitues ñC.ò SHPK, në zërat furnizim/vendosje u konstatuan, 14 (katërmbëdhjetë) copë kondicionerë, 30 (tridhjetë) copë fikse zjarri dhe 11 (njëmbëdhjetë) kamerave vëzhguese, të pashoqëruara me dokumentacionin financiar hyrje dhe dalje, në kundërshtim me Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 35/b dhe pika 37.

(v) Për këtë kontratë nga AK i DPSHP, janë realizuar dy pagesa për situacionet pjesore 1& 2 me vlerë prej 7,327,950 lekë me TVSH duke mos përfshirë 5% e garancisë së punimeve, ndërsa pjesa tjetër sipas Situacionit Përfundimtar dorëzuar në DPSHP nga operatori ekonomik më datë 29.08.2020 në vlerën prej 10,436,115 lekë pa TVSH nuk është likuiduar.

Për vonesën e pajustifikuar për përfundimin e objektit nga OE fitues ñC.ò (226 ditë të vonuara sipas kontratës) punimet kanë filluar më datë 26.08.2019 dhe kanë mbaruar më datë

17.07.2020) **vlera e penalitetit** për operatorin ñC.ò llogaritet **9,434,247.96 lekë pa TVSH,** kjo sipas situacionit përfundimtar (i papaguar nga AK) 10,436,111 lekëx0,004 = 41,744.46 kostoja ditore e penalitetit x 226 ditë të vonuara= 9,434,247.96 lekë, kjo në bazë të nenit 38 pika 1, germa (a) të Kontratë Pune nr.01/7 prot., datë 13.06.2017.
Për vlerën e saktë të penalitetit, AK ende nuk ka njoftuar OE me shkresë zyrtare.
(vi) nuk është bërë rinovimi i Formularit të Sigurimit të Kontratës 10% të vlerës së investimit, në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar neni 49 pika b/(iii).
(vii) Nga AK, në përfundim të kontratës, nuk është dërguar APP-së një kopje të raportit të monitorimit të saj, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914/2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 77, pika 3 dhe 4.
(**viii**) konstatimet e mësipërme, tregojnë se nga ana e DPSHP në cilësinë e AK, ka angazhuar burime njerëzore, të cilët nuk janë trajnuar pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për pasojë kemi raste parregullsie dhe paqartësie mbi ecurinë e realizimit, të zbatimit dhe monitorimit të kontratave të prokurimeve publike.
(Trajtuar më hollësisht në pikën 2 faqet 38-66 të Raportit të Auditimit).
6.1.Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë si organ qendror në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në cilësinë e institucionit të varësisë, të marrë masa për personat e ngarkuar me përgjegjësi, në lidhje me mangësitë e konstatuara gjatë procesit të zbatimit të kontratës nr.01/7 prot., datë 13.06.2017 me objekt ñRikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provësò, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomicitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore dhe shmangien e risqeve financiare në Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

6.2. Rekomandimi: Të merren masat nga DPSHP dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për njoftimin e OE ñC.ò SHPK, për vendosjen penalitetit në vlerën prej 9,434,247.96 lekë, si pasojë e vonesave në dorëzimin në kohë të objektit, e cila do të mbahet nga pagesa e mbetur e pa realizuar ende nga DPSHP.

Menjëherë

6.3. Rekomandimi: Të merren masa nga DPSHP që në të ardhmen të kërkojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik që të planifikojë trajnime të stafit që merret me prokurimet publike, me qëllim rritjen e nivelit profesional në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik si dhe vendosjes së kritereve të konkurrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, DPSHP ka në pronësi 1 automjet tip Hunday (I-30) viti i prodhimit 2010. Për konsumim e karburantit është miratuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm z.E.H. (*në mungesë dhe me urdhër*) urdhri nr.2477 prot., datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë TR xx T, brenda Tiranësò, me sasi mujore 150 litra për përdorim brenda qytetit të Tiranës.
Në bazë të auditimit nga ana juridike e hartimit dhe miratimit të urdhrit, u konstatua se:
-Urdhri është hartuar sipas ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 4 dhe ligjit nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò i ndryshuar, neni 3 pika 6, por baza e mësipërme ligjore, nuk përputhet me qëllimin e hartimit të tij, pra për përcaktimin e saktë të sasisë së karburantit mujor, në kundërshtim me ligjin nr.10160 datë 15.10.2009 ñPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò neni 2, pika 4 dhe 5.
-Gjithashtu, në momentin e hartimit të urdhrit, nuk u konstatua asnjë dokument administrativ, që të vërtetonte sasinë mujore të km që konsumon mjeti i DPSHP brenda Tiranës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-66 të Raportit të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: DPSHP të marrë masa të menjëhershme për shfuqizimin e urdhrit nr.2477 datë 31.05.2018 dhe nxjerrjen urdhrit për përcaktimin e limitit të karburantit sipas dispozitave ligjore të mirë përcaktuara, me qëllim shmangien e menaxhimit jo efektiv të shpenzimeve financiare nga Buxheti i Shtetit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor i DPSHP për periudhën në auditim 2019ï 2021, janë realizuar procedurat ka realizuar procedurën me blerje të vogël me objekt ñShpenzime dhe mirëmbajtje dhe riparim automjetiò në bazë të Urdhrave të Prokurimit nr.1 datë 27.02.2019, me fond limit 180,000 lekë pa TVSH, nr.1 datë 19.05.2020 me fond limit 100,000 lekë pa TVSH dhe nr.2 datë 24.05.2021 me fond limit 100, 000 lekë pa TVSH.
Nga auditimi për tre procedurat e mësipërme u konstatuan mangësitë si më poshtë:
(**i**) llogaritja e fondit limit është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg, të cilat nuk përmbajnë datë, dhe nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë aktuale për kohën.
(**ii**) Në përcaktimin e vlerës për riparimet dhe shërbimet që do i bëhen automjetit (para llogaritjes së fondit limit) nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit e mjetit motorik në përputhje me Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Udhëzimin nr. 30 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Gjithashtu, nuk ka evidenca për mjetin (letër shërbimesh) se sa kilometra ka përshkruar përgjatë viteve të mëparshme. Pra nuk ka dokumentacion dhe evidenca te mjaftueshme për të argumentuar gjendjen reale të përdorimit dhe nivelin e amortizimit të automjetit, me qëllim identifikimi e saktë të nevojës për riparime dhe shërbim, mbi bazën e të cilave do të llogaritej dhe të kërkohej financimi buxhetor për të vijuar me pas me llogaritjen e fondit limit sipas përcaktimeve te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-66 të Raportit të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Nga DPSHP, të merren masa, për të analizuar dhe vlerësuar saktë gjendjen teknike mbështetur në vlerën kontabël, në llogaritjen e amortizimit dhe në dokumentacionit teknik të çdo automjeti. Kjo analizë dhe vlerësim të bëhet me qëllim marrjen në konsideratë të raportit kosto-përfitim (leverdinë ekonomike)për shërbimet që kërkohet të kryhet për mjetin motorik.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në DPSHP, dosjet e prokurimeve për të cilat kanë përfunduar procedurat përkatëse si dhe dosjet e inspektimit pranë Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës, nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-66 të Raportit të Auditimit).
9.1.Rekomandimi: Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, nga ana e DPSHP, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare (DI&SHK) për vitin 2018-2019 u konstatua se:
-Dosjet e inspektimit nuk janë të inventarizuara por të protokolluara jo në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò.
-Në asnjë rast nuk janë raportuar pranë ministrit të Drejtësisë përmes analizave vjetore të institucionit dërguar me shkresat respektive nr. 310 prot., datë 14.02.2019, nr. 76 prot., datë 17.01.2020, masa për punonjësit e shërbimit të provës dhe pse evidentohen problematika dhe nxirren përgjegjësitë, shprehur në raportet respektive të inspektimit.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 85-117 të Raportit të Auditimit).
10.1. Rekomandimi:Të merren masa nga titullari i institucionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare (DI&SHK), për inventarizimin e dosjeve të inspektimit konform ligjit ñPër arkivatò.
10.2. Rekomandimi:Të merren masa nga titullari i institucionit që pas ushtrimit të inspektimit në zyrat rajonale të Shërbimit të Provës në ato raste kur janë konstatuar veprime që përbëjnë shkelje disiplinore për punonjësit, të rekomandojë masave disiplinore në raport me shkeljen e konstatuar e cila përcillet së bashku me Raportin e inspektimit/kontrollit, pasi të ketë analizuar më parë përgjegjësitë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve të inspektimit të Drejtorisë së DI&SHK për vitin 2018-2019 u konstatua se veprimet e kryera nga inspektorët për praktikat e inspektimit/raportet e kontrollit të audituara me zgjedhje, nuk janë në përputhje me VKM nr.302, datë 25.03.2009 pasi:
-Nuk kanë bashkëngjitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm si: urdhrin e inspektimit apo shkresën përcjellëse.
-Në shumicën e rasteve paraqitja e raportit është në tejkalim të afatit të vendosur në urdhrin e inspektimit.
-Konkluzionet e dala nga grupi i inspektimit, nuk kanë të përcaktuar qartë bazën ligjore për klasifikimin e shkeljeve disiplinore, pasi nuk përcaktohet klasifikimi i shkeljeve disiplinore sipas nenit 21,VKM nr.302, datë 25.03.2009 me të cilin është trajtuar shkelja e nxjerrë si problematikë.
-Konkluzioni nuk është në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, pasi nuk propozohen masa disiplinore konkrete.
-Klasifikimi i shkeljeve në disa raste si shkelje të òlehtaò nuk është në përputhje me përcaktimet VKM nr.302, datë 25.03.2009, pasi referuar problematikave të konstatuara nuk kemi të bëjmë me thyerje të rregullave të etikës apo shkelje të ñlehtaò siç trajtohet në këto raporte, por me shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullore që lidhen me detyrën funksionale të inspektorit të ZVSHP-ve e cila klasifikohet si shkelje e ñrëndë disiplinoreò
-Në një rast (ZVSHP Sarandë) Raporti i kontrollit nuk i është dërguar për njoftim personit përgjegjës ish drejtorit z.A.G. (larguar nga institucioni), jo në përputhje me Rregulloren ñMbi procedurat e dhënies së masës disiplinore për punonjësit e Shërbimit të Provësò miratuar me Urdhrin Nr.1673, datë 02.12.2010 neni 14, pika 2.
11.1.Rekomandimi:Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Plani i Veprimit për Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare (DISHK), për vitin 2020, është miratuar nga DP në bazë të shkresës nr.276 prot.,

datë 25.02.2020, duke përcaktuar ZVSHP për inspektim. Nga auditimi u konstatua se, ZVSHP të cilat janë inspektuara nuk janë të njëjta me ato të cilat ishin miratuar në Planin e Veprimit, kjo për shkak të situatës së krijuar nga pandemi Covid-19. Gjithsej, janë realizuar 12 inspektime dhe 1 inspektim tematik në ZVSHP, nga 22 zyra vendore që ka në administrim dhe varësi DPSHP.

Ndërsa, për periudhën 01.01.2021 deri më 30.06.2021, DPSHP nuk ka miratuar Planin e Veprimit për DISHK, në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò, përgjegjësi e Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) z. A. K.. Plani i Veprimit është miratuar më datë 01.09.2021 me shkresë nr.846 prot.

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, janë realizuar 6 inspektime rast pas rasti në Degët Territoriale të Shërbimit të Provës (DTSHP) emërtimi sipas ligjit të mësipërm.

Nga auditimi i raporteve përfundimtare të inspektimit nga DISHK për vitin 2020 dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, u konstatua se:

(i) Në rubrikën e problematikave të raporteve të inspektimit, të evidentuara nga grupi inspektimit për vitin 2020, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë në kundërshtim me VKM-së nr.302 datë 25.03.2009 neni 21 pika 4, të bëra nga specialistët dhe nga drejtuesit e ZV/DTSHP, ndërsa rekomandimet e propozuara prej tyre, e më pas të miratuara nga titullari i institucionit, ishin mjaft më të lehta, ndonëse akti nënligjor shprehet se *"Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore."*

Kjo situatë paraqitet pothuajse e njëjte dhe për periudhën 01.101.2021 deri në 30.06.2021, ku problematikat e evidentuara në raportet përfundimtare të inspektimit, pasqyrohen shkeljet e mospërputhshmërisë në kundërshtim me ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 11 pika1;neni 18 pika1; neni 21 pika 1 dhe neni 23, të bëra nga specialistët dhe nga drejtuesit e ZV/DTSHP, ndërsa rekomandimet e propozuara prej tyre, e më pas të miratuara nga titullari i institucionit, ishin mjaft më të lehta. Në këtë rast për vendosjen e masave disiplinore, duhej të aplikohej ligji 153/2013 ñPër Nëpunësin Civilò dhe VKM nr.115 datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin , përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, pika 2.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi grupin e inspektimit me përbërje (E.G., E.K., A.XH. dhe S.L.,) dhe ish-Drejtorit të Përgjithshmëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) (B.D. dhe A.K.), të cilët, duke mos marrë masa për përmirësimin e gjëndjes në përputhshmëri me legjislacionin bazik dhe atë sekondar , përbën shkak për rritjen e risqeve të veprimtarisë së DPSHP.

(ii) Në raportet përfundimtare nuk është dhënë informacion i qartë, mbi aktivitetin total që ushtron ZVSHP/DTSHP, duke mos relatuar numrin e përgjithshëm aktual të personave të dënuar të cilët janë nën mbikëqyrje nga ZVSHP/DTSHP si dhe numri total të dosjeve aktive, në mënyrë tillë për të nxjerr ne pah ñngarkesën individualeò të secilit punonjës.

(iii) Nuk është relatuar mbi çfarë baze është bërë përzgjedhja e dosjeve të inspektuara, duke treguar mangësi për metodologjinë e organizimit të punës, si pasojë e mungesës së rregullores të detyrave funksionale të Drejtorisë së Inspektimit, pranë DPSHP .

(iv) Dosjet e inspektimit, nuk rezultuan të jenë e numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 85-117të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga titullari i DPSHP të merren masa që në fillim viti të miratohet Plani i Veprimit të Inspektimin si dhe të ngihet niveli i marrjes së masave disiplinore në

rastet kur është e nevojshme, me qëllim arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e DPSHP për vitet 2020 dhe 2021, mbi detyrimin up-date të sistemit të dosjeve aktive mbi ecurinë e personit nën mbikëqyrje deri në momentin e mbarimit të periudhës së provës, në formatin elektronik, u konstatua se:
-Për mirëmbajtjen e sistemit, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është realizuar procedura e prokurimit në rolin e AK me objekt ñMirëmbajtja e sistemit të shërbimit të provësò dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP), është në cilësinë e institucionit përfitues, me afat 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës nr.1201 prot., datë 25.02.2021.
-Kështu, për të parë funksionin e veprimtarisë së detyrave funksionale të DPSHP si dhe ecurinë e sistemit të mësipërm, u fokusuam pranë DTSHP-Tiranë, pasi ka në mbikëqyrje numrin më të lartë të dosjeve fizike, kështu për vitin 2020 rezultoi me 1720 dosje aktive dhe për 6 mujorin e parë të vitit 2021 rezultoi 1028 dosje aktive, nga të cilat u konstatuan se janë hedhur 681 dosje aktive në formatin elektronik.
-Në bazë të metodës krahasimore të dosjeve fizike respektive me dosjet e hedhura në sistem, u konstatua se, dosjet aktive në formatin elektronik nuk janë hedhur të plota, duke hedhur vetëm, të dhëna personale, vendimin e gjyqësorit, hartimin dhe miratimin e Planit Individual të Trajnim, ndërsa takimet periodike, pasqyrimi periodik mbi trajtimet e personave nën mbikëqyrje, nuk janë reflektuar në sistemin e dosjeve aktive në formatin elektronik të Shërbimit të Provës.
-Mos hedhja në sistemin elektronik, të elementëve të plotë të dosjeve aktive, përbën shkak për rritjen e pritshmërisë së riskut të implementimit të shërbimit përfitues për institucionin e DPSHP, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 24 pika 3 pika 5 dhe VKM nr.421 datë 08.07.2021 ñPër miratimin e rregullores së përgjithshme të shërbimit të provësò neni 10 (Regjistrat e shërbimit të provës) pika 2, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtuesin aktual Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës-Tiranë z.B. D. si dhe titullarin e DPSHP (në mungesë dhe me urdhër z.A.K.) ka kontrolle të dobëta, si pasojë e mos ngritjes së strukturave për përditësimin në sistemin elektronik të dosjeve aktive.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 85-117 të Raportit të Auditimit).
13.1. Rekomandimi: Nga DPSHP, të merren masa për të analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e detyrimeve për përditësimin në formatin elektronik të dosjeve aktive mbi ecurinë e personit nën mbikëqyrje deri në momentin e mbarimit të periudhës së provës, me qëllim arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, konstatohet se: detyrimet nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, pasi nuk janë njohur si shpenzime periudhe në momentin që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 34 dhe 42. Për pasojë, llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Konkretisht nga viti 2018 deri në vitin 2021, ky zë reflektohet me vlerë

0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare përkatësisht:
-në vitin 2016 në shumën prej 456,440 lekë, likuiduar në vitin 2019;
-në vitin 2017 në shumën prej 471,482 lekë, likuiduar në vitin 2019 dhe 2021.
Gjithashtu referuar pagesave të kryera nga DPSHP për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
(Më hollësish trajtuar në fq. 72-85 të Raportit).

14.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe i Buxhetit të marrë masa të menjëhershme në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve ligjore, për rakordimin e informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2. Rekomandim: Sektori i Financës dhe i Buxhetit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.3. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështje ligjore, të marrë masa për ndjekjen proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit duke dërguar në kohë reale informacion të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike të Shërbimit të Provës miratuar me Urdhrin nr.55, datë 20.04.2017, nr.149, datë 01.10.2018 dhe nr.63, datë 07.05.2020, Kryeministrit, konstatohet se DPSHP nuk ka miratuar rregullore ku të përcaktojë detyrat funksionale të çdo drejtorie, sektori dhe punonjësve dhe pse është hartuar një draft rregullore por që nuk është miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.78, datë 25.06.2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provësñ është zëvendësuar termi ñZyrat vendoreò në ñDrejtoritë territorialeò, ndërkohë që kërkesat për planifikimet dhe shpalljet në DAP bëhen me emrin ñZyrat vendoreò sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020 ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës ò.*(Më hollësisht trajtuar në fq. 72-85 të Raportit*).

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa për miratimin e rregullores së brendshme, në mënyre që çdo pozicion pune dhe punonjës të ketë të përcaktuar detyrat e tij funksionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa për saktësimin e termit nga ñ**Zyrat vendore"** në **"Drejtoritë territoriale"** tek Urdhri i Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhrin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës* ò me qëllim që ndryshimet ligjore të reflektohen në aktet nënligjore që rregullojnë strukturës organike të DPSHP.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike konstatohet **s**e pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ka qenë dhe është vakant për një periudhë 4

vjeçare, nga muaj gusht i vitit 2017. Gjatë kësaj periudhe respektive Ministri i Drejtësisë e ka deleguar në mungesë dhe me porosi, ndërkohë që Ligji nr.78/2020 ñPër organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provësò neni 10, përcakton qartë vetëm emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe kriteret që ai duhet të plotësojë, por nuk parashikon delegim të kompetencave në afate të papërcaktuara.
Gjithashtu shkresa e Ministrit të Drejtësisë nr.875/1 datë 11.02.2021, i cili i ka kaluar kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Shërbimit të Provës z. A.K., i referohet VKM nr.302 datë 25.03.2009, VKM e cila është shfuqizuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 78/*2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës".(Më hollësisht trajtuar në fq.72-85 të Raportit*).
16.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me ministrinë e Drejtësisë të marrë masa të menjëhershme për të propozuar pranë Këshillit të Ministrave plotësimin e vendit të lirë/vakant në pozicionin ñDrejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik (GMS), veprim jo në përputhje me kërkesat e të Ligjit nr.10296, datë 18.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar nenit 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 tagër dhe kompetencë e Nëpunësit Zbatues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 8 të Raportit Auditimit*).
17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës/Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për ngritjen e GMS-së dhe hartimin e Regjistrit të Riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën nën auditim 01.01.2018 deri në 30.06.2021, në lidhje me realizimin dhe menaxhimin e procedurave me blerje të vogël me objekt ñBlerje karburant për nevojat e DPSHPò, u konstatua se:
Me Urdhër-shpenzimin nr.373 date 24.05.2019, është paguar karburant 350 litra gazoil me tollonë, në mbështetje të Urdhër të ish-titullarit të DPSHP, me nr.3812 prot. datë 22.11.2018 ñPër shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, për specialisten e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kukës, znj.J.E.ò, për lëvizjet në ZVSHP-Tropojë në përmbushje të detyrave administrative dhe funksionimit të zyrës. Në Urdhër-shpenzimin nr.373 datë 24.05.2019, nuk u konstatuan, dokumentacion justifikues si dhe faturat e blerjes së karburantit nga znj. Elezaj në koherencë me lëvizjet e saj sipas datave të raportuara në autorizimet e lëshuara nga ish-titullari i DPSHP, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.36.
Dhënia e 350 litra karburant me tollonë është në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, për pasojë vlera prej 47,970 lekë pa TVSH, është menaxhuar jo në përputhje me aktet e mësipërme ligjore/nënligjore, duke shkaktuar efekt negativ në buxhetin e institucionit, siguruar nga Buxheti i shtetit.
-Për periudhën 01.01.2020 deri në 31.08.2020, në bazë të Fletë daljeve të magazinës së DPSHP, sasia për përdorim brenda Tiranës prej 150 litra në muaj, është konsumuar duke mos paraqitur dokumentacionin argumentues dhe justifikues Fletë-udhëtime mujore, për rrjedhojë sasia prej 950 litra gazoil në vlerën prej 130,055 lekë me TVSH, është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i Shtetit, në kundërshtim me Udhëzimin e

Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 & 36 dhe Urdhër nr.2477 prot., datë 31.05.2018 ñPër limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjeti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me targë TR xxxT, brenda Tiranësò pika 3.
-Nga institucioni i DPSHP, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.06.2021,në bazë të fletë-udhëtimit mjeti ka lëvizur brenda Tiranës duke përfshirë edhe lëvizjet në drejtim të IEVP-Vaqarr të cilat janë 1090 km ose 100 litra gazoil, ndonëse ky institucion është i mbyllur për shkak të amortizimit të godinës, kjo në bazë Urdhër Transferimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.3497/1 datë 17.04.2019, duke u zhvendosur në ambientet e IEVP ñJordan Misjaò.
-Gjithashtu për këtë periudhë, u konstatua se, në hartimin dhe miratimin e fletë-udhëtimeve, kemi mospërputhshmëri të lëvizjes së mjetit, i cili rezultoi që në të njëjtën datë ñ*është ndodhur në dy vendndodhje të ndryshme*ô e për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit për 320 km ose 32 litra gazoil.
Në total, për vitet 2019, 2020 deri në 30.06.2021,vlera prej 144,926 lekë me TVSH është përdorur me efekt negativ, ndaj fondeve të siguruara nga Buxheti i shtetit, për shkak të konsumit të karburantit, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar UMF nr.30 datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarët e DPSHP sipas kohës respektive ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër) (E. H., B.D. dhe A.K.) dhe znj.A.N. në cilësinë e ish nëpunësit zbatues dhe znj.H.M. në cilësinë e nëpunësit zbatues (në mungesë dhe me urdhër).
(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-66 të Raportit të Auditimit).
1.1.Rekomandimi: Nga DPSHP të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **144,926 lekë me TVSH** e cila përbën dëm për buxhetin e shtetit për konsumin e karburantit në kundërshtim me bazën ligjore të sipër përmendur, konkretisht:
-vlera **47,970 lekë** pa TVSH, nga znj. J.E. e cila nuk ka dokumentacion justifikues si dhe faturat e blerjes së karburantit në koherencë me lëvizjet e saj sipas datave të raportuara në autorizimet e lëshuara nga ish-titullari i DPSHP,
-vlera **130,055 lekë** me TVSH nga z.E. H., z.B.D., z.A.K., znj.A.N. dhe znj.H. M., për miratimin e fletë-udhëtimeve në mospërputhje me lëvizjet e mjetit, i cili rezulton në të njëjtën datë në dy vendndodhje të ndryshme, për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit për 320 km ose për 32 litra gazoil.

Deri në Qershor 2022

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike u konstatua se për periudhën 2018-2019, kjo drejtori nuk ka qënë në eficencë të plotë për të përmbushur shërbimin e ME, pasi funksionimi i ñpajisjes së gjurmimitò ka paraqitur një sërë problematikash të cilat nuk kanë mundësuar teknikisht funksionimin e saj. Për pasojë, nga gushti i vitit 2017 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (DPSHP) nuk ka zbatuar asnjë urdhër ekzekutimi për mbikëqyrje elektronike si dhe pas dy vitesh testim dhe monitorim të sistemit të mbikëqyrjes elektronike ministria e Drejtësisë ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën nr.8383/10 prot., datë 21.02.2017, për shkak se ka dështuar funksionimi efektiv i pajisjes së gjurmimit. Për pasojë, nga data 20.09.2019, datë në të cilën

është zgjidhur zyrtarisht kontrata e sipërcituar e në vijim (*deri 30.06.2021 periudhë nën auditim*), DME, nuk ka qënë eficente dhe nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për të cilat është krijuar, pasi nuk ka realizuar procesin e mbikëqyrjes elektronike, duke sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në lidhje me shpenzimet e kryera për pagat e punonjësve të drejtorisë së ME në vlerën 14,291,182 lekë llogaritur për periudhën tetor 2019 deri në Qershor 2021.*(Më hollësisht trajtuar në fq.85-117 të Raportit*).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, të marrë masa të menjëhershme duke kërkuar nga organi qendror/ministria e Drejtësisë vënien në eficencë të DME dhe stafit të saj, me qëllim funksionimin e kësaj drejtorie.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Shërbimit të Provës në lidhje me krijimin e regjistrit elektronik dhe dixhitalizimin e Shërbimit të Provës rezultoi se: DPSHP ka ngritur një sistem elektronik për dixhitalizimin e sistemit të Shërbimit të Provës i cili është implementuar në vitin 2015 me lidhjen e kontratës nr.1853, datë 28.09.2015 me objekt ñDixhitalizimin e sistemit të Shërbimit të Provësò me palë kontraktuese AKSHI-i dhe BOE ñF.ò(*ku përfitues është SHP*), me vlerë 7,899,680 lekë pa TVSH, me afat 4 vjet për mirëmbajtjen duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të shërbimeve të implementuara (afati për implementimin e shërbimeve 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës). Me akt marrëveshjen nr.7552/6 prot., datë 06.12.2019 të palëve kontraktuese (AKSHI dhe ñF.ò) është zgjidhur kontrata nr.1853, datë 28.09.2015 pa asnjë kosto për palët duke ju referuar nenit 8 të kontratës së sipërcituar sipas të cilës ò*Në rast se, Qeveria Shqiptare vendos, të mos miratojë fondin vjetor lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes, kontrata do të ndërpritet pa kosto për palët*ò.

Për pasojë, për periudhën nga 2018-2019, periudhë e cila përfshihet në afatin 4 vjeçar të kontratës nr.1853, datë 28.09.2015, nuk rezulton të jenë hedhur të dhënat e regjistruara nga ZVSHP-të dhe administruar nga DPSHP, jo në përputhje me VKM nr.302, datë 25.3.2009, neni 26, pika 3, e cila ka sjellë si pasojë përdorimin pa eficencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 7,899,680 lekë pa TVSH, vlerë e cila është shpenzuar për ngritjen e sistemit/dixhitalizimit të Shërbimit të Provës dhe mirëmbajtjen e tij, por që nuk është përdorur dhe nuk ka gjurmë dokumentare të qartë për të vërtetuar cilët kanë qenë shkaqet nga mos përdorimi i sistemit si pasojë e mos kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes apo mos hedhja në kohë e të dhënave si pasojë e mos përdorimit të sistemit nga vetë Shërbimi i Provës. Nga Shërbimi i Provës me shkresën nr.603 prot., datë 23.06.2020 drejtuar AKSHI-t dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë vihet në dukje se ñ*sistemi ka probleme të cilat shkojnë përtej ekspertizës...është e nevojshme të mundësohet mirëmbajtja nga kompani e specializuar*ò. *(Më hollësisht trajtuar në fq.85-117. të Raportit*).

2.1. Rekomandimi: Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi në lidhje me shkaqet e mos përdorimit të sistemit të dixhitalizimit të Shërbimit të Provës dhe në bashkëpunim me AKSHI-n, në të ardhmen të sigurohet vazhdimësia e mirëmbajtjes së sistemit të dixhitalizimit të Shërbimit të Provës.

Menjëherë

2.2. Rekomandimi: Të merren masa nga Shërbimi i Provës për hedhjen e të dhënave të dosjeve për personat nën mbikëqyrje, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratën nr.1201, datë 25.02.2021 lidhur mes AKSHI-t dhe operatorit fitues për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet gjyqësore u konstatua se janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 7 ish-punonjës në vlerën totale 5,938,934 lekë, nga ku për vitin 2019 në vlerën 2,784,670 lekë, për vitin 2020 në vlerën 2,547,072 lekë dhe për vitin 2021 ne vlerën 607,192 lekë. Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës menjëherë me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë ekzekutuar në mënyrë të detyrueshme me urdhër ekzekutime të lëshuara nga përmbaruesit privat, kundrejt tarifës përmbarimore, në vlerë totale prej 661,644 lekë nga ku për vitin 2019 në vlerën 265,248 lekë, për vitin 2020 në vlerën 354,676 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 41,720 lekë.
Vendimit gjyqësore janë shpenzim jo i drejtë dhe jo në përputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e DPSHP-së, në total për periudhën objekt auditimi në vlerën prej 5,938,934 lekë.
(Më hollësish trajtuar në fq.72-85 të Raportit).
3.1.**Rekomandimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës të marrë masa për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë menjëherë pas publikimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, me qëllim uljen e shpenzimeve të DPSHP-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

D.MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, germa (b, c dhe ç), nenin 58 të Ligjit nr.153/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar si dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 për ñPërcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinorò, kreu II, pika 3, nenin 72 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurim publikò i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrit të Drejtësisë si titullar i organ qendror në bashkëpunim me Shërbimin e Provës të analizojë parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara nga punonjësit e Shërbimit të Provës të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore nga *ñvërejtje"* deri në *"largim nga shërbimi civil*ò në lidhje me:
I. Mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në raportet e inspektimit të kryera nga Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare për vitin 2018, 2019, 2020 deri në 30.06.2021 për punonjësit më poshtë:
1.z.E.K., në cilësinë e inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit të Shërbimit të Provës viti 2018, për kontrollin e kryer në ZVSHP Tiranë, Mat, Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Berat, Kurbin, për vitin 2019 për kontrollin e kryer në ZVSHP Korçë, Fier, si dhe për vitin 2020 sipas problematikave të trajtuara në këtë Raport Auditimi.
2.z.A.XH., në cilësinë e inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit të Shërbimit të Provës viti 2018, për kontrollin e kryer në ZVSHP Tiranë, Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Kurbin, Berat, Fier, për vitin 2020 sipas problematikave të trajtuara në këtë Raport Auditimi.
3.z.E.G., në cilësinë e inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit të Shërbimit të Provës viti 2018, për kontrollin e kryer në ZVSHP Tiranë, Mat, Përmet, Gjirokastër Sarandë, Berat, Vlorë, për vitin 2019 për kontrollin e kryer në ZVSHP Korçë, Berat dhe Fier, si dhe për vitin 2020.
4.z.S.L., në cilësinë e inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit të Shërbimit të Provës viti 2018, për kontrollin e kryer në ZVSHP Tiranë, për vitin 2019, për kontrollin e kryer në ZVSHP Berat dhe Fier, si dhe për vitin 2020 sipas problematikave të trajtuara në këtë Raport Auditimi.
5.z.R.L., në cilësinë e ish inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit të Shërbimit të Provës viti 2018, për kontrollin e kryer në ZVSHP Kurbin,

6.z.E. H., në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), si dhe cilësinë e ish Drejtorit të Inspektimit të Shërbimit të Provës, viti 2018, për miratimin e raport kontrolleve me parregullsi dhe mangësi.
7.z.A.K. me detyrë ish Drejtor i Inspektimit të Shërbimit të Provës, në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), për periudhën e gjashtëmujorit të parë të vitit 2021 sipas problematikave të trajtuara në këtë Raport Auditimi.
8. z.B.D. me detyrë Drejtor i Degës Territoriale të Shërbimit të Provës, në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), për vitin 2020 sipas problematikave të trajtuara në këtë Raport Auditimi.

II. Për konsumin e karburantit, pa ekonomicitet në vlerën 144,926 lekë me TVSH në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, UMF nr.30 datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika nr.35 &36, për punonjësit më poshtë:
1.z.E.H., në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), për vitet 2018 dhe 2019, (sot në pension pleqërie).
2.z.A.K. me detyrë Drejtor i Inspektimit të Shërbimit të Provës, në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), për periudhën e gjashtëmujorit të parë të vitit 2021.
3. z.B.D. me detyrë Drejtor i Dega Territoriale të Shërbimit të Provës, në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të SHP (në mungesë dhe me urdhër), për periudhën e vitit 2020.
4. znj.A.N. në cilësinë e ish-nëpunësit zbatues për vitet 2018, 2019 dhe 2020, larguar nga institucioni i DPSHP.
5. znj. H. M. me detyrë specialiste e financës, për periudhën nën auditim.
6. znj.J.E. në cilësinë e ish-specialistes të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kukës, larguar nga institucioni i DPSHP.

Menjëherë

Shënim: Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në këtë Raport të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës (apo dalë në pension pleqërie) sipas legjislacionit për nëpunësin e civil/Kodin e Punës, nuk rekomandohet masë disiplinore pasi quhet e ezauruar.

V. Anekse.

Aneksi 1. "Mbi përputhshmërinë ligjore të veprimeve të kryera në lidhje me strukturën organizative, marrëdhëniet e punës, paga e shpërblime bazuar në aktet ligjore në fuqiò.

Aneksi 1/1 "Të dhënat mbi shpenzimet për pagat e punonjësve të DME nga data 20.09.2019 deri 30.06.2021ò.

Muajt/ Vitet	Nr punonjësve	Pagat e perfituara në muaj
10.2019	14	809,785
11.2019	13	702,707
12.2019	13	705,581
1.2020	13	705,581
2.2020	13	706,008
3.2020	13	699,634
4.2020	13	679,878
5.2020	13	653,884
6.2020	13	653,216
7.2020	13	652,777
8.2020	13	652,495
9.2020	13	654,064
10.2020	13	654,505
11.2020	13	655,158
12.2020	13	618,396
1.2021	13	602,867
2.2021	13	602,867
3.2021	13	603,290
4.2021	15	730,882
5.2021	15	752,925
6.2021	15	794,684
Totali		**14,291,182**

Aneksi 2: "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Shërbimit të Provës/drejtorive përbërëse**"**

Aneksi 2/1 "Raportet e kontrollit të cilat rezultuan në përputhje me kriteret ose me devijim të vogëlò

Viti 2018

Raportet e kontrollit/inspektimit për ZVSHP	**Mangësi e përbashkët**
Elbasan	Vonesa në paraqitjen e raportit jo në përputhje me urdhrin nr. 3570, datë 29.10.2018
Shkodër	Vonesa në paraqitjen e raportit jo në përputhje me urdhrin nr. 2216, datë 04.05.2018
Korçë	Vonesa në paraqitjen e raportit jo në përputhje me urdhërin nr. 1972, datë 13.04.2018
Pukë	Paraqitur brenda afatit
Pogradec	Vonesa në paraqitjen e raportit jo në përputhje me urdhërin nr. 1973, datë 13.04.2018 -Shkresa përcjellëse e raport kontrollit ka mos përputhje mes datës kur është konceptuar shkresa (30.01.2018) dhe Urdhrit nr.1973, datë 13.04.2018 për inspektim si dhe datës së protokollit të shkresës 15.05.2018.

Aneksi 2/1 "Raportet e kontrollit të cilat rezultuan në përputhje me kriteret ose me devijim të vogëlò

Viti 2019

Raportet e kontrollit/inspektimit për ZVSHP	**Mangësi e përbashkët**
Durrës	Vonesa në paraqitjen e raportit jo në përputhje me urdhërat respektivë të inspektimit nr. 568, datë 02.04.2019
Tropojë	Urdhri i inspektimit nr. 458, datë 11.03.2019 nuk përmban afatin e paraqitjes së Raportit, ndjekur 2 standarde në hartimin e urdhrit të inspektimit.
Përmet	Paraqitur brenda afatit sipas Urdhrit nr.1522, datë 01.11.2019.
Gjirokastër	Paraqitur brenda afatit sipas Urdhrit nr.1522, datë 01.11.2019.
Sarandë	Bashkëlidhur praktikës mungon Raport kontrolli bashkëlidhur Urdhrit të inspektimit nr. 1522, datë 01.11.2019 ndodhet raporti i vitit 2018, cituar dhe në shkresën përcjellëse nr.735 prot., datë 14.05.2019
Pogradec	paraqitur brenda afatit
Vlorë	paraqitur brenda afatit

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI LARTE I SHTETIT